



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport për auditimin financiar në Bashkinë Has**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**  
**MBI**  
**(Auditimin Financiar)**

**BASHKIA HAS**

**Tiranë, shtator 2025**

		<b>PËRMBAJTJA</b>	<b>Faqe</b>
<b>I</b>		<b>PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>3-8</b>
	<b>1</b>	Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit	3-4
	<b>2</b>	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-6
	<b>3</b>	Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit	6-8
<b>II.</b>		<b>HYRJA</b>	<b>8-13</b>
	<b>1</b>	Objektivat e auditimit dhe Qëllimi i auditimit	8-8
	<b>2</b>	Identifikimi i çështjes	8-9
	<b>3</b>	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9-9
	<b>4</b>	Përgjegjësitë e audituesve	9-9
	<b>5</b>	Kriteret e vlerësimit	10-10
	<b>6</b>	Standardet e auditimit	11-11
	<b>7</b>	Metodat e auditimit	12-12
	<b>8</b>	Dokumentimi i auditimit	13-13
<b>III.</b>		<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	<b>13-77</b>
	<b>1</b>	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	13-14
	<b>2</b>	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtiveve të auditimit	<b>13-14</b>
	<b>2.1.</b>	Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin e brendshëm dhe organizimin dhe funksionimin e auditit të brendshëm	14-31
	<b>2.2.</b>	Vlerësimi i Raportimit Financiar	31-55
	<b>2.3</b>	Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.	55-74
	<b>2.4</b>	Të ndryshme të dalta gjatë auditimit	54-55
<b>IV.</b>		<b>GJETJET DHE REKOMANDIMET</b>	<b>75-85</b>

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Bashkia e Hasit është njësi vendore, institucion i pavarur. Buxheti i Bashkisë Has si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transfertat e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

### b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të *Ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisve të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”*. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Has si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

### c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024, duke vlerësuar nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

### d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

**e. Nga shqyrtimi i evidencave**, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 11 gjetje dhe ka dhënë 12 rekomandime, nga ku masa organizative me 9 gjetje dhe 10 rekomandime, 1 gjetje-1 rekomandim në vlerën 19,321,716 lekë në fushën e të ardhurave si masa për uljen e borxhit tatimore dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia si dhe 1 gjetje dhe 1 rekomandim për Menaxhimin e 3-E-ve, për vendimet gjyqësore për gjyq fituesit e larguar nga puna në vlerën 108,455 lekë.

**f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.** Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

- **Mbi Menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe funksionimin e NJAB**

Bashkia Has nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim pasi u konstatuan se:

- Njësia e Auditit të Brendshëm për vitin 2023 nuk ka funksionuar në mënyrë të plotë për arsye se struktura është plotësuar vetëm me 2 auditues dhe jo 3 auditues siç përcaktojnë dispozitat ligjore.

- Plani i angazhimeve të auditimit është reduktuar në 4 auditime gjithsej duke mos kryer funksionin e plotë si sektor në auditimin e fushave me risk të Institucionit.

▪ **Mbi raportimin financiar dhe kontabilizimin e transaksionet financiare.**

-Gjendja e llogarisë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” ruan të njëjtën vlerë prej 914,949 lekë si në fund të vitit 2024, ashtu edhe në fund të vitit 2023, pa pasur lëvizje gjatë periudhës raportuese. Kjo vlerë është trashëguar nga procesi i konsolidimit të pasqyrave financiare midis Bashkisë Has dhe ish-komunës Gjinaj, në kuadër të reformës territoriale të vitit 2015. Megjithatë, nga strukturat përkatëse të bashkisë nuk është hartuar një analizë e detajuar që të sqarojë natyrën dhe përbërjen e kësaj vlere.

-Për Llogarinë 211 “Pyje dhe plantacione”, u konstatua se Drejtoria e Administrimit Pyjor dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit / Inspektori i Pronave kanë kryer aplikime pranë ASHK Kukës vetëm për marrjen e vërtetimeve për pronat e regjistruara në vitin 2020, me qëllim dhënien e tyre me qira. Megjithatë, vlera e këtyre pasurive nuk është regjistruar në kontabilitetin e institucionit. Për pesë certifikatat e pronësisë të përfshira në dokumentacionin përkatës, grupi i auditimit ka kryer një vlerësim të aseteve përkatëse, në bazë të VKM nr. 89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, duke përdorur tabelat referuese për vlerën për m<sup>2</sup> të pyjeve në territorin e Bashkisë Has. Bazuar në këtë metodologji, dhe duke llogaritur me vlerën 100 lekë/m<sup>2</sup>, rezulton se vlera totale e këtyre aseteve është **406,279,100 lekë**. Pavarësisht faktit se këto prona janë regjistruar në ASHK Kukës që në vitin 2020 dhe janë rifreskuar në vitin 2024, ato nuk janë rivlerësuar dhe nuk janë integruar siç duhet në kontabilitetin e bashkisë. Kjo situatë është rezultat i mungesës së bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe Drejtorisë së Administrimit Pyjor, për sa i përket përpunimit dhe shkëmbimit të informacionit mbi regjistrimin dhe pasqyrimin e pasurive pyjore në sistemin financiar.

- Të ardhura të munguara në 31.12.2024, në vlerën totale 89,782,727 lekë e përbërë nga:

- Detyrime ndaj subjekteve tregtarë, të lëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, në vlerën 23,154,812 lekë;
- Detyrime të debitorëve për penalitete të vendosura nga Agjencia e Prokurimit Publik, në vlerën 3,256,581 lekë;
- Detyrime nga taksat dhe tarifat për biznesin e madh në shumën 32,121,207 lekë,
- Detyrime nga taksat dhe tarifat për biznesin e vogël në shumën 13,279,332 lekë;
- Detyrime nga institucionet shtetërore në shumën 206,600 lekë;
- Detyrime nga qiratë e tregut (markat) në shumën 6,030,721 lekë;
- Detyrime kontraktore nga qiradhënie të tokës bujqësore të pandarë në vlerën 595,065 lekë;
- Detyrime kontraktore mbi takën e ndikimit në infrastrukturë, në vlerën 11,138,409 lekë.

**h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:** Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

▪ Bashkia Has në lidhje me **menaxhimin financiar dhe kontrollin** të marrë të gjitha masat për hartimin dhe miratimin e strategjisë së riskut. Koordinatori i Grupit të Menaxhimit Strategjik të organizojë takimet periodike të GMS-së për të siguruar marrjen në kohën të informacioneve cilësore për vlerësimin e progresit të bërë nga njësia në arritjen e objektivave të MFK-së.

▪ Bashkia Has në lidhje me **organizimin dhe funksionimin e NJAB** të marrë të gjitha masat e nevojshme për plotësimin e strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm me punonjësit e nevojshëm me qëllim bërjen funksionale të kësaj njësie auditimi për përmbushjen e misionit të saj, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njesisë.

- Bashkia Has *në lidhje me të ardhurat*, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në vlerën **89,782,727 lekë** nga taksapaguesit e biznesit (BM+BV) institucione shtetërore, familjarë, fermerë, individë etj.

- Bashkia Has në lidhje me *raportimin financiar nëpërmjet rregullsisë së hartimit të pasqyrave financiare* të marrin masa për kryerjen e procedurave të inventarizimit fizik të aktiveve të paktën një herë në vit, si dhe të kryhen përditësimet në kontabilitet duke plotësuar dhe saktësuar regjistrin historik të aktiveve;

- - Të analizojë dhe të përcaktojë të drejtat e konstatuara për arkëtim në vlerën 914,949 lekë, gjendje e llogarinë 423-429 “*Personeli, paradhënie, deficite, gjoba*”; Të marrë masa, që në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare, të zbatojë parimet e kontabilitetit në procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare, duke ndjekur fazat në mënyrë logjike, që nga mbajtja e dokumenteve përmbledhës të transaksioneve dhe veprimeve, që rezultojnë nga mbajtja e kontabilitetit në ditarët përkatës kronologjik.

- Në lidhje me *inventarizimin, përditësimin dhe regjistrimin e asetëve në ASHK* Bashkia Has nëpërmjet strukturave drejtuese dhe përgjegjëse të kryejë procedurat e plota për miratimin e listave përfundimtare të pronave për 3 NJA Golaj, Fajza dhe Gjinaj, duke kryer inventarizimin dhe përditësimin e listave paraprake të pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM Bashkisë dhe NJA-ve dhe më pas miratimi me VKB e paraqitja pranë ASHK në Drejtorinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike me vërejtjet dhe ndryshimet e listave të paraprake apo fillestare të pronave të miratuara. Gjithashtu për pjesën tjetër të pronave të kaluara Bashkisë me VKM në pronësi/përdorim, të pa hipotekuar të përgatisë dokumentacionin tekniko-ligjor dhe të ndjekë deri në fund regjistrimin e tyre në ASHK, Drejtoria Vendore Has.

## I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

### **Opinioni i auditimit financiar.**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Has për vitin ushtrimor 2024, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre, si dhe shënimet në relacionin për llogaritë, që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidencë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme të auditimit, shprehim një **opinion të kualifikuar** për llogaritë vjetore të Bashkisë Has, duke arritur në përfundimin se anomalitë e konstatuara apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura në llogaritë vjetore të vitin 2024, të shprehura në bazën për opinion.

### **Baza për opinion:**

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit”, pjesë e Raportit të auditimit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 - Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30 - Kodi Etik. Ne i kemi përbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipër përmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale por jo të përhapura, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm. Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 7,610 mijë lekë, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një “Opinionit të Kualifikuar” të auditimit

- Llogaria nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë”, nuk paraqitet në situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2024, pasi nuk janë regjistruar vlera e aksioneve që ka Bashkia Has në “Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Kukës Sh. A”.

- Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua se llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” nuk është pasqyruar saktë, pasi nuk janë përfshirë detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore, të cilat në fund të vitit 2024 rezultojnë në vlerën 277,126 lekë.

Llogaria 211 "Pyje dhe plantacione" nuk është pasqyruar saktë në fund të vitit 2024 duke u nënvlerësuar për vlerën 406,279,100 lekë, si rezultat i mos kontabilizimit të vlerës së 5 certifikatave të vlerësuar sipas VKM nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë

- Gjendja e llogarisë 423-429 “*Personeli, paradhënie, deficite, gjoba*” paraqitet në fund të vitit 2024 në vlerën prej 914,949 lekë. Kjo vlerë është trashëguar nga konsolidimi i pasqyrave financiare të aparatit të Bashkisë Has me ish komunat me reformën territoriale të vitit 2015 dhe i përket bilancit të ish-komunës Gjinaj, për të cilën nuk ka analizë të detajuar dhe të dhëna konkrete se çfarë përfaqëson.

- Nga auditimi i të ardhurave u konstatua mungesë në arkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, si dhe nga penalitetet për vitet e mëparshme deri më 31.12.2024, në një vlerë totale progresive prej 89,782,727 lekë, ndër të cilat debitorë për vitin 2024 janë në vlerën 19,321,716 lekë.

Nga auditimi i vendimeve gjyqësore rezulton se për vitin 2024 janë likuiduar vendime të formës së prerë në shumën 863,978 lekë dhe shpenzime përmbartimore në vlerën e 108,455 lekë, duke sjellë kosto shtesë në buxhetin e shtetit, të cilat nuk kanë qenë të njohura në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke mos i njohur si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë nga Vendimet e Gjykatave, por janë njohur në momentin e likuidimit.

## II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. Prot. 466/1, datë 25.04.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 28.04.2025 deri në datë 09.06.2025, në subjektin Bashkia Has për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024 u krye auditimi “Mbi auditimin Financiar”, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. E. Ll. – Përgjegjëse Grupi
2. L. Gj. – Auditues
3. K. F. – Audituese

## **OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA**

### **1. Objektivat e auditimit**

Auditimi Financiar në Bashkinë Has ka si objektiva kryesor:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrin ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)<sup>1</sup>;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

### **2. Qëllimi i auditimit**

Objekivi i auditimit financiar në Bashkinë Has është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme për periudhën nën auditim viti 2024, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejtë dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

### **3. Identifikimi i çështjes**

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Has dhe përgjegjësisë, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

**Pika 1.** Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.

**Pika 2.** Vlerësimi i raportimit financiar.

**Pika 3.** Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

**Pika 4.** Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

### **4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Has, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

### **5. Përgjegjësitë e audituesve**

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t, të cilat kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë

---

<sup>1</sup>Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

dhe kryejnë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionimi i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e mëparshme;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, ankesat, etj.).
- fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidencat auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Has, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

## **6. Kriteret e vlerësimit**

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Has është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Has. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- *Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";*
- *Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";*
- *Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;*
- *Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;*
- *Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;*
- *Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;*
- *Ligji nr. 152-2013, "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar;*
- *Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar;*
- *Ligjin nr.20/2020 datë 05.03.2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë";*
- *VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial";*
- *VKM nr.500 datë 14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme Shtetërore dhe*

*transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendor” i ndryshuar:*

- VKM nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njërive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njërive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar;
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”;
- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar;
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.05 datë 21.02.2022;
- Udhëzimi MF nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- Udhëzimin e MF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- Udhëzimin e MF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm në sektorin publik i miratuar me urdhrin e Ministrit të MFE nr. 100, dt. 16.10.2017.
- Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”
  - Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”;
  - Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së”;
  - Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.
  - Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;

## **7. Standardet e auditimit**

Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Has grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 200; 400 etj. “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.
- Manuali i zbatimit të rekomandimeve të KLSH.
- Manuali i auditimit financiar të KLSH me ndryshime.

## **8. Metodatat e auditimit**

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe
- Pështetja specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Ndjekja dhe zbatimi i hapave të mësipërm do të sjellin natyrshëm përcaktimin e elementëve kryesorë që do të ndiqen gjatë procesit të zbatimit të projektit të auditimit, nëpërmjet sigurimit të gjurmës së projektit të auditimit. Gjurma e auditimit është dokumentimi i procesit të realizimit të Projektit të Auditimit. Evidentimi i zbatimit të procedurave të auditimit nëpërmjet dokumentimit përfshin të gjitha fazat e kryerjes së Projektit të Auditimit që nga Planifikimi i Auditimit, Puna në Terren, Raportimi i Auditimit, Ndjekja e Rekomandimeve dhe Publikimi i Auditimit. Theksojmë se nga ana jonë janë audituar pothuajse të gjitha fondet, me metodat si më poshtë: *Kontrolli aritmetik, Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimeve, Konfirmimi nga të tretët, Kontrolli sipas një treguesi, Intervista, Raporte dhe Informacione, Praktikrat e ndjekura në kryerjen e auditimit*

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231). Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrolleve është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja<sup>2</sup>.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst, procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënive ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose në trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetentë dhe të mirë informuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

---

<sup>2</sup> Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm \* Risku i kontrollit \* Risku i Zbulimit

## 9. Dokumentimi i auditimit

Mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 "Dokumentimi i auditimit", nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

## III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

### 1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Has

#### 1. Informacioni i Përgjithshëm:

Auditimi në Bashkinë Has u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan disa të meta e dobësi në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në drejtim të raportimit financiar, të menaxhimit të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, menaxhimit, inventarizimit dhe hipotekimit e pronave/aseteve.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin dhe realizimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave për shpenzimet dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

**Zona Gjeografike:** Bashkia Has kufizohet në veri dhe perëndim me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Kukës dhe në lindje me Republikën e Kosovës. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Krumës.

**Historik i zhvillimit ekonomik:** Bashkia Has përbëhet nga 4 Njësi Administrative. Bashkia ka nën administrimin e saj një qytet dhe 29 fshatra. Pasuritë nëntokësore të këtij rajoni kanë nisur të shfrytëzohen në vitet '30 nga italianët. Deri në mesin e viteve '90 ka funksionuar miniera dhe fabrika e pasurimit të bakrit në Golaj, 6 kilometra larg qytetit të Krumës si dhe disa miniera më të vogla, ku ishin të punësuar mbi 3000 punëtorë. Jo vetëm banorët, por edhe specialistët thonë se nëntoka ende nuk është prekur. Për mineralin e bakrit dallohen zona Nikoliq Golaj, Krumë dhe Zahrisht në rrethin e Hasit. Relievi i zonës shtrihet nga rreth 300 metra mbi nivelin e detit deri në malet e larta të Gajrepi, Pashtrikut dhe Maja e Kunorës, të cilat gjenden në lartësitë 1400-1900 metra mbi nivelin e detit.

Misioni i Bashkisë Has është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

**Rëndësia e këtij auditimi** është sepse, auditimi është pjesë jetike e një sistemi rregullator, që ka për qëllim të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, si edhe shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur që subjekti i audituar të ndërmarrë veprimet korrigjuese sipas rastit, të rritë përgjegjshmërinë në llogaridhënie, rikuperimin e dëmeve

të shkaktuara, si dhe parandalimin e shkeljeve me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve

## **II. 1 Auditimi i vlerësimit të funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm.**

**II.1.1** Mbi Identifikimin dhe vlerësimin e nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike për periudhën e aktivitetit viti 2024.

### **1. Mbi kontrollin e brendshëm financiar publik**

**1.1** Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një koncept i rëndësishëm, i cili bazohet në krijimin e sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm, për të ndihmuar menaxherët në arritjen e objektivave, marrjen e vendimeve të përshtatshme dhe përcaktimin e përgjegjësive për zbatimin e tyre.

Ky auditim u krye për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga stafi i Bashkisë Has, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

#### **Komponenti “Mjedisi i kontrollit”**

Ky komponent përfshin integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale të punonjësve.

**Parimi 1** - Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike.

Nëpërmjet këtij parimi është vlerësuar angazhimi i Bashkisë Has në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

-Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se bashkia vepron mbi bazën e rregullores së brendshme miratuar me shkresën nr.1445.prot, datë 25.04.2024 me Vendimin nr. 01, datë 24.04.2024 “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së Bashkisë Has”.

Në këtë dokument, janë përcaktuar parimet, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për strukturat e institucionit. Konstatohet se është rishikuar rregullorja e brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore për Njësinë e Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Has, e miratuar me Urdhrin nr. 02,

datë 19.11.2024 “Për Ndryshim të Rregullores së Brendshme për Njësinë e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Has”

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga sektori i burimeve njerëzore rezulton se në rregulloren e brendshme përfshihen 66 pozicione pune të strukturës aktuale përkatësisht:

- 7 pozicione pune me statusin i zgjedhur dhe funksionarë kabinetit;
- 66 pozicione pune me status të nëpunësit civil;
- 227 pozicione pune janë punonjës administrativë dhe rregullohen nga ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

-Bashkia Has ka Kod Etike i miratuar me shkresën nr. 272 prot, datë 22.01.2024 me Urdhër nr. 56, datë 22.01.2024. Për zbatimin e tij bashkia mbështetet në *Ligjin nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, ligji nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”,* i ndryshuar si dhe ligje apo rregulloret specifike që janë krijuar në bazë të një ligji specifik.

-Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se nuk ka asnjë procedurë për raportimin e shkeljeve të rregullave mbi etikën dhe për marrjen e masave si rrjedhojë e kësaj. Mungojnë programet e trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatorë apo kodin e etikës.

-Është hartuar rregullore për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Bashkinë Has në përputhje me *ligjin nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit” e cila është miratuar nga titullari i bashkisë me shkresën nr. 272.prot., datë 22.01.2024, me Urdhër nr. 56, datë 22.01.2024 “Për Hetimin Administrativ të Sinjalizimit dhe Mbrojtjen e Konfidencialitetit në Institucionin e Bashkisë”*.

Gjatë vitit 2024 nuk ka masa disiplinore:

-Për rastet e raportimit lidhur me ankesat për korrupsion, funksionon sektori i çështjeve të anti korrupsionit, ngritur pranë bashkisë, në përputhje me kërkesat e ligjit 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në ushtrimin e Funksioneve Publike", i ndryshuar.

-Njësia përgjegjëse e menaxhimit të burimeve njerëzore bashkëpunon me zyrtarët raportues dhe zyrtarin autorizues në lidhje me performancën dhe sjelljen profesionale të nëpunësve civil.

**Parimi 2** -*Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.*

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

-Për vitin 2024, situata paraqitet efektive, vlen të theksohet raportimet e rregullta periodike nga drejtoritë e bashkisë, raportim i cili nuk ka qenë i përqendruar vetëm në çështjet financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performance dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva gjë e cila evidenton nevojën e miratimit të një procedure të shkruar mbi rregullat e raportimit në institucion.

Titullari i Bashkisë mbikëqyr projektimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

-Rezultojnë Raporte nga Njësia e Auditimit të Brendshëm lidhur me monitorimin e kontrollit të brendshëm të institucionit të cilat janë të miratuara nga titullari.

-Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, dhe nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese.

**Parimi 3** - *Titullari / NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.*

Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organigramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësiwe funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit të delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit / Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.

- Bashkia Has ka rregullore të brendshme të miratuar dhe publikuar nga titullari për veprimtarinë e institucionit, përfshirë të gjitha autoritetet, përgjegjësitë menaxheriale dhe operacionale, linjat e raportimit sipas strukturës organizative si dhe bazën ligjore për të gjithë veprimtarinë e bashkisë.

- Bashkia nuk ka një miratuar një plan strategjik me objektiva dhe prioritete në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor.

-Me Vendimin nr. 1, datë 04.01.2024 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Has” për vitin 2024, titullari ka miratuar strukturën e përbërë nga 300 (treqind ) punonjës, Kjo strukturë ka ndryshuar me vendimin nr. 01/3, datë 22.08.2024, e përbërë nga 300 (treqind) punonjës.

-Përgjatë vitit 2024 janë rekrutuar 103 punonjës të rinj dhe janë larguar 55 punonjës.

**Tabela nr.1:** Struktura e Bashkisë Has për vitin 2024

Numri i të punësuarve në strukturën e miratuar	300	Nëpunës Civilë	66
		Nëpunës me kontratë	227
		Të zgjedhur	7

Burimi: Sektori i Burimeve Njerëzore Has, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Nga auditimi konstatohet se është rishikuar rregullorja e brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore e për rrjedhojë ka çdo drejtori, sektor apo njësi, përgjegjësi dhe detyra të mire përcaktuara.

- Rezulton se delegohen përgjegjësitë brenda bashkisë nga ana e menaxherëve nëpërmjet urdhrave të delegimit por nuk analizohen risqet që lidhen me funksionet dhe kompetencat e deleguara.

- Evidenca të analizës së riskut ka vetëm nga Njësia e Auditit të Brendshëm.

**Parimi 4** -Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave.

Ky parim vlerëson angazhimin e njësive publike për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësisë.

-Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale e cila ka të dhënat për marrëdhëniet e punës, librezat e punës, rekrutimin, trajnimet, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë.

Nga Sektori i Burimeve Njerëzore është ngritur Komiteti i Vlerësimit dhe të Përshkrimeve të Punës më shkresën nr. 3286.prot, datë 15.10.2024 me Urdhër nr. 455/1, datë 15.10.2024. Përshkrimet e punës nuk janë rishikuar periodikisht edhe pse bashkia ka ndryshuar strukturën e saj. Nuk janë kryer vlerësimet periodike të punonjësve nga menaxherët në lidhje me arritjen e objektivave dhe respektimin e Kodit të Etikës.

-Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Sektori i Burimeve Njerëzore mbi rekrutimet dhe largimet, rezultoi se përgjatë vitit 2024 janë rekrutuar 103 punonjës të rinj dhe janë larguar 55 punonjës.

-Për sa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, gjatë vitit 2024 bashkia ka hartuar një plan vjetor të trajnimeve për të gjithë punonjësit pjesë e Shërbimit Civil me shkresën nr. 3383/1.prot, datë 07.11.2024 drejtuar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) të cilët bëjnë vlerësimin e nevojave për trajnim, ku të përfshihen seanca trajnimi

në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Për vitin 2024 janë kryer trajnime ku kanë marrë pjesë nëpunës të institucionit sipas sektorëve përkatës.

-Bashkia Has nuk disponon një regjistër të detajuar për regjistrimin e trajnimeve të kryera nga nëpunësit e institucionit por parashikohen fonde në buxhet për trajnime në fusha të ndryshme.

- Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 12, 13 të ligjit 114/2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe VKM nr. 160 datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit”.

**Parimi 5** -Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale

Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësive dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm.

-Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi, rezulton se bashkia nuk i ka të përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale për hartimin dhe monitorimin e objektivave strategjike në dokumentin e rregullores së brendshme.

-Gjithashtu, evidentohet se njësia publike nuk ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë. Një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ndikon në efektivitetin e përcaktimit të përgjegjshmërisë menaxheriale, është edhe përfaqësimi i rregullt në Grupin e Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.

Për vitin 2024, është hartuar shkresa me nr. 79 prot, datë 08.01.2024 me Vendimin nr. 1, datë 08.01.2024 “Për Ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP) për hartimin e PBA-së 2024-2026, Bashkia Has” si dhe ndryshimet e bëra me shkresën nr. 3734.prot., datë 19.11.2024, me Vendimin nr. 02, datë 19.11.2024 “Për Ndryshim në Ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP) për Hartimin e PBA-së 2024-2026, Bashkia Has”.

Gjatë vitit 2024 rezultojnë mbledhje të GMS por nuk ka procesverbale të mbajtura si dhe Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk është njoftuar për mbledhjet e realizuara, kjo për te siguruar transparencë dhe përgjegjshmëri në vendimmarrjen e proceseve të ndryshme.

GMS luan një rol kyç për sa i takon integritetin të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike.

Për vitin 2024, është përcjellë në MFE “Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë Bashkia Has dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm” me shkresën nr. 728.prot, datë 28.02.2025.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu III, neni 20.

-VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, Kreu II. “Dosja e Personelit”;

-“Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.1, Kapitulli IV “Plani i veprimt të menaxhimit financiar dhe të kontrollit”, Kapitulli V, Aneksët.

**I. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”**

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të

mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

**Parimi 6** – *Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva.*

Ky parim paraqet një pamje të elementëve bazë të nevojshëm për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët / NA / Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë.

- -Dokumenti përfundimtar i Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak (VKB) nr. 35, datë 22.12.2024.

Është e rëndësishme që të ketë një lidhje në mes të planeve vjetore të punës me planin strategjik të njësisë publike. Lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike.

Në planin vjetor të punës çdo njësi publike do të zhvillojë objektivat dhe aktivitetet të cilat duhet të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike për të cilat ata janë përgjegjës.

**Parimi 7** – *Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave.*

Megjithëse analiza e riskut mund të fillojë nga niveli i lartë menaxherial ose në një funksion operativ, çelësi është ekzistenca e një procesi të përgjithshëm për të përcaktuar se si identifikohen dhe menaxhohen risqet në të gjithë njësinë publike.

-Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi rezulton se bashkia nuk ka përcaktuar mekanizma të organizuar dhe funksionalë të procesit të menaxhimit të riskut.

-Nuk është hartuar strategjia dhe regjistri i risqeve, ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Has si dhe në monitorimin dhe raportimin në mënyrë periodike të risqeve me impakt të lartë me qëllim menaxhimin efektiv të tyre.

-Titullari i bashkisë ka ngritur Urdhër nr. 3/1, datë 16.01.2025 për “Menaxhimin dhe Koordinimin e Riskut në Bashkinë Has” për përcaktimin e grupit koordinues teknik për procesin e menaxhimit dhe raportimit mbi risqet.

- Nuk ka plan-veprime për menaxhimin e riskut.

**Parimi 8** – *Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve.*

Mashtrimi ekziston (ose mund të ndodhë) në shumicën e njësive publike. Ekzistenca e një risku të tillë të rëndësishëm ka bërë që formati i përditësuar i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistrit të riskut të përfshijë vlerësimin e riskut të mashtrimit duke theksuar se duhet të merret parasysh për çdo objektiv.

-Nga auditimi evidentohet se Bashkia Has nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.

**Parimi 9**- *Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme*

Ndryshimi është i vazhdueshëm në të gjitha njësitë publike. Ato duhet të kenë një proces formal për të identifikuar ndryshimet e rëndësishme, të brendshme dhe të jashtme, si dhe të vlerësojnë risqet dhe qasjet për të minimizuar riskun në kohë.

-Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi rezulton se efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivel mesatar.

-Bashkia Has ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni për rrjedhje këto ndryshime strukturore apo

menaxheriale janë ndjekur nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualët e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës.

*Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:*

*-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu III, neni 21, pika 2;*

*-Udhëzimi nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 3 “Përgjegjësitë dhe detyrat e KR”, pika 3.2.1 “Titullari i njësisë publike” pika 4 “Hapat për ngritjen e sistemit të MR” -“Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.2, Kapitulli V, Anekset.*

## **II. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”**

Veprimtaritë e Kontrollit përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.

Parimi 10 – Njësia Publike për zgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.

Nuk ka "zgjedhje ideale" në zgjedhjen e aktiviteteve të duhura të kontrollit. Përkundrazi, aktivitetet e kontrollit, ose një kombinim i aktiviteteve të kontrollit (politikave, procedurat dhe përgjegjësitë) duhet të zgjidhen për të zvogëluar në mënyrë të mjaftueshme riskun e mosrealizimit të objektivave në një nivel të pranueshëm. As menaxhimi dhe as auditimi i brendshëm nuk duhet të fillojnë një analizë të aktiviteteve të kontrollit me një listë të kontrolleve dhe të identifikojnë nëse janë të pranishëm apo jo. Përkundrazi, kontrollet duhet të vlerësohen në raport me risqet që duhet të minimizohen.

-Në vijim të auditimit të kryer, mund të themi se ka problematika për t'u adresuar, të cilat lidhen kryesisht me mungesën e hartave apo manualeve të proceseve të punës dhe sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësi.

Përgatitja e një harte me proceset e punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij.

-Nga të dhënat e vëna në dispozicion, rezultojnë se asnjë prej drejtorive nuk ka hartë dhe manual të proceseve të punës.

-Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ sipas sistemit të dy firmave, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

-Nga komunikimi me punonjësit e Drejtorisë së Burimeve rezultojnë se ekzekutimi dhe regjistrimi i transaksioneve financiare nuk bëhen nga i njëjti person. Detyrat janë të ndara. Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga nëpunësi zbatues, regjistrohet nga specialisti i buxhetit dhe miratohet nga nëpunësi zbatues. Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga specialisti për kontabilitetin dhe autorizimi i pagesës kryhet nga nëpunësi autorizues.

-Në zbatim të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, bashkia ndjek procedurat për organizimin e prokurimeve, kanë komisione për prokurim, komisione për hartimin e specifikimeve teknike, komisionin e vlerësimit të ofertave, komisionin për pranimin e mallit etj..

-Në zbatim të Udhëzimit nr. 01 datë 05.01.2018 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të PP dhe krijimi i tyre në sistemin e PP” është hartuar dhe miratuar regjistri i prokurimeve.

-Bashkia Has ka krijuar një regjistër aktivesh i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet.

-Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat. Nuk ka asnjë procedurë të miratuar nga titullari dhe gjurmë auditi për inventarizimin, tjetërsimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktivëve afatgjata materiale. Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike” i ndryshuar.

#### Gjurma e auditimit

Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

Qëllimi i përgjithshëm i gjurmës së auditimit është të ndihmojë menaxhimin të vlerësojë përshtatshmërinë e sistemeve të MFK-së në kuadër të një procesi të caktuar si dhe të identifikojë boshllëqet, mbivendosjet, ose dublimet ndërmjet strukturave të ndryshme të njësisë. Titullarët e njësisë publike miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë.

-Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se, bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi të miratuara për proceset kryesore të punës.

Gjurma e auditimit duhet të ndërtohet dhe rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.

Në Drejtorinë e Financës janë përcaktuar dhe ndarë detyrat për çdo specialist, dhe miratohen konform ligjit nga përgjegjësi i sektorit dhe n/zbatues në vijim nga nëpunësi autorizues.

Specialisti i buxhetit kryen gjithë procedurën për regjistrimin e çeljeve të fondeve dhe pakësimin të tyre në Microsoft Access.

Specialisti i kontabilitetit kryen gjithë regjistrimet e aktiveve në sistemin Acces, shtesat pakësimet, amortizimet, etj., janë të regjistruara në këtë sistem.

Specialisti i pagave mban liste pagesat për çdo sektor kontabilizimet e pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe TAP, harton dhe nënshkruan gjithë urdhërpagesat që kryhen nga ky sektor. Në vijim çdo dokument kontrollohet dhe miratohet pastaj regjistrohet në sistem konform Udhëzimit të MF Nr. 24, datë 29.08.2019 “Për Përdorimin e Arkivës Elektronike në Procesin e ekzekutimit të Buxhetit të Shtetit nga Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, të Ndryshuar.

Parimi 11 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë

Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo organizate. Megjithatë, ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit, mungesës së kujdesit në testimin e softuerit ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë. Çdo organizatë duhet të identifikojë kontrollet e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme.

- Bashkia Has ka sisteme funksionale të IT-së të ndryshme nga ato fikse (pra sisteme qeveritare si APP, SIFQ, PBA, HRMIS).

- Nga auditimi rezulton se bashkia nuk ka një procedurë të rikuperimit dhe të ruajtjes, back-up- it. Bashkia Has për vitin 2024 ka vendosur procedura për të siguruar vazhdimësinë e veprimeve kundrejt risqeve kryesore që mund të pengojnë këtë veprimtari. Pra, ka plane të vlerësimit të riskut për Bashkinë Has, për sigurinë e aktiveve nga zjarri/përmytjet dhe rimëkëmbjet nga fatkeqësitë miratuar nga titullari i institucionit me nr. 874/1.prot, datë 26.09.2024.

Parimi 12 – Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave.

Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë.

-Bashkia nuk i ka ndarë/përcaktuar qartazi përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar. Nuk ka procedura të shkruara operative për vlerësimin, përzgjedhjen, konstatimin dhe monitorimin e investimeve.

*Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:*

*-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu II, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1;*

*-Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 5.2.7 “Monitorimi dhe Raportimi”;*

*-“Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.3, Kapitulli V, Aneksët.*

### **III. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”**

Informimi dhe komunikimi përfshin identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.

Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara.

Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë. Në lidhje me komunikimin e jashtëm, Bashkia Has ka një faqe zyrtare ëeb në të cilën paraqiten informacione për publikun. Nga kërkimi i ndërveprimit të tij me qytetarët, konstatohet se në faqen ëeb Bashkia Has ka programin e transparencës, në zbatim me *ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”* ku në nenin 4 përcaktohet se ‘Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga 19 hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim të një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni’. Gjithashtu, Bashkia Has ka edhe regjistrin me kërkesat dhe përgjigjet e qytetarëve, në zbatim me këtë ligj ku në nenin 8 përcaktohet se “Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre.

Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuesve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër”.

Parimi 13 - Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

-Në vijim të auditimit, rezulton se bashkia i kushton rëndësinë e duhur përcjelljes së informacionit dhe raportimit. Bashkia ka një sistem komunikimi si brenda dhe jashtë institucionit dhe ky sistem jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

-Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit.

-Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.

-Institucioni operon me program të vetin të kontabilitetit, në përputhje me udhëzimet dhe ligjin e kontabilitetit të pasqyrave financiare.

Parimi 14 - Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm

Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

-Për sa i përket krijimit dhe përdorimit të linjave të brendshme të komunikimit, nëpunësit e bashkisë sqarojnë se të gjitha vendimet, projektet, proces verbalet e mbledhjeve komunikohen punonjësve në rrugë zyrtare.

-Faqja zyrtare e institucionit përditësohet rregullisht dhe punonjësit kanë e-mail zyrtar.

-Drejtuesit e institucionit njoftohen nëpërmjet shkresave sa herë që ka alokime fondesh.

Parimi 15 - Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.

-Bashkia Has siguron qasje publike nëpërmjet publikimit rregullisht në faqen e internetit të njësisë të informacionit.

-Institucioni realizon konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Për vitin 2024 janë zhvilluar 2 dëgjesa publike në Bashkinë Has. Dëgjesa Publike janë zhvilluar në lidhje me Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Has, Hartimi i Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, Miratimi i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has për vitin 2025 për vitin 2025 dhe Plani i Përmirësimit të Arsimit Parashkollor për vitin 2024 sipas kalendarit të mëposhtëm:

- Pallati i Kulturës, në datë 11.12.2024 ora 11.00

- Pallati i Kulturës, në datë 16.12.2024 ora 13.00

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-*Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu III, neni 23, “Informacioni dhe Komunikimi” pika 2;*

-*“Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.*

**IV. Komponenti: “Monitorimi”**

Monitorimi realizohet përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm

Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herë pas herë të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.

-Nga auditimi i kryer, konstatohet se institucion nuk ka përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave, ende nuk janë hartuar manuallet e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.

-Bashkia Has monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokumenti i cili është dërguar në Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë MFE. Për periudhën nën auditim, rezulton se Bashkia Has ka plotësuar pyetësorin e vetëvlerësimit e cila i është dërguar Ministrisë së Financave ( DHMFK) me shkresën nr.728 prot, Datë28.02.2025. Për vitin 2024 rezulton se nëpunësi autorizues i Bashkisë Has ka hartuar deklaratën dhe raportin mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në zbatim me nenin 18 të ligjit për MFK-në.

Për vitin 2024 nga Sektori i Burimeve Njerëzore në Bashkinë Has është hartuar plani vjetor i trajnimeve në përputhje me *Ligjin nr. 10296 datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*.

-NJAB ka hartuar Planin Strategjik të Auditimit të Brendshëm, raportin vjetor dhe raportet e auditimit për çdo auditim të kryer përgjatë vitit 2024.

Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë

Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi.

-Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve .

*Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:*

*-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu III, neni 24, “Monitorimi” pika 1;*

*-“Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.5, Kapitulli V, Anekset.*

### **Sa më sipër, arrihet në konkluzion se:**

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK, nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm nuk funksionojnë, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:

#### **Komponenti “Mjedisi i kontrollit”**

-Nga auditimi konstatohet se është rishikuar Rregullorja e Brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore e për rrjedhojë ka çdo drejtori, sektor apo njësi, përgjegjësi dhe detyra të mire përcaktuara;

-Ka procedurë për raportimin e shkeljeve të rregullave mbi etikën dhe për marrjen e masave si rrjedhojë e kësaj. Mungojnë programet e trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore apo kodin e etikës;

-Titullari i bashkisë nuk ka miratuar plan për menaxhimin e risqeve të nivelit të mesëm e të lartë.

-Bashkia nuk ka miratuar një plan strategjik me objektiva dhe prioritete në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor;

- dosjet personale të punonjësve të rekrutuar kanë mangësi në dokumentacion dhe mungesa si: librezat e punës, trajnimet, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë, etj.

-Gjithashtu, evidentohet se njësia publike nuk ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë;  
Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

-Për vitin 2024 nuk është hartuar strategjia dhe regjistri i risqeve, ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Has si dhe në monitorimin dhe raportimin në mënyrë periodike të risqeve me impakt të lartë me qëllim menaxhimin efektiv të tyre;

Titullari i bashkisë ka ngritur Urdhër nr. 3/1, datë 16.01.2025 për “Menaxhimin dhe Koordinimin e Riskut në Bashkinë Has” për përcaktimin e grupit koordinues teknik për procesin e menaxhimit dhe raportimit mbi risqet.

-Nuk ka plan-veprime për menaxhimin e riskut.

Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”

-Bashkia Has ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni për rrjedhojë këto ndryshime strukturore apo menaxheriale janë ndjekur nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualet e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës;

-Mungojnë hartat dhe manualet e proceseve të punës dhe sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësi;

- Bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi të miratuara për proceset kryesore të punës.

Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

-Faqja zyrtare e institucionit përditësohet rregullisht dhe punonjësit kanë e-mail zyrtar.

-Bashkia siguron qasje publike nëpërmjet publikimit rregullisht në faqen e internetit të njesisë të informacionit.

Komponenti: “Monitorimi”

-Bashkia Has ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit.

-Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

**Konkluzion:** Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se Bashkia Has nuk ka një miratuar një plan strategjik me objektiva dhe prioritete në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe nuk ka hartuar plane vjetore të punës për të gjitha drejtoritë.

Për vitin 2024 nuk është hartuar strategjia dhe regjistri i risqeve, ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Has si dhe në monitorimin dhe raportimin në mënyrë periodike të risqeve me impakt të lartë me qëllim menaxhimin efektiv të tyre si dhe nuk ka hartuar plan-veprime për menaxhimin e riskut.

Mungojnë programet e trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatorë apo kodin e etikës. Titullari i bashkisë nuk ka miratuar plan për menaxhimin e risqeve të nivelit të mesëm e të lartë.

Bashkia nuk ka miratuar një plan strategjik me objektiva dhe prioritete në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor. Gjithashtu, evidentohet se njësia publike nuk ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë.

Mungojnë hartat dhe manualet e proceseve të punës çka sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësiive. Bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi të miratuara për proceset kryesore të punës.

Këto veprime janë në kundërshtim me *Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; VKM-në nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”;* *Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”;* *Manualin e MFK-së, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.*

### ➤ **Auditi i Brendshëm.**

#### **2.1.2 Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm;**

#### **2.1.3 Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm**

Dokumentacioni që u analizua për të vlerësuar veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm është si vijon:

- Karta e Auditimit të Njësisë AB të Bashkisë Has;
- Plani Strategjik dhe Vjetor, si dhe pasqyrat shoqëruese;
- Programimi i auditimeve për vitin 2024;
- Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm;
- Dosjet e përthshme të subjekteve të audituara;
- Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.
- Vlerësimi i auditimeve.

Auditimi u krye referuar akteve ligjore e nënligjore si më poshtë:

*-Ligji Nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar;*

*-Ligji Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”;*

*-VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”;*

*-Manuali i “Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016;*

*-VKM nr. 160, datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike” i ndryshuar;*

*-Udhëzimi Nr. 42, datë 27.10.2020 “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”;*

*-Urdhri nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”;*

*-Normat Tekniko Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.*

*Auditimi u fokusua kryesisht në këto çështje:*

- Organizimi dhe funksionimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm/Komitetit të Auditimit, niveli profesional i audituesve, certifikimi i tyre dhe trajnimet e detyrueshme, bashkëpunimi me

Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, niveli i raportimit në këtë drejtori,

-Realizimi i treguesve të planifikuar nga DAB,

-Sigurimi i cilësisë së auditimit, me qëllim vlerësimin nëse veprimtaria e auditit të brendshëm është në përputhje me kriteret ligjore dhe standardet e auditimit, konkretisht *Ligjin Nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, “Manualin e Auditimit të Brendshëm”,* miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100 datë 25.10.2016, *Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.*

Nga auditimi i kryer mbi funksionimin e NJAB të Bashkisë Has, rezultoi se:

**Organizimi dhe funksionimi: Konkluzion:** Për vitin 2024 Njësia e Auditit të Brendshëm ka funksionuar pjesërisht me 2 (auditues). Sipas strukturës organizative të përcaktuar nga Titullari i Bashkisë me *Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 34, datë 22.12.2023, “Për Numrin e Punonjësve të Bashkisë, Institucioneve në vartësi, Njësive Administrative dhe Klasifikimin e Pagave të Administratës dhe Punonjësve të Tjerë për vitin 2024, Bashkia Has”,* struktura e Njësisë së Auditit të Brendshëm është e përbërë nga 1 përgjegjës dhe 2 specialistë auditit.

Sipas VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” pika 3, përcakton se: “*Njësia e Auditimit të Brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3(tre) punonjës, përfshirë drejtuesin e njësisë. Në strukturën e Njësisë së Auditimit të Brendshëm mund të punësohen deri 1/3 e punonjësve të pa certifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik.*”

Struktura e Bashkisë Has është miratuar me shkresën nr. 165.prot, datë 15.1.2024, me Urdhër nr. 35, datë 15.1.2024 “Për miratimin e Strukturës, Organigrama e Bashkisë Has, viti 2024”.

**Konkluzion:** Pra, struktura e miratuar me VKB-në nr. 34, datë 22.12.2023 është në mbështetje të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” pika 3 e cila përcakton se: “*Njësia e Auditimit të Brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3(3) punonjës, përfshirë drejtuesin e njësisë. Në strukturën e Njësisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri 1/3 e punonjësve të pa certifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik.*”

Detyrat dhe kompetencat e NJAB janë përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Has **Nr. 1445, datë 25.04.2024 me Vendimin nr. 01, datë 25.04.2024 “Për Miratimin e Rregullores për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Bashkisë Has”** ndryshuar me *Rregulloren e Brendshme për Njësinë e Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Has, e miratuar me Urdhrin nr. 02, datë 19.11.2024 “Për Ndryshim të Rregullores së Brendshme për Njësinë e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Has”* mbi bazën e të cilës funksionojnë struktura e Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe të gjitha strukturat e tjera të Bashkisë.

Tabela nr.2: Struktura e NJAB, niveli i arsimit, certifikimi, përvoja dhe trajnimet e audituesve paraqiten sipas tabelës se mëposhtme:

Nr	Periudha 2023	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi ne pune	Vjetërsi auditim/vite në	Certifikimi	Trajnime te vijueshme
1	E. Z.	Audituese	I lartë Master Shkencor	3,5	1	JO	PO
2	S. SH.	Auditues	I lartë Master Shkencor	1	1	JO	JO

*Burimi: Bashkia Has.*

Nga verifikimi i dokumentacionit i dosjeve të punonjësve të strukturës së Auditit të Brendshëm rezulton se Specialistët e Sektorit të Auditimit të Brendshëm nuk janë të certifikuar por kanë ndjekur në mënyrë të vazhdueshme trajnime për kualifikimin profesional, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” nenet 11, “Punësimi i Auditit të Brendshëm” neni 19 “Certifikimi i audituesve të brendshëm” dhe neni 20 “Trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm”.

➤ **Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik**

NJAB në mbështetje të Urdhrit nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrisë të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” ka hartuar “Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” në Bashkinë Has, e cila është miratuar nga titullari me urdhrin nr. 142, datë 12.03.2024.

➤ **Kodi i Etikës për Audituesit e Brendshëm**

NJAB në mbështetje të Urdhrit nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrisë të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” ka hartuar “Kodin e Etikës për Audituesit e Brendshëm” në Bashkinë Has, e cila është miratuar nga titullari me urdhrin nr. 143, datë 12.03.2024.

➤ **Planet Strategjike dhe Vjetore:**

Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik janë hartuar dhe miratuar planet strategjike sipas viteve:

**Për vitin 2024** me shkresën nr. 914/1, datë 28.09.2023 është miratuar Plani Strategjik për vitet 2024 - 2026 dhe Plani Vjetor i auditimeve për vitin 2024.

Plani Vjetor 2024 dhe Plani Strategjik për vitet 2024 - 2026 është dërguar zyrtarisht (por edhe me postë elektronike) në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 914 prot, datë 28.09.2023 në përputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

Është bërë ndryshim i planit strategjik dhe vjetor me Urdhrin nr. 468, datë 28.10.2024, për “Ndryshim të Planit Strategjik dhe Vjetor të Auditimit të Brendshëm, Bashkia Has viti 2024 – 2026” e cila është miratuar nga titullari i bashkisë dhe me shkresën nr. 3459.prot, datë 28.10.2024 është dërguar zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Njësia e AB në Bashkinë Has mbulon me auditim 20 subjekte: ku 2 subjekte janë drejtori, sektorë e inspektorate të tjera në juridiksionin e Bashkisë Has, si Sektori i Edukimit dhe Shërbimeve në Konvikt, Arsimi Parashkollor + QKF, Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH), Administrimi i Pyjeve, Bordi i Kullimit, Gjendja Civile si edhe **3 subjekte Njësi Administrative** në juridiksionin e Bashkisë Has si: NJA Golaj, NJA Fajza, NJA Gjinaj.

**Konstatim:** NjAB në hartimin e këtyre planeve është fokusuar në prioritetin e risqeve të identifikuar, dhe ka marrë në konsideratë respektimin e frekuencës së kryerjes së auditimeve.

Në Planin Vjetor 2024 dhe Planin strategjik 2024-2026 janë parashikuar të auditohen 11 subjekte nga audituesi i cili ka hartuar Planin Strategjik dhe Vjetor të Auditimit duke e bërë të pamundur pasi hartimi i këtij plani ka qenë një planifikim i pabazuar në risk nga audituesi i kaluar dhe nuk është mbështetur në mangësitë që Njësia e Auditimit ka hasur në burime njerëzore si dhe koha në dispozicion për të realizuar auditimet, pasi Njësia e Auditimit ka funksionuar vetëm me një Specialist Auditimi deri në Korrik të vitit 2024.

Nisur nga sa më sipër është bërë kërkesa për ndryshim të Planit Strategjik dhe Vjetor të Auditimit të Brendshëm për periudhën 2024 – 2026, sipas shkresës nr. 3459 prot, datë 28.10.2024 si dhe Urdhrit me nr. 468, datë 28.10.2024 “Për ndryshim të Planit Strategjik dhe Vjetor të Auditimit të Brendshëm, Bashkia Has viti 2024 – 2026” e cila është dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MF.

➤ **Realizimi i Planeve Vjetore:**

Sipas rishikimit të planit, janë realizuar gjithsej 4 misione auditimi në 4 subjekte auditimi, sipas planifikimit.

Tabela nr.3: Realizimi e auditimeve

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga te realizuarat, sipas llojit				Zb.Rek
				Përputhshëri	Financë	Kombinuar	Performancë	
1	Viti 2023	4	4	3			1	

Burimi: Bashkia Has

**Raportimi:** Për veprimtarinë e NJAB Në Bashkinë Has për periudhën objekt auditimi, është raportuar në mënyrë sistematike. Janë hartuar dhe dërguar në NJQHAB te Ministrisë së Financave raportet periodike vjetore të shoqëruara këto me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për veprimtarinë e NJAB, përkatësisht: Me shkresën nr. 515.prot, datë 13.02.2025, është dërguar Raporti Vjetor i Veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm, Bashkia Has për vitin 2024. Të dhënat për realizimet e angazhimeve nga AB për auditimet e kryera paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Tabela nr.4: Realizimi i angazhimeve të auditimit.

Nr	Subjektet e Audituar	Realizimi i angazhimeve të auditimit									
		Auditime të realizuara sipas llojit të tyre								Statusi Angazhimit	
		Gjithsëj	Shërbime të Sigurisë nga të cilat:						Shërbime Këshillimi	Angazhime me kërkesë të titullarit	Angazhime të përfunduara
A. të përputhshëm	A. të performancë		A. financiare	A. tek. Informacionit	A. të kombinuara						
1	Auditimi i detyrimeve të prapambetura	1	1							1	
2	Njësitë Administrative Golaj, Fajza dhe Gjinaj	1		1						1	
3	Spektori i Burimeve Njerëzore	1	1							1	
4	Spektori Juridik dhe Njësia e Prokurimeve	1	1							1	

Burimi: Bashkia Has, përpunuar nga grupi i Klsh-së.

➤ **Gjetje - Rekomandimet**

**Për vitin 2023,** Nga auditimet janë evidentuar 27 gjetje, për të cilat janë dhënë 27 rekomandime, nga të cilat 6 rekomandime për përmirësimin e sistemit, 4 rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor, 7 janë rekomandime të karakterit organizativ, 2 rekomandime për arkëtime, dhe 8 rekomandime të tjera, të cilat në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.5: Gjetje - Rekomandimet nga A.B

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar	Gjithsej në numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
4	Viti 2024	27	20	7	0	0	0	0	0
<b>TOTALI</b>		<b>27</b>	<b>20</b>	<b>7</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

Burimi: Bashkia Has

Tabela nr.6: Të dhënat e gjetjeve sipas fushave të auditimit dhe subjekteve të auditimit

Nr	SUBJEKTI AUDITUAR	GJETJET SIPAS FUSHËS OSE SISTEMEVE NE NUMER									
		Sistemi i prokurimeve, blerjeve & investimeve	Sistemi i pagesave, shpërblyme, trajtime, komisione.	Fondet e sig. Shoq, sig.shendetesore, përkuajtjes shoqërore	Sistemet e tatimeve, taksave, doganave	Sistemet e administrimit pronës, pasurisë	Sistemet e privatizimit, shitjes, qiradhënies	Sistemet e koncesioneve, ankandeve	Sistemet e legalizimeve, Urbanistikës, kthim pronash	Sistemet e kreditimit, subvencioneve	Të tjera
1	Drejtoria e Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore, Detyrimet e Prapambetura										
2	Njësitë Administrative Golaj, Fajza dhe Gjinaj										“
3	Spektori i Burimeve Njerëzore										“
4	Spektori Juridik dhe Njësia e Prokurimeve										“
	<b>Totali</b>										

Burimi: Bashkia Has, përpunuar nga grupi i Klsh-së.

Ndjekja e zbatimi i rekomandimeve për periudhën audituese është bërë sipas përcaktimeve të manualit të A.B. NJAB u ka dërguar Akt Verifikime për zbatimin e rekomandimeve të vitit 2023 me shkresa zyrtare të protokolluara tek zyra e Protokoll- Arkivit, po ashtu u janë dërguar edhe Raportet Finale njëjësive të audituara për informim e zbatim mbi nivelin e zbatimit të tyre dhe në auditimin e radhës është çështja e zbatimit të rekomandimeve të trajtohet si çështje kryesore.

Tabela nr.7: Rekomandimet sipas llojit dhe statusit të realizimit në subjektet e audituara,

Nr	Subjekti Audituar	Rek. të dhëna në vitin 2024	STATUSI I REKOMANDIMEVE				REKOMANDIMET SIPAS LLOJIT					
			Rekomandim i dhënë	Rekomandim i pranuar	Rekomandim i zbatuar	Në proces zbatimi	Rekomandime të përmirësimit e sistemeve	Rekomandime të përmirësimit e kuadrit ligjor	Rekomandime të karakterit organizativ	Rekomandime për arkëtime	Rekomandime të tjera	
1.	Drejtoria e Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore, Detyrimet e Prapambetura	2	2	2	2	0	0	0	0	2	0	
2	Njësitë Administrative Golaj, Fajza dhe Gjinaj	6	6	6	6	0	4	1	1	0	0	
3	Spektori i Burimeve Njerëzore	13	13	13	7	6	0	2	4	0	7	
4	Spektori Juridik dhe Njësia e Prokurimeve	6	6	6	5	1	2	1	2	0	1	
	<b>Totali</b>	<b>27</b>	<b>27</b>	<b>27</b>	<b>20</b>	<b>7</b>	<b>6</b>	<b>4</b>	<b>7</b>	<b>2</b>	<b>8</b>	

Burimi: Bashkia Has, përpunuar nga grupi i Klsh-së.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, rezulton se nga 27 masa të rekomanduara, janë pranuar 27 rekomandime, nga këto 20 rekomandime janë zbatuar, 7 rekomandime janë proces zbatimi, ndërsa rekomandime të pa zbatuara janë 0.

Nga auditimi rezulton se Njësia e Auditimit të Brendshëm ka marrë në shqyrtim dhe ka mbikëqyrur procesin e monitorimit e ndjekjes së rekomandimeve të dhëna nga struktura e auditimit të brendshëm.

Grupi i auditimit ka analizuar ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm me Raportimin Vjetor të Nivelit të Zbatimit të Rekomandimeve me nr. 1147/1.prot, datë 07.04.2025 i cili është dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, në MF me shkresën përcjellëse me **nr. 1147.prot, datë 07.04.2025**, kjo për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Njësia e Auditimit të Brendshëm. Referuar Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.1.13.3 përcaktohet se:

*Një njësi e mirë menaxhuar vendos procedura për t'u siguruar se çdo rekomandim i bërë nga njësia e AB, zbatohet ashtu siç duhet. Njësia e Auditimit të Brendshëm në bashkëpunim me menaxhimin cakton një punonjës me përvojë që të evidentojë të gjitha rekomandimet e bëra nga auditimi i brendshëm dhe të komunikojë, monitorojë dhe informojë për progresin që është bërë për zbatimin e tyre. Kjo do të ndihmojë që të sigurohet se përmirësimi i kontroleve të brendshme është përgjegjësi e menaxhimit të njësisë publike dhe jo rol i Njësisë së Auditimit të Brendshëm”.*

✓ **Vlerësimi i procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm.**

*Nga auditimi i detajuar i dosjeve të auditimeve të kryera në subjektet:*

**Për vitin 2024** dosjet:

1. Drejtoria e Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore, Detyrimet e Prapambetura
2. Njësitë Administrative Golaj, Fajza dhe Gjinaj
3. Sektori i Burimeve Njerëzore
4. Sektori Juridik dhe Njësia e Prokurimeve

***Në lidhje me respektimin e kërkesave të manualit në hartimin e materialeve të auditimit për:***

a-Letrat e punës së auditimit në fazën përgatitore të programit;

b-Letrat e punës në fazën e ekzaminimit të dokumentacionit të subjektit, hartimit të Projekt Raportit dhe Raportit Final nga audituesit;

c- Bazueshmërinë ligjore të gjetjeve, argumentimin e konkluzioneve të nxjerra nga audituesit në përputhje me standardet e auditimit, rezultoi se:

- Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr.100, datë 25.10.2016.

- Subjektet e audituara kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në zbatim të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, Pika 4.1.12. Hapi 11, “Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar”.

- Hartimi i Projekt Raporteve dhe Raporteve Përfundimtare në përgjithësi është bërë sipas strukturës së miratuar në manualin e auditimit.

- Programi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Njësinë e Auditimit të Brendshëm për vitin 2024, nuk është hartuar, miratuar dhe nuk është dërguar pranë Strukturës Përgjegjëse të Harmonizimit në MF.

- Në dosjet e auditimit është “Memo e planifikimit”.

- Në fund të procesit të auditimit ekzistojnë letrat e punës për secilin auditues të cilat duhet të përfshijnë regjistrimin e punës së audituesit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemit.

- Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve janë dhënë opinione për realizimin e rekomandimeve të mëparshme si dhe konkluzioni nga audituesit për masat që duhet të marrë menaxhimi i subjektit të audituar në rastin e mosrealizimit të tyre.

**Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit në dispozicion u konstatua se:**

- Audituesit e brendshëm nuk janë të certifikuar por janë trajnuar në fushat e planifikuara në Planin Strategjik të Auditimit, si edhe kanë kryer trajnime mbi menaxhimin e riskut, element ky i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut;

- Për vitin 2024, konstatohet se është realizuar plani i rishikuar i auditimeve për vitin 2024 nga 11 në 4 auditime.

- Nuk dokumentohet procesi i ndarjes së detyrave/sistemeve për tu vlerësuar, pasi Njësia e Auditimit të Brendshëm ka funksionuar vetëm me një punonjës auditimi për vitin 2024, sipas drejtimeve të auditimit për secilin anëtar të grupit të punës në kundërshtim me pikën 4.1.1.2 të MAB, dokument ky i nevojshëm për vlerësimin e punës për secilin auditues.

-Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve janë dhënë opinione mbi realizimin e rekomandimeve të lëna nga Njësia e Auditimit të Brendshëm për vitin 2024 me Raportimin Vjetor të Nivelit të Zbatimit të Rekomandimeve me nr. 1147/1 prot, datë 07.04.2025 i cili është dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, në Ministrinë e Financave, me shkresën përcjellëse me nr. 1147.prot, datë 07.04.2025.

**Pretendimi i subjektit:** Lidhur me konstatimin për sa më sipër Sektori i Burimeve Njerëzore ka sjellë observacion të dërguar me shkresë 1927/2, datë 15.08.2025, protokolluar në KLSH me nr 466/5, datë 21.08.2025, në të cilin citohet:

*Sektori i Burimeve Njerëzore do të marrë masa për plotësimin e vendeve vakant në NJAB.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Për sa citohet me sipër pranohet konstatimi ynë, rrjedhimisht qëndrimi i grupit të auditimit mbetet i pandryshueshëm.

**Konkluzion:** Si përfundim konstatohet se: Veprimtaria e Njesisë së Auditimit të Brendshëm është në mos përputhje me kuadrin rregullator dhe me standardet ndërkombëtare për praktikat profesionale të auditimit të brendshëm, duke qenë në kushtet kur kjo strukturë ka funksionuar gjysmën e vitit 2024, me 2 auditues (si trajtuar më sipër), pa përgjegjës sektori, dhe njëkohësisht pa eksperiencën e nevojshme. Për këtë periudhë auditimi, mban përgjegjësi, Titullari aktual i Bashkisë Has.

**II/2. Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare.**

**2.1.** Auditimi i përkatësisë, plotësisë dhe saktësisë së paraqitjes së aktiveve afatgjata në pasqyrën e pozicionit financiar. Regjistrimi fillestar dhe klasifikimi i tyre.

**2.2.** Auditimi i saktësisë dhe raportimit të paraqitjes në pasqyrën e pozicionit financiar të llogarive të arkëtueshme dhe llogarive të pagueshme

**2.3.** Auditimi i plotësisë dhe saktësisë së pasqyrës së performancës financiare mbi realizimin dhe regjistrimin e të ardhurave nga burimet e veta dhe transfertat dhe mbi realizimin dhe regjistrimin e shpenzimeve.

Për auditimin e pikës 2 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Pasqyrat financiare të vitit 2024 të shoqëruar me formatet 1-9.
2. Dokumente kontabël si: ditarët e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj., centralizatori, bilanci vërtetues.
3. Dokumentacioni i kryerjes së inventarëve të aktiveve 2024, libri i aktiveve.
4. Urdhër-shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur për vitin 2024.
6. Akt-rakordimet me Degën e Thesarit Has në mbyllje të vitit buxhetor 2024.
8. Të tjera dokumente mbështetëse (data bazë të ndryshme ne programet “Excel” si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet te ardhurat etj.).

### **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:**

- Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:

Për vitin 2024 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Has” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5 datë 21.02.2022, VKM Nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”.

**2.1.** Auditimi i përkatësisë, plotësisë dhe saktësisë së paraqitjes së aktiveve afatgjata në pasqyrën e pozicionit financiar. Regjistrimi fillestar dhe klasifikimi i tyre.

**2.2. Auditimi i saktësisë dhe raportimit të paraqitjes në pasqyrën e pozicionit financiar të llogarive të arkëtueshme dhe llogarive të pagueshme.**

Për të arritur në opinionin, në se pasqyrat financiare për vitin 2024, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare, aktiveve neto dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht *udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”*, i ndryshuar, u analizuan pasqyrat financiare të vitit 2024, konkretisht:

### **2.2 Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare.**

- **Pjesë përbërëse të Pasqyrave Financiare të vitit 2024 janë:**

- Pasqyra e pozicionit financiar (F1);
- Pasyra e performancës financiare (F2);
- Pasqyra e flukseve monetare (F3);
- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4);
- Pyetësor dhe shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare (F5);

*Pasqyrat statistikore:*

- Investimet dhe burimi i financimit (F6);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, kosto historike (F7.a);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, vlera neto (F7.b);
- Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (F8);
- Gjithashtu është dhënë informacion mbi:
  - Emrin e njësisë ekonomike raportuese, Bashkia Has me NIPT - K46919505P
  - Periudhën kontabël të mbuluar nga pasqyrat financiare, nga 01.01.2024-31.12.2024;
  - Monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare, në lekë;
- Përgatitur nga znj. G. B. regjistruar, z. S. M. nëpunës zbatues z. M. D. nëpunës autorizues.

- **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:**

Pasqyrat Financiare janë hartuar për Degën e Thesarit Has me *shkresën nr. 1095, datë 27.03.2025*, nënshkruar nga G. B., Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Buxhetit dhe z. S. M. nëpunës zbatues.

Dërgimi i pasqyrave financiare në mënyrë elektronike në thesar është kryer me datë **16.04.2025** konfirmuar nga dega e thesarit datë 21.05.2025, jashtë afateve të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 118. ‘*Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruar të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës.*

*Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi:*

*Z. S.M. nëpunës zbatues Drejtor i Financës dhe Buxhetit.*

*Znj. G. B. Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Buxhetit*

Pjesë përbërëse e dokumentacionit mbi pasqyrat financiare dhe raportimin financiar janë Akt rakordimet mbi shpenzimet dhe të ardhurat me Degën e Thesarit Has të konfirmuara dhe nënshkruara nga NZ dhe NA i Bashkisë Has, si dhe Përgjegjësi i Degës së Thesarit Has.

-Mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike. Në këtë Bashki, kontabiliteti mbahet në mënyrë manuale, çka me risk të lartë për sa i përket sigurisë në saktësinë informacionit që marrim nga ky sistem kontabiliteti.

**Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:**

Për vitin 2024 nga verifikimi i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e Klasës 6 dhe Klasës 2 me akt-rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari vitin 2024) për shumat për çdo llogari dhe në total vjetor konstatohet se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

**Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.**

Për t’u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testimet në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

-Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara për sa i përket vlefshmërisë për t’u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

-Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

-Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

-Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

-Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

-Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditareve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

### **Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:**

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

-Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

-Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhen me veprim ekstra-kontabël.

-Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

-Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

-Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

-Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmbajnë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj.

Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si: faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

-Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

### **Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare të konsoliduara, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Has për aktivitetin ekonomik-financiar **për periudhën 01.01.2024, deri më datën 31.12.2024.**

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur nga Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit si dhe janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2024, të cilat rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2023.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2024 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike. Llogaritja e nivelit të materialitetit paraqitet në anekset bashkëlidhur këtij RPA.)

### **Procesi i inventarizimit:**

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, neni 74, parashikohet se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Auditimi i procesit të inventarizimit është kryer duke u bazuar në gjendjen e aktiveve, shtesat, pakësimet apo nxjerrjen jashtë përdorimit të evidentuara në Pasqyrën nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)”, Pasqyrën nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)”, kartelat sipas personave të cilën kanë aktive në përdorim, urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit, relacionet dhe raportet për gjendjen e inventarit pas përfundimit të procesit të inventarizimit, fletë-hyrjeve dhe fletë-daljet nga magazina etj.

Me urdhrin nr. 489.prot., datë 02.12.2024 të Kryetarit të Bashkisë Has është ngritur grupi i punës për inventarizimin e aseteve të bashkisë Has. Bazuar në të dhënat e formularëve përmbledhës të inventarëve të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk konstatohen diferenca në lidhje me vlerat e kostove historike të aktiveve.

### **Mbi aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të pa trupëzuara.**

a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

*Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.*

b. Kontrolle të llogarive dhe dokumenteve.

Gjendja e llogarive të Pasqyrave Financiare të Bashkisë Has paraqitet si më poshtë:

Tabela 2/3: Aktivi i Bilancit Kontabël 2024

Llogari	EMERTIMI	2024	2023
	<b>AKTIVET</b>	<b>2,301,666,918</b>	<b>2,207,069,425</b>
	<b>I. Aktivet Afat shkurtra</b>	<b>222,142,431</b>	<b>161,532,009</b>
	<b>1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre</b>	<b>72,735,533</b>	<b>48,169,431</b>
520	Disponibilitete ne Thesar	72,735,533	48,169,431
	<b>2.Gjendje Inventari qarkullues</b>	<b>32,684,280</b>	<b>22,226,749</b>
31	Materiale	9,465,722	118,411
32	Inventar I imet	23,218,558	22,108,338
	<b>3.Llogari te Arketushme</b>	<b>116,722,618</b>	<b>91,135,829</b>
423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	914,949	914,949
468	Debitorë te ndryshëm	89,782,727	70,461,011
4342	Operacione me shtetin (Te drejta)	26,024,942	19,759,869
	<b>II. Aktivet Afat gjata</b>	<b>2,079,524,487</b>	<b>2,045,537,416</b>
<b>20</b>	<b>1.Aktive Afatgjata jo materiale</b>	<b>4,568,516</b>	<b>1,754,367</b>
202	Studime dhe kërkime	4,568,516	1,754,367
<b>21</b>	<b>2.Aktive Afatgjata materiale</b>	<b>1,808,007,498</b>	<b>1,859,671,223</b>
210	Toka, Troje, Terrene	1,074,183	1,074,183
212	Ndërtesa e Konstruksione	628,838,227	662,045,813
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	1,098,948,821	1,125,026,150
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	36,024,655	33,306,233
215	Mjete Transporti	25,561,834	22,108,394

218	Inventar ekonomik	7,390,866	5,941,538
24	Aktive afatgjata te dëmtuara	10,168,866	10,168,912
25-26	<b>3.Aktive Afatgjata Financiare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	<b>4.Investime</b>	<b>266,948,473</b>	<b>184,111,826</b>
231	Per Aktive Afatgjata materiale	266,948,473	184,111,826

*Burimi, Bashkia Has.*

## 1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

**Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet = lekë.**

- Aktivet 2,301,666,918 lekë
- Pasivet 135,601,348 lekë
- Aktivet neto 2,166,065,570 lekë

### Aktivi i Bilancit

#### **Aktivet afatshkurtra**

Aktivet afatshkurtra më datë 31.12.2024 paraqiten në vlerën **222,142,431 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 72,735,533 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 32,684,280 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 116,722,618 lekë dhe

Vlera e llogarisë **520 “Disponibilitete në thesar”** paraqitet në pasqyrat financiare në shumën 72,735,533 lekë, e cila përbëhet nga gjendja e fondeve në thesar më 31.12.2024 në shumën 53,856,803 lekë dhe gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" e cila paraqitet në shumën 18,878,730 lekë.

Gjendja prej 53,856,803 lekë përbëhet nga rezultati veprimtarisë ushtrimore i vitit 2024 që mbartet për vitin 2025 e cila përputhet me vlerën e raportuar në pasqyrën e performances financiare.

Mjetet në ruajtje përbëhen nga **18,878,730 lekë**, ndalesat e 5 % te garancisë së punimeve.

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Has në 31.12.2024 paraqiten në vlerën **32,684,280 lekë** dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 9,465,722 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Objekte inventari imët” në vlerën 23,218,558 lekë.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën (-10,457,531) lekë, përbën efektin në shpenzime e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” (*pasqyra F2 – performanca financiare*).

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve, në përputhje me udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, Titullari i Bashkisë Has ka nxjerrë Urdhrin nr. 489, datë 02.12.2024.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

**Llogaritë e arkëtueshme janë në vlerën 116,722,618 lekë** të përbëra nga :

-Llogaria 423-429–Personeli, deficite, gjoba, paradhënie në vlerën prej 914,949 lekë, që përbëhet detyrime të punonjësve i pa ndryshuar nga viti i kaluar;

**Gjendja e llogarisë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba”** paraqitet në të njëjtën vlerë prej 914,949 lekë si në fund të vitit 2023 dhe në fund të vitit 2024. Kjo vlerë është trashëguar nga konsolidimi i pasqyrave financiare të aparatit të Bashkisë Has me ish komunat me reformën territoriale të vitit 2015. Kjo vlerë i përket bilancit të ish-komunës Gjinaj, për të cilën nuk ka

analizë të detajuar dhe nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”.

-Llogaria 468–Debitorë të ndryshëm në vlerën prej **89,782,272 lekë**, për taksa dhe tarifa vendore, si dhe detyrime nga të ndryshme.

Tabela 2/4: Lëvizja e llogarisë 468 debitorë të ndryshëm për vitin 2024

Nr.	Përshkrimi	Vlera/lekë
1	Gjendje e debitorëve me 1.01.2024	70,461,011
2	Shtesa e debitorëve për taksa dhe tarifa e vitit 2024	22,780,171
3	Arkëtimet e debitorëve të bizneseve te viteve te mëparshme.	3,458,455
4=1+2-3	Gjendja e debitorëve me 31.12.2024	89,782,727

Nr	Llogaria	Gjendja 01.01.2024	Shtesa gjatë vitit 2024	Pakësimet gjatë vitit 2024	Gjendja ne fund 31.12.2024	Emërtimi i debitorit
1	468	23,241,868		87,056	23,154,812	Debitorë nga KLSH
2	468	3,268,581		12,000	3,256,581	Debitorë nga APP
3	468	15,215,917	18,983,128	2,077,838	32,121,207	Subjekte Juridike BM
4	468	12,636,841	957,106	314,615	13,279,332	Subjekte Fizike BV
5	468	206,600	-	-	206,600	Institucione buxhetore Taksa vendore
6	468	5,364,206	818,315	151,800	6,030,721	Debitorë nga Markata Krume
7	468	272,145	322,920		595,065	Debitorë për Qira Toke
8	468	10,254,853	1,698,702	815,146	11,138,409	Debitorë Taksa e ndikimit ne infrastrukture
Totali		<b>70,461,011</b>	<b>22,780,171</b>	<b>3,458,455</b>	<b>89,782,727</b>	

*Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has*

Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua se llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” me vlerë 89,782,727 lekë ka kundër parti në “llogarinë 4341” Operacione me shtetin, detyrime”. Gjithashtu, Sektori i Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Has, me gjithë rekomandimet e dhëna në vazhdimësi nga KLSH, nuk ka marrë masa për:

- përditësimin e regjistrit me numrin e saktë të familjeve që kanë detyrimin për të paguar tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, nuk ka të dhëna lidhur me nivelet e pritshmërisë së tyre si dhe nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve që janë debitorë ndaj bashkisë.

Gjithashtu, familjet në Bashkinë Has nuk ngarkohen për detyrimet vendore për taksat dhe tarifave të tjera të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak, si për shembull taksa e tokës bujqësore, taksa e truallit, tarifën e gjelbërimit. Bashkia Has nuk ka agjent tatimor për mbledhjen e taksave/tarifave nga familjet, por i mbledh ato me paraqitjen e qytetarëve pranë zyrave të bashkisë/njësiteve administrative për të marrë shërbime të ndryshme. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore regjistron vetëm të dhëna lidhur me familjet që paguajnë ndërsa për familjet debitorë vazhdon të mos e disponojë këtë regjistër edhe për vitin 2024. Si rezultat, procesi i ngarkimit të familjeve për detyrimet vendore nuk është i dokumentuar si dhe nuk dihet numri i familjeve debitorë dhe vlera totale që ato kanë ndaj bashkisë.

Gjendja e debitorëve progresiv të vitit deri më datë 31.12.2023, rezulton në vlerën 70,461,011

lekë, ku gjatë vitit 2024 janë paguar detyrime në total në vlerën 3,458,455 lekë dhe janë shtuar debitorë në vlerën 22,780,171 lekë, duke sjellë një vlerë të detyrimeve në fund të viti 2024, në shumën 89,782,727 lekë. (të detajuar në tabelën 2.4, Lëvizja e llogarisë 468 debitorë të ndryshëm për vitin 2024).

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me përcaktimet e VKB nr. 33, datë 22.12.2023, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has”, me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10.

Konstatohet një tendencë në rritje e detyrimeve të prapambetura dhe mos marrje masash për arkëtimin e detyrimeve duke rritur “moshën” e borxhit të vjetër dhe duke e vendosur Bashkinë Has para një risku në rritje në mos arkëtimin e të ardhurave të planifikuara vit pas viti, në kundërshtim me Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, Ligjin 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, “Për procedurat tatimore në RSH”.

Nga sektori i Taksave dhe tarifave vendore, nuk janë marrë masa për dërgimin e urdhër bllokimeve dhe monitorimin 30 ditor nga dërgesa e njoftim vlerësimit fillestar mbi detyrimet e lindura për çdo subjekt BM apo BV.

Për këtë mbajnë përgjegjësi: **Përgjegjësi i sektorit të Taksave dhe tarifave vendore D. Ç, dhe specialistët e sektorit: S.Xh. dhe inspektore e tregut dhe taksapaguesve familjarë E.D.**

**-Llogaria 4342-Operacione me shtetin të drejta** (fonde që priten të alokohen në vitin në vijim nga buxheti i shtetit), debituar në vlerën prej 26,024,942 lekë, e cila përfaqëson llogaritë e klasës së 4 të pasivit (si furnitorët, pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, tatim në burim) të pasqyrës financiare të pozicionit financiar.

Tabela 2/6: Detyrimet në fund të vitit 2024 /lekë

Përshkrimi	Mbetja në fund të vitit 2024/lekë
Furnitorë dhe llogari të lidhura me to	1,057,517
Detyrime ndaj personelit për pagat dhjetor	17,974,332
Detyrime ndaj shteti për tatim page	1,161,785
Detyrime ndaj sigurimeve shoq. Për dhjetor	5,121,610
Detyrime për sig.shendetësore.	709,698
Kreditore, Parapagime	
<b>Totali</b>	<b>26,024,942</b>

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has

Për sa më sipër llogaria 4342-Operacione me shtetin të drejta në vlerën 26,024,942 lekë kuadron me llogaritë e detyrimeve të furnitorëve dhe llogarive të lidhura me to dhe detyrimet e pagave dhe sigurimeve dhe tatimit mbi të ardhurat personale detyrime të dhjetorit që paguhen në janar të vitit 2025.

**Aktivet afatgjata** janë në vlerën neto prej **2,079,524,487 lekë**, nga të cilat:

**Aktivet afatgjata jo materiale** në vlerën neto prej 4,568,516 lekë:

-Gjendja e llogarisë 202 “Studime e projekte” në çelje të vitit 2024 gjendjet në vlerën 1,754,367 lekë (Kosto historike – amortizim i akumuluar), ndërsa në fund të vitit 2024 rezulton në vlerën 4,568,516 lekë [(Teprica neto në fillim të vitit 2024 + shtesa gjatë vitit) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2023 + amortizimin e vitit 2024)].

Referuar pasqyrës aneks formati 7/b llogaria 202 “**Studime dhe kërkime**” është me vlere bruto fillestare në fillim të vitit për shumën prej 9,960,627 lekë amortizim i akumuluar në vlerën 8,206,260 lekë dhe tepricë neto në fillim të vitit 2024 për vlerën 1,754,367 lekë. Për vitin 2024

është llogaritur amortizim për llogarinë “studime dhe kërkime” për vlerën 370,420 lekë dhe shtesat gjatë vitit në llogarinë 202 janë në vlerën 4,938,936 lekë. Pakësimet e llogarisë 202 për vlerën 5,203,300 lekë kanë ndodhur për shpërndarjen dhe kapitalizimin në llogarinë 212 për vlerën 512,841 lekë dhe llogarinë 213 për vlerën prej 4,661,400 lekë. Për vitin 2024 pakësimi i kësaj llogarie sipas veprave infrastrukturore janë si më poshtë vijon:

Tabela 2/7: Tabela e shtesave të llogarisë 212 dhe 213 dhe pakësimi i llogarisë 202 studime dhe kërkime /lekë

Ilogaria	Objektet	shtesa/pakësim
213	Ndërtim i Ujit te Pijshëm Thertore +studim projektim preventiv zbatim rikonstruksion thertore bagëtime qyteti Krume	117,000.00
213	Ndërtim i rrugës Trotuar Qytetit Krume,pazari vjetër + studim projektim rehabilitim trotuari rruga pazari vjetër	984,600.00
213	Ushqyes Ujëmbledhës rezervuari Llakaj + studim projektim kanalit ushqyes te kanalit Llakaj	990,000.00
213	Rikonstruksion rruga Pashtriku + studim-projektim rruga pashtrik-rrafsh,sheta,geca,peçaku e sistemim I projektit te tërshërës	684,000.00
213	Rehabilitim I Trotuareve Rruga Pashtriku dhe Trotuare te Brendshëm qytetit Krume	57,000.00
213	Ujesjellesi Cahan-Kishaj-Pogaj +Studim & Projektim Rik Ujësjellësi Cahan	120,000.00
213	Ndërtim trotuare ne segmentet (Krume-Kodër e mdhe, Qender Fshatit Letaj dhe Qender Fshati Vranisht) + studim-projektim ndërtim trotuareve qendra vranisht,kodra e madhe, qendër letaj,rruge malore qender gjinaj,Bjeshkë stanet Gjinaj	673,200.00
213	Ndërtim trotuare ne segmentet (Krume-Kodër e madhe, Qendër Fshatit Letaj dhe Qendër Fshati Vranisht) + hartim projekti për trotuaret nga varrezat tek rezervuari	116,400.00
213	Ndërtim rruga bjeshkës Gjinaj & rikonstruksion I rrugës Gjinaj - Pusi I thate Hartimi I projektit zbatimit - Ndërtim rruge Pusi I Thate	115,200.00
213	Ndërtim kolektori ujërave te zeza Lagje Qerimaj,Gajrep Pla &Pla + Rrjeti kanalizimeve Ujera te Zeza, ne zonën Kodra e Madhe 3km2	804,000.00
	<b>totali llogarisë 213 shtesa</b>	<b>4,661,400.00</b>
212	Rehabilitim pallatet Qyteti Krume + studim-projekt impianti nr3 fizarmonika lagje 1 ne qendër qyteti krume	117,000.00
212	Rindërtim Shkolla 9-Vjecare Letaj	330,000.00
212	Lulishte qytetit Krume + studim-projektim lulishte qyteti Krume	94,800.00
	<b>Totali i llogarisë 212 shtesa</b>	<b>541,800.00</b>
202	<b>Studime Kërkime pakësimi</b>	<b>(5,203,200.00)</b>

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has

Pakësimet e llogarisë 202 janë kryer sipas rekomandimit të KLSH nga auditimi i mëparshëm për objekte të marra në dorëzim përpara vitit 2024.

Shtesa e llogarisë 202 për vlerën 4,938,936 lekë është për projektin “Përgatitje hartim projekt - rehabilitim dhe sistemim i përroit Vrella, rruga rrafshnalta e Pashtrikut, lagjja Sheta, Geca, Pecaku 1, Pecaku 2, fushës rruga e malit të Tërshënës”.

Si përfundim paraqitja sipas të dhënave të DFB-së, i llogarisë 202 “Studime dhe projekte” sipas formatit 7/b është si më poshtë vijon:

Tabela 2/8: Shtesat dhe pakësimet e llogarisë 202 studime projekte për vitin 2024 formati 7/b /lekë

Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fillim 2024	Shtesat gjatë vitit 2024	Amortizim 2024	Pakësimet viti 2024	Amortizim	Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fund vitit 2024
9,960,627	8,206,280	1,754,367	4,938,936	370,420	5,203,200	3,448,833	9,696,363	5,127,847	4,568,516

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has

**Aktivitet afatgjata materiale** në vlerën neto prej 1,808,007,498 lekë ;

-Gjendja e llogarisë 210 “*Toka, troje dhe terrene*”, në çelje të vitit 2024 ka qenë në shumën 1,074,183 lekë, e pa ndryshuar dhe në fund të vitit 2024.

-Gjendja e llogarisë **211 “Pyje, plantacione”**, në çelje të vitit 2024 nuk ka qenë e pasqyruar kjo do të thotë që rezulton në vlerën zero lekë, e pa ndryshuar dhe pa pasqyruar është edhe në fund të vitit 2024, pra **rezulton në vlerën zero lekë**.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga DFB si dhe Drejtoria e Administrimit Pyjor (DAP) për ri aplikimet në ASHK Kukës për pajisjen me certifikatë të rifreskuar të regjistrimit të pronave për vitin 2024 janë pajisur me certifikatë pronësie të rifreskuar pranë ASHK Kukës pronat për pyjet në pronësi të Bashkisë Has si më poshtë vijon:

Tabela 2/9: Certifikata të regjistruara për pyje dhe kullota gjatë vitit 2024

Nr. i pasurisë	Zona kadastrale	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja në m2	Data e certifikatës
44	2283	Pyll	910,129	08.08.2024
6	3012	Pyll	86,855	26.11.2024
9	3012	Pyll	224,201	26.11.2024
1	3012	Pyll	2,558,149	26.11.2024
343	2760	Pyll	283,457	10.08.2024
<b>TOTALI</b>			<b>4,062,791</b>	

*Burimi: Drejtoria e Administrimit pyjor/ Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has*

Theksojmë që të dhënat për certifikatat e pronësisë së pyjeve janë sipas VKM përkatëse në vite, pra nuk i përkasin viti 2024.

Referuar VKM-së nr. 89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” tabelat referuese për vlerat për m2 të pyjeve për bashkinë Has u kryen përllogaritjet e vlerës së aseteve të transferuara me certifikatë pronësie si më poshtë vijon:

Tabela 2/10: Përllogaritja e vlerave të pyjeve dhe kullotave sipas VKM nr.89 vlera në lekë

Nr. i pasurisë	Zona kadastrale	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja në m2	Data e certifikatës	Vlera lekë/ m2 sipas VKM Nr. 89, datë 3.2.2016	Vlera minimale për regjistrim pa rivlerësim të pronës
1	2	3	4	5	6	7=4*6
44	2283	Pyll	910,129	08.08.2024	100	91,012,900
6	3012	Pyll	86,855	26.11.2024	100	8,685,500
9	3012	Pyll	224,201	26.11.2024	100	22,420,100
1	3012	Pyll	2,558,149	26.11.2024	100	255,814,900
343	2760	Pyll	283,457	10.08.2024	100	28,345,700
<b>TOTALI</b>			<b>4,062,791</b>			<b>406,279,100</b>

*Burimi: Drejtoria e Administrimit pyjor/ DFB, Bashkia Has/ përpunoi grupi i auditimit*

Nga auditimi i procesit të kontabilizimit të pronave **llogaria 211 Pyje dhe kullota** të bashkisë Has, u konstatua se Drejtoria e Administrimit Pyjor dhe Drejtoria e Planifikimit dhe zhvillimit të territorit / inspektori i pronave kanë kryer aplikimet në ASHK Kukës vetëm për marrje vërtetimi për prona të regjistruara **gjatë vitit 2020**, për efekt të dhënies së tyre me qira sipas VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave /Bashkive, për 5 certifikata të cituara në material. Grupi i auditimit i vlerësoi këto prona sipas VKM. Nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” tabelat referuese për vlerat për m2 të pyjeve për bashkinë Has, ku nga përllogaritjet me 100 lek/m2, vlera e këtyre aseteve rezulton të jetë **406,279,100 lekë**.

Drejtoria e Administrimit Pyjor nuk ka bashkëpunuar me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit për të dhënat për regjistrimin e pronave pyje pas daljes së certifikatave të pronësisë të cilat janë regjistruar në ASHK Kukës **gjatë vitit 2020, por të rifreskuara pa rivlerësim të tyre, në vitin 2024**. Për sa më sipër llogaria 211 “Pyje dhe plantacione” nuk është pasqyruar saktë në fund të vitit 2024 duke u nën vlerësuar për vlerën **406,279,100 lekë**, veprime në kundërshtim me *Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 19*

“Gjurma e auditimit”, neni 6 germa ç, neni 12 germa ë dhe germa dh, neni 16 pika 2, neni 25 pika 5, si dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 **Të drejtat dhe përgjegjësitë e pika 1, Pika 1.3.** “Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve”, sipas së cilës; germa ç) ‘Mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit’, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap III, pika 30, i ndryshuar. Llogaria nr. **211 “Pyje Plantacione”**, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2024.

**Pretendimi i subjektit:** Lidhur me konstatimin për sa më sipër Sektori i urbanistikës ka sjellë observacion të dërguar me shkresë 1927/1, datë 14.08.2025, protokolluar në KLSH me nr 466/5, datë 21.08.2025, në të cilin citohet:

*Jemi në vazhdim të kontabilizimit të pronave me sektorin e Pyjeve dhe sektorin e Financës.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Për sa citohet me sipër pranohet fakti që procesi i regjistrimit të pronave nuk ka përfunduar dhe që do të vijohet procesi për regjistrimin e pronave. Grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim në këtë raport auditimi.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi:

Z. F. D, Drejtor i Administrimit të Pyjeve

Z. N. B, Përgjegjësi i Sektorit Urbanistik

Z. Y. D, Inspektor i pronave

Znj. E. S, specialiste finance/kontabilitet

Znj. G .B, Përgjegjëse e sektorit të financës

-Gjendja e llogarisë nr.212 “**Ndërtime e konstruksione**” në çelje të vitit 2024 ka qenë në shumën 662,045,813 lekë (kosto historike, duke zbritur amortizimin e akumuluar) dhe në fund të vitit 2024 është në vlerën 628,838,217 lekë [(Teprica neto në fillim të vitit 2024 + shtesat gjatë vitit) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2023 + amortizimin e vitit 2024)].

Tabela 2/11:Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione” shtesa pakësime formati 7/b lekë

Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fillim 2024	Shtesat gjatë vitit 2024	Amortizim 2024	Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fund vitit 2024
966,447,807	304,401,994	662,045,813	541,800	33,749,388	966,989,607	338,151,380	628,838,227

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has

Shtesa e llogarisë nr.212 “Ndërtime e konstruksione” për vitin 2024 ka ardhur si pasojë e pakësimit të llogarisë 202 :”studime e projekte” që kanë lidhje me kapitalizimin e llogarisë 202, për vlerën 541,800 lekë në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”.

-Gjendja e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” në çelje të vitit 2024, ka qenë në shumën 1,125,026,150 **lekë** (kosto historike, zbritur amortizimin e akumuluar) dhe në fund të vitit 2024

është në vlerën **1,098,948,821 lekë** [(Teprica neto në fillim të vitit 2024 + shtesat gjatë vitit) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2023 + amortizimin e vitit 2024)].

Tabela 2/12:Llogaria 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” shtesa pakësime formati 7/b lekë

Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fillim 2024	Shtesat gjatë vitit 2024	Amortizim 2024	Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fund vitit 2024
1,627,644,078	502,617,928	1,125,026,150	31,695,228	57,772,557	1,659,339,306	560,390,485	1,098,948,821

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has

Për vitin 2024 janë kapitalizuar në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” vlera prej 27,033,828 lekë për situacionet e punimeve të objekteve të cilat janë marrë në dorëzim gjatë vitit 2024 vlera të cila kanë qenë në llogarinë punime në proces llogaria 231.

Tabela 2/13:Shtesa e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” dhe pakësimi i llogarisë 231 lekë

Llogaria	Emërtimi	Vlera /lekë
213	Rehabilitim kënete dhe bazament kanali te betonit përroi Tërshënës	112,200
213	Rehabilitim trotuare përgjatë rrugës nacionale dalje te qytetit Krume deri rezervuari Pla	9,301,560
213	Kanali me tub Rezervuari Bera	2,533,188
213	Rehabilitim trotuare përgjatë rrugës nacionale dalje te qytetit Krume deri rezervuari Pla	7,255,080
213	Rehabilitim trotuare përgjatë rrugës nacionale dalje te qytetit Krume deri rezervuari Pla	4,565,400
213	Ndërtim i tri urave fshati Nikoliq ,lagje Ngjec-Pec	2,823,480
213	Kolaudim punimesh/rehabilitim trotuare përgjatë rrugës nacionale dalje qyteti Krume deri rezervuari pla	327,720
213	Supervizim punimesh kanal me tub plastik rez.,qyteti Krume	115,200
Totali		<b>27,033,828</b>

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has

Në total llogaria 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” është shtuar për vlerën prej 31,695,228 lekë e cila përbehet nga vlera 27,033,828 lekë të situacioneve të punimeve të cilat përkasin objekteve të përfunduara dhe të marra në dorëzim dhe vlera prej 4,661,400 që i përket pakësimit të llogarisë 202 “studime dhe kërkime” për objekte të përfunduara të trajtuara më sipër.

- Akti përfundimtar i marrjes në dorëzim të objekteve “Kanali me tub Rezervuari Bera” datë 12.11.2024 me vlerë 2,533,188 lekë.
- Akti përfundimtar i marrjes në dorëzim të objekteve “Ndërtim i tri urave fshati Nikoliq, lagjja Ngjec-Pec” datë 02.12.2024 me vlerë 2,823,480 lekë.
- Akti përfundimtar i marrjes në dorëzim të objekteve “Rehabilitim trotuari përgjatë rrugës nacionale dalje të qytetit Krume deri te rezervuari Pla” datë 24.12.2024 me vlerë 22,122,040 lekë.

- Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” në çelje të vitit 2024, ka qenë në shumën 33,306,233 Lekë kosto historike, zbritur amortizimin e akumuluar) dhe në fund të vitit 2024 është në vlerën 36,024,655 lekë. [(Teprica neto në fillim të vitit 2024 + shtesat gjatë vitit) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2023 + amortizimin e vitit 2024)].

Tabela 2/14:Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” shtesa pakësime formati 7/b lekë

Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fillim 2024	Shtesat gjatë vitit 2024	Amortizim 2024	Pakësimet viti 2024	Amortizim	Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fund vitit 2024
76,859,409	42,553,176	33,308,233	6,148,560	3,253,420	176,718		81,831,251	45,806,596	36,024,655

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has

Gjendja e llogarisë 215 “Mjete transporti” në çelje të vitit 2024, ka qenë në shumën 22,103,394 lekë. kosto historike, zbritur amortizimin e akumuluar) dhe në fund të vitit 2024 është në vlerën 25,561,834 Lekë lekë [(Teprica neto në fillim të vitit 2024 + shtesat gjatë vitit) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2023 + amortizimin e vitit 2024)].

Tabela 2/15:Llogaria 21 “Mjete transporti “shtesa pakësime formati 7/b lekë

Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fillim 2024	Shtesat gjatë vitit 2024	Amortizim 2024	Pakësimet viti 2024	Amortizim	Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fund vitit 2024
35,172,364	13,063,970	22,108,394	4,560,000	1,108,560			39,732,364	14,170,530	25,561,834

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has

-Gjendja e llogarisë 218 “Inventar ekonomik” në çelje të vitit 2024, ka qenë në shumën 5,941,538 lekë (kosto historike, zbritur amortizimin e akumuluar) dhe në fund të vitit 2024 është në vlerën 7,390,866 lekë [(Teprica neto në fillim të vitit 2024 + shtesat gjatë vitit) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2023 + amortizimin e vitit 2024)].

Tabela 2/16:Llogaria 21 “Mjete transporti “shtesa pakësime formati 7/b lekë

Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fillim 2024	Shtesat gjatë vitit 2024	Amortizim 2024	Pakësimet viti 2024	Amortizim	Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fund vitit 2024
55,255,846	49,314,310	5,941,536	4,685,928	3,236,6000			59.941,776	52,550,910	7,390,866

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has

Në total ***llogaria 231*** punime në proces (ndërtesa konstruksione + rruge rrjete dhe vepra ujore) paraqitet në fillim të vitit 2024 në vlerën debitorë prej ***184,111,826 lekë***. Për vitin 2024 është debituar për vlerën 129,520,290 lekë dhe është kredituar për vlerën prej 46,683,643 lekë dhe rezulton me teprice debitorë në fund të vitit 2024 për vlerën prej 266,948,473 lekë.

Nga krahasimi i të dhënave të thesarit me të dhënat e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit rezulton që llogaria 231, sipas thesarit për vitin 2024 është në vlerën ***266,948,473 lekë*** që rezulton e përputhur me vlerën debitorë të llogarisë 231 sipas DFB në bashkinë Has, për vitin 2024.

Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” për vitin 2024 është në vlerën 0 lekë.

\*Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të Shoqërisë Aksionare “*Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Kukës Sh. A*” me NIPT M28322201I, u konstatua se Bashkia Has zotëron 6.06% të aksioneve të kësaj shoqërie. Kjo shoqëri është krijuar sipas akt marrëveshjes se Bashkive Tropojë, Has dhe Kukës dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë e përfaqësuar nga AKUK me nr. 3206.prot., datë 19.07.2022. Vlera e kapitalit të kësaj shoqërie është 10,000,000 lekë ku bashkia Has zotëron ose 6,06% të tyre ose në vlerën ***total 606,000 lekë***, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu 3.1, pika 31, shkronja “b”, i ndryshuar.

**Llogaria nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, nuk paraqitet në situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2024 pasi nuk janë regjistruar vlera e aksioneve që ka Bashkia Has në “Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Kukës Sh. A”.**

-Konstatohet se nuk është pasqyruar ***llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”*** saktë për detyrimet qe rezultojnë në fund të vitit 2024 për investime shërbime dhe detyrime të vendimeve gjyqësore dhe nuk është pasqyruar në pasiv llogaria 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” për vlerën

277,126 lekë, rrjedhimisht është vepruar në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 pika 15 paragrafi 42 ndryshon si më poshtë vijon: “*Degët e Thesarit regjistrojnë në SIFQ raportin/listën e faturave të siguruar sipas pikës 6 (b) të këtij udhëzimi lidhur me detyrimet e prapambetura të njësive të qeverisjes së përgjithshme të njësive të qeverisjes së përgjithshme ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryer e të pa financuara për shkak të mungesës së fondeve publike. Për të evidentuar këto detyrime, degët e thesarit përdorin llogarinë kontabël 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, funksionimi i të cilit caktohet me udhëzim të veçantë dhe vetëm për qëllime monitorimi të performancës financiare të njësive të qeverisjes së përgjithshme. Regjistrimet e thesarit në llogarinë 486 nuk janë pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar që prodhohet nga SIFQ në nivel njësie shpenzues, ose njësi publike qendrore ose vendore për efekt rakordimi me këto të fundit.*

*Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, përpara mbylljes së llogarive vjetore 2021, kryejnë veprimin e mbylljes së llogarisë 4864 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura” në debi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në këtë llogari në datën 31 Dhjetor 2021”.*

*Të gjitha detyrimet e prapambetura të regjistruara në llogarinë 4864 deri në fund të periudhës ushtrimore 2021 konsiderohen detyrime të prapambetura të trashëguara nga vitet e kaluara.*

*Konkretisht llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, është nënvlerësuar për 277,126 lekë, detyrime të vendimeve gjyqësore të pa likuiduara për vitin 2024.*

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi:

Z. S. M. nëpunës zbatues Drejtor i Financës dhe Buxhetit.

Znj. G. B. Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Buxhetit.

Tabela 2/17:Pasivi i Bilancit /lekë

Llogaria	EMERTIMI	2024	2023
	<b>PASIVET(DETYRIMET)</b>	<b>135,601,348</b>	<b>104,472,812</b>
	<b>I. Pasivet Afat shkurtër</b>	<b>135,601,348</b>	<b>104,472,812</b>
	<b>1. Llogari te Pagueshme</b>	<b>135,601,348</b>	<b>104,472,812</b>
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	1,057,517	1,695,566
42	Detyrime ndaj personelit	17,974,332	13,150,788
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	1,161,785	558,749
435	Sigurime Shoqërore	5,121,610	3,829,522
436	Sigurime Shëndetësorë	709,698	525,244
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	18,878,730	13,336,983
467	Kreditorë të ndryshëm	0	0
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	90,697,676	71,375,960
	<b>2. Te tjera pasive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
419	Kreditorë, Parapagime	0	0
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	2,166,065,570	2,102,596,613
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	2,166,065,570	2,102,596,613
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	2,112,208,767	2,067,764,165
12	Rezultatet e mbartura		
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	53,856,803	34,832,448
111	Rezerva		
115	Nga Fondet e veta të investimeve		
15	Shuma të parashikuara për rreziqe e Zhvlerësime		
105	Teprica e Granteve kapitale të Brendshme		

106	Teprica e Granteve kapitale të Huaja		
107	Vlera e mjeteve të caktuara në përdorim		
109	Rezerva nga Rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata		
	Të Tjera		
E	TOTALI I PASIVEVE (B+C)	<b>2,301,666,918</b>	<b>2,207,069,425</b>

*Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has*

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Has më 31.12.2024, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2024, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2024, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave të investimeve.

**Pasivet (Detyrimet)** janë në vlerën prej **135,601,348** lekë të ndara përkatësisht, si më poshtë vijon : **-Llogaria 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”**, është në vlerën prej 1,057,517 lekë të cilat janë detyrime ndaj të tretëve për faturat e mbërritura pranë financës, por të pa likuiduara brenda vitit për mungesë të fondeve.

Tabela 2/18: Llogaria 401-408 Furnitorë dhe llogari të lidhura me to në fund të 2024-ës/ lekë

Nr.	Vlera	Emërtimi	Furnitori
1	117,600	Kolaudim punimesh tre urat	A. fature 3/2024
2	552,108	Energji Elektrike dhjetor 2024	FSHU
3	196,200	Shpenzime te ujit pijshëm	Ujësjiellësi Has
4	28,200	kolaudim punimesh rruga Zahrisht	Xh & M Shpk
6	163,409	Ndërtim ujësjiellësi Krume - Zahrisht vazhdim shtesa	L Shpk

*Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has*

-Llogaria 42-Detyrime ndaj personelit, është në vlerën prej 17,974,332 lekë ku përfshihen pagat e punonjësve për muajin Dhjetor 2024, të cilat paguhet në muajin Janar të vitit 2025.

-Llogaria 431-Detyrime ndaj shtetit për tatim mbi të ardhurat nga paga në masën 15% sipas klasifikimit të pagave, është në vlerën prej 1,161,785 lekë, që përfshin tatimin e pagave dhe tatimin në burim të muajit Dhjetor 2024, që paguhet në vitin pasardhës buxhetor.

-Llogaria 435-Sigurimet shoqërore 9,5% punëmarrësi dhe 15% punëdhënësi, si dhe sigurimet suplementare, të cilat aplikohen mbi pagën bruto dhe janë në vlerën prej 5,121,610 lekë.

-Llogaria 436- Sigurimet shëndetësore 1,7% punëmarrësi dhe 1,7% punëdhënësi, të cilat aplikohen mbi pagën bruto dhe janë në vlerën prej 709,698 lekë.

-Llogaria 466-Kreditorë për mjete në ruajtje, është në vlerën prej 18,878,730 lekë në të cilën përfshihen 5% garanci defektsh për objektet e investimeve të cilave nuk u ka mbaruar afati garancisë së punimeve të parashikuar në kontratën e sipërmarrjes, por edhe garanci për të cilat nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme për likuidimin e tyre. Llogaria 466 është debituar gjatë vitit 2024 në vlerën 329,043 lekë, që përfaqëson vlerën e garancive të kthyera ndaj palëve të të treta në kredi të bankës, si dhe është kredituar për vlerën 5,870,790 lekë, që përfaqëson garancitë e mbajtura nga Bashkia Has kundrejt palëve të treta, në debitë bankës.

Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2024, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve private, të cilat paraqiten si më poshtë:

Tabela 2/19: Gjendja e llogarisë 466 kreditor për mjete në ruajtje fund 2024 /lekë

Nr.	Objekti	Vlera
1	Totali Kreditorë për mjete ne ruajtje 2023	13,336,983
2	Ndërtim Ujësjiellësi Rajonal për NJA Golaj	53,741
3	Blerje mjet shtrim asfalti	228,000
4	Blerje kamion 3 akse	228,000
5	Përgatitje projekt investime	246,947

6	Rehabilitim trotuare përgjatë rrugës nacionale dalje qyteti Krume- Rezervuari Pla 01	965,655
7	Rehabilitim trotuare përgjatë rrugës nacionale dalje qyteti Krume- Rezervuari Pla 05	90,447
8	Rehabilitim me qellim mbi ngritjen e digës se rezervuarit Helshan-2	2,190,167
9	Kanal me tub plastik rezervuari Bera	126,659
10	Rikonstruksioni Gjinnazi Skënderbeu Has	1,600,000
11	Ndërtimi I tre urave Fshati Nikoliq Lagje Ngjec-Pec	141,174
	<b>Total</b>	<b>18,878,730</b>

*Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has*

-Llogaria 4341-Operacione me shtetin detyrime është në vlerën prej 90,697,676 lekë. Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)" është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të pa arkëtuara nga vitet e mëparshme. Sipas informacionit analitik në këtë llogari janë kontabilizuar të drejta të Bashkisë Has për arkëtim të detyrimeve të pa paguara të taksave dhe tarifave vendore nga bizneset, si dhe për detyrime të tjera individë, punonjës.

**Llogaria 4341 korrespondon me llogaritë 468 dhe 423,429** si më poshtë vijon:

423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	914,949
468	Debitorë të ndryshëm	89,782,727
Totali		90,697,676

*Burimi i të dhënave, Bashkia Has, përpunuar nga grupi i auditimit*

### Fondi i Konsoliduar

Në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën **2,166,065,570 lekë**. Fondi i Konsoliduar është i barabartë me fondet neto. Gjendja e fondit të konsoliduar rezulton nga diferenca e shumës së aktiveve me pasivet.

Tabela 2/20: Fondi i konsoliduar 2024/lekë

Llogaria	EMERTIMI	2024	2023
	<b>FONDI I KONSOLIDUAR:</b>	<b>2,166,065,570</b>	<b>2,102,596,613</b>
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	2,122,208,767	2,067,764,165
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	53,856,803	34,832,448

*Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has*

-Llogaria 101-Teprica (Fondi Akumuluar), është në vlerën prej 2,122,208,767 lekë, e përbërë nga aktivet materiale dhe jo materialë, si dhe gjendja e aktiveve qarkulluese (materialet dhe objekte inventari).

-Llogaria 85-Rezultati i veprimtarisë ushtrimore, është në vlerën prej 53,856,803 lekë (Të ardhurat – Shpenzimet), e përbërë nga fondet buxhetore të papërdorura (në debi të llogarisë 520), që trashëgohen në vitin pasardhës buxhetor.

### 2.3. Auditimi i plotësisë dhe saktësisë së pasqyrës së performancës financiare mbi realizimin dhe regjistrimin e të ardhurave nga burimet e veta dhe transfertat mbi realizimin dhe regjistrimin e shpenzimeve.<sup>3</sup>

Auditimi në lidhje me të ardhurat tatimore u fokusua në drejtim të rakordimit të të ardhurave sipas llojeve të tyre midis sektorit të taksave dhe tarifave vendore dhe Drejtorisë së Financës dhe

<sup>3</sup> Referohu tabelës 1: Pasqyra e Performancës Financiare /lekë, në anekset bashkëlidhur këtij RPA-je).

Buxhetit. U kryen rakordimet e të ardhurave me thesarin sipas llojeve të tyre dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrën e performancës financiare të bashkisë Has.

Nga kryqëzimi i informacionit të thesarit, sektorit të taksave dhe tarifave vendore dhe rakordimi me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit u konstatua që nuk ka devijime në pasqyrimin e të ardhurave, paraqitur në tabelën 2/ Rakordimi i të ardhurave tatimore me thesarin dhe bilancin /lekë në anekset bashkëlidhur këtij RPA-je.

Llogaria 70 është në vlerën prej **6,572,426** lekë, nga të cilat:

Llogaria 700-Tatimi mbi të ardhurat nga biznesi i vogël në vlerën prej 176,732 lekë.

Llogaria 702-Të ardhura nga pasuria e paluajtshme, në vlerën prej 1,156,654 lekë ku përfshihen të ardhurat nga taksë e tokës bujqësore në vlerën 81,675 lekë dhe taksë ndërtese 1,074,979 lekë.

Llogaria 703-Tatim mbi mallra dhe shërbime brenda vendit, në vlerën prej 5,239,040 lekë ku përfshihen:

- taksë për zënie hapësire publike 144,446 lekë,
- taksë e ndikimit në infrastrukturë 918,837 lekë,
- taksë therje bagëtie 142,100 lekë,
- taksë reklame 250,000 lekë,
- taksë tabele 230,355 lekë,
- taksë shfrytëzimi pyjor 729,000 lekë,
- taksë e gjelbër 264,087 lekë,
- taksë ndriçimi 401,400 lekë,
- taksë trualli 69,745 lekë,
- tarifë uji 912,450 lekë,
- certifikate përdorimi 66,620 lekë,
- tarifë urbanistike 15,000 lekë,
- tarifë leje zhvillimi 20,000 lekë,
- tarifë leje karburantesh 1,060,000 lekë,
- tarifë leje ndërtimi 15,000 lekë

### **Të ardhurat jo tatimore**

Llogaria 71 në vlerën prej 11,492,751 lekë e përbërë nga:

Llogaria 710-Të ardhura nga ndërmarrjet dhe pronësia, qira objekti në vlerën prej 4,997,812 lekë.

Llogaria 711-Shërbime administrative dhe të ardhura sekondare), në vlerën prej 6,494,939 lekë me nën llogari tarifë administrative 44,447 lekë, leje transporti 169,729 lekë dhe taksë pastrimi 5,823,890 lekë.

Llogaria 711-Shërbime administrative dhe të ardhura sekondare përbëhet nga:

Llogaria 7110 - Tarifa shërbimesh dhe rregullatore në vlerën 6,038,098 lekë

Llogaria 7111 -Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh në vlerën 180,087 lekë

Llogaria 7113 - Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve 70,000 lekë

Llogaria 7115 - Gjoha kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime në vlerën 206,776 lekë

Të detajuara llogaria 711 është tarifa administrative për leje transporti, 169, 729 lekë, taksë pastrimi 5,283,890 lekë, bursa konvikti 180,067 lekë, te ardhura nga MNZ 70,000 lekë, bileta qendra kulturore 10,000 lekë, tarifë administrative 44,477 lekë dhe gjoha 196,776 lekë.

### **Grante**

Llogaria 72-Grant Korrent i brendshëm, në vlerën prej **699,311,928** lekë në të cilin përfshihen grante nga qeveria për shpenzime, financim i pritshëm, taksat e ndara si vijon:

Llogaria 7201 - financim nga buxheti për njësisë e vetëqeverisjes vendore 658,028,066 lekë  
 Llogaria 7204 - pjesëmarrje e institucioneve në tatimet nacionale në vlerën 17,258,920 lekë( e përbërë nga: Taksë qarkullimi i automjeteve në vlerën 10,045,757 lekë dhe Tatim mbi të ardhurat personale në vlerën **7,152,517 lekë**.

Financim i pritshëm nga buxheti 26,024,942 lekë janë të ardhura që priten të alokohen vitin në vazhdim.

### **Shpenzimet**

Shpenzimet në total për vitin 2024 janë në vlerën **663,520,302 lekë** sipas Pasqyrës së Performancës Financiare për sa i përket shpenzimeve të detajuara si më poshtë vijon:

Tabela 2/21: Pasqyrimi i shpenzimeve në bilancin 2024 /lekë

<b>B</b>	<b>SHPENZIMET</b>	<b>663,520,302</b>	<b>645,758,389</b>
<b>600</b>	<b>I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJESEVE</b>	<b>215,069,105</b>	<b>182,444,350</b>
6001	Paga, personel i përhershëm	202,466,644	176,247,768
6002	Paga personel i Përkohshëm	12,602,461	5,062,682
6003	Shpërblime (Komisioner)	0	1,133,900
6009	Shpenzime të tjera për personelin	0	
<b>601</b>	<b>II.KONTRIBUTE TË SIGURIMEVE</b>	<b>36,227,975</b>	<b>29,254,236</b>
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	32,501,700	26,276,192
6011	Kontributi i Sigurimeve Shëndetësore	3,726,275	2,978,044
<b>602</b>	<b>III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME</b>	<b>56,985,788</b>	<b>80,051,250</b>
602	Mallra dhe shërbime te tjera		
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	1,971,551	1,773,870
6021	Materiale dhe shërbime speciale	1,433,028	1,699,332
6022	Shërbime nga te tretë	19,230,792	23,512,243
6023	Shpenzime transporti	16,403,897	12,681,390
6024	Shpenzime udhëtimi	3,041,540	3,792,340
6025	Shpenzime për mirëmbajtjeje të zakonshme	5,627,717	31,255,573
6026	Shpenzime për qiramarrje	0	0
6027	Shpenzime për detyrime për kompesime legale	628,860	111,360
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	0	200,000
6029	Shpenzime të tjera operative	8,648,403	5,025,142
	<b>V.TRANSFERIME KORENTE</b>	<b>365,694,965</b>	<b>357,048,583</b>
<b>604</b>	<b>1.Transferime korrente te brendshme</b>	<b>2,993,890</b>	<b>3,394,486</b>
6040	Transferime korrente tek nivele të tjera të Qeverisë	2,993,890	3,394,486
<b>606</b>	<b>3.Transferime për Buxhetet familjare e Individë</b>	<b>362,701,075</b>	<b>353,654,097</b>
6061	Transferta të Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pushtetit Vendor	362,701,075	353,654,097
<b>63</b>	<b>VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT</b>	<b>-10,457,531</b>	<b>-3,040,030</b>

*Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has/ sektori i tatimeve /thesari*

Llogaria 600 – “Pagat dhe përfitimet e punonjësve” për vitin 2024 janë në vlerën prej 215,069,105 lekë, dhe përbëhen nga pagat bruto të punonjësve detyrime të konstatuara gjatë vitit 2024 përfshirë dhe pagat e muajit Dhjetor 2024 që paguhen në muajin Janar 2025. Nga verifikimi i ditarit të shpenzimeve për vitin 2024 rezultojnë shpenzime te realizuara në vlerën prej **215,069,105 lekë**. Pagat për vitin 2024 janë ndryshuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr.121. datë 24.10.2024’ “Për disa ndryshime në VKB nr.34 datë 23.12.2023 për klasifikimin e pagave të administratës së bashkisë e institucioneve në varësi dhe njësisive administrative për vitin 2024 Bashkia Has”.

Llogaria 601 në vlerën **36,227,975 lekë** përbëhet nga nën llogaria 6010 Kontributet e sigurimeve shoqërore në vlerën prej **32,501,700 lekë** dhe **6011 kontributet e sigurimeve shëndetësore në vlerën prej 3,726,275 lekë**.

Llogaria 6010 - Kontributet e sigurimeve shoqërore në vlerën prej 32,501,700 lekë që përbëhen nga detyrimet e konstatuara për sigurimet shoqërore gjatë vitit 2024 përfshirë dhe detyrimet e

muajit Dhjetor 2024 e që paguhen në muajin Janar 2025. Nga verifikimi i ditarit të shpenzimeve për vitin 2024 rezultojnë shpenzime të realizuara në vlerën prej **32,501,700 lekë**.

Llogaria 6011- Kontributet e sigurimeve shëndetësore në vlerën prej 3,726,275 lekë të përbëra nga detyrimet e konstatuara për sigurimet shëndetësore gjatë vitit 2024 përfshirë dhe detyrimet e muajit Dhjetor 2024 që paguhen në muajin Janar 2025. Nga verifikimi i ditarit të shpenzimeve për vitin 2024 rezultojnë shpenzime të realizuara në vlerën prej 3,726,275 lekë.

Llogaria 602 - Blerje mallra dhe shërbime, në vlerën 56,985,788 lekë, përbëhen nga shpenzimet e kryera gjatë vitit 2024 për mallra dhe shërbime të konstatuara për faturat e mbërritura në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit gjatë vitit 2024. Nga verifikimi i ditarit të shpenzimeve për vitin 2024 rezultojnë shpenzime të realizuara në vlerën prej 56,985,788 lekë.

**Të detajuara shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime sipas llojit të tyre janë si më poshtë vijon:**

Tabela 2/22: Pasqyrimi i shpenzimeve të llogarisë 602 dhe nen llogarive të sajë 2024 /lekë

602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	56,985,788
6020	Materiale zyre e te përgjithshme	1,971,551
6021	Materiale dhe shërbime speciale	1,433,028
6022	Shërbime nga te trete	19,230,792
6023	Shpenzime transporti	16,403,897
6024	Shpenzime udhëtimi	3,041,540
6025	Shpenzime për mirëmbajtje te zakonshme	5,627,717
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	628,860
6029	Shpenzime te tjera operative	8,648,403

*Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Has*

**Nën llogaria 6020** në vlerën 1,971,551 lekë përbën shpenzime për materiale zyre e të përgjithshme të kryera dhe te konstatuara si shpenzime gjatë vitit 2024 dhe përbehet për blerje të detajuara sipas nen llogarive si më poshtë vijon:

**Nën llogaria 6021** në vlerën 1,433,028 lekë përbën shpenzime të konstatuara gjatë vitit 2024 që janë plehra kimike, ushqime, veshje për punonjësit etj.

**Nën llogaria 6022** në vlerën 19,230,792 lekë përbën shpenzime për shërbime nga të tretët të kryera dhe te konstatuara si shpenzime gjatë vitit 2024 që janë shpenzime për energji elektrike, shpenzime për ujë, shpenzime për dru zjarri, shërbime të pastrim gjelbërimit etj.

**Nën llogaria 6023** në vlerën 16,403,897 lekë që përbëhet shpenzime të kryera dhe te konstatuara si shpenzime gjatë vitit 2024 që janë shpenzime për transport, shpenzime për goma dhe bateri, shpenzime regjistrimi etj.

**Nën llogaria 6024** në vlerën 3,041,540 lekë përbën shpenzime për udhëtime dhe dieta të kryera dhe te konstatuara si shpenzime gjatë vitit 2024.

**Nën llogaria 6025** në vlerën 5,627,717 lekë përbën shpenzime. Shpenzime për mirëmbajtje te zakonshme dhe te konstatuara si shpenzime gjatë vitit 2024 që janë shpenzime për mirëmbajtje objekte ndërtimore, shpenzime për mirëmbajtje rruge, mirëmbajtje makineri dhe pajisje kompjuterike etj.

**Nën llogaria 6027** në vlerën 628,860 lekë përbën shpenzime për mirëmbajtje legale të konstatuara si shpenzime gjatë vitit 2024 që janë shpenzime për vendime gjyqësore të paguara gjatë vitit 2024.

**Nën llogaria 6029** në vlerën 8,648,403 lekë përbën shpenzime të tjera operative te konstatuara si shpenzime gjatë vitit 2024 që janë pagesat e këshilltarëve për vitin 2024 etj.

**Llogaria 604** “Transferime korrente të brendshme” në vlerën 2,993,890 lekë përbën shpenzimet e kryera gjatë vitit 2024 që janë pagesa për ndihma financuara për familje të dëmtuara ndihma për njerëzit në nevojë etj.

**Llogaria 606** “Transferime për buxhete familjare dhe individë” në vlerën 362,761,875 lekë përbën shpenzimet e realizuara për ndihmën ekonomike dhe të paaftësisë nga transferata për buxhete familjare dhe individë e cila sipas rakordimit me thesarin rezultoi e përputhur me të dhënat e thesarit për shpenzimet buxhetore.

**Llogaria 63** është ndryshimi i gjendjes së inventarit i cili rezultoi për vitin 2024 në vlerën prej - **10,457,531 lekë**.

### **Konkluzione:**

- Pasqyrat Financiare janë hartuar për Degën e Thesarit Has me *shkresën nr. 1095, datë 27.03.2025*, nënshkruar nga G B, Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Buxhetit dhe z. S. M. nëpunës zbatues. Dërgimi i pasqyrave financiare në mënyrë elektronike në thesar është kryer me datë **16.04.2025** konfirmuar nga dega e thesarit datë 21.05.2025, jashtë afateve të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 118. ‘Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruar të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës.

- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon për Hasi i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, lis pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Nga auditimi i llogarisë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” u konstatua se kjo llogari ruan të njëjtën vlerë prej **914,949 lekë** si në fund të vitit 2024, ashtu edhe në fund të vitit 2023, pa pasur lëvizje gjatë periudhës raportuese. Kjo vlerë është trashëguar nga procesi i konsolidimit të pasqyrave financiare midis Bashkisë Has dhe ish-komunës Gjinaj, në kuadër të reformës territoriale të vitit 2015. Megjithatë, nga strukturat përkatëse të bashkisë nuk është hartuar një analizë e detajuar që të sqarojë natyrën dhe përbërjen e kësaj vlere, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar.

Nga auditimi i procesit të kontabilizimit të pronave në llogarinë 211 “Pyje dhe kullota” të Bashkisë Has, u konstatua se, Drejtoria e Administrimit Pyjor dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit / Inspektori i Pronave kanë kryer aplikime pranë ASHK Kukës vetëm për marrjen e vërtetimeve për pronat e regjistruara në vitin 2020, me qëllim dhënien e tyre me qira. Megjithatë, vlera e këtyre pasurive nuk është regjistruar në kontabilitetin e institucionit. Për pesë certifikatat e pronësisë të përfshira në dokumentacionin përkatës, grupi i auditimit ka kryer një vlerësim të aseteve përkatëse, në bazë të VKM nr. 89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, duke përdorur tabelat referuese për vlerën për m<sup>2</sup> të pyjeve në

territorin e Bashkisë Has. Bazuar në këtë metodologji, dhe duke llogaritur me vlerën 100 lekë/m<sup>2</sup>, rezulton se vlera totale e këtyre aseteve është **406,279,100 lekë**. Pavarësisht faktit se këto prona janë regjistruar në ASHK Kukës që në vitin 2020 dhe janë rifreskuar në vitin 2024, ato nuk janë rivlerësuar dhe nuk janë integruar siç duhet në kontabilitetin e bashkisë. Kjo situatë është rezultat i mungesës së bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe Drejtorisë së Administrimit Pyjor, për sa i përket përpunimit dhe shkëmbimit të informacionit mbi regjistrimin dhe pasqyrimin e pasurive pyjore në sistemin financiar, veprime në kundërshtim dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.02.2011, i ndryshuar "Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik", pika 36, 52,73,85 si dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 3.1, nën-pika 30.

-Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të Shoqërisë Aksionare "*Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Kukës Sh. A*" me NIPT, u konstatua se Bashkia Has zotëron 6.06% të aksioneve të kësaj shoqërie. Kjo shoqëri është krijuar sipas akt marrëveshjes se Bashkive Tropojë, Has dhe Kukës dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë e përfaqësuar nga AKUM me nr. 3206.prot., datë 19.07.2022 protokolluar nga AKUM me nr. 1574.prot., datë 26.07. 2022.Vlera e kapitalit të kësaj shoqërie është 10,000,000 lekë, ku bashkia Has zotëron ose 6,06% të tyre ose në vlerën total 660,000 lekë e pa pasqyruara kjo në Llogarinë 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet", e cila për vitin 2024 është në vlerën 0 lekë, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Kreu 3.1, pika 31, shkronja "b", i ndryshuar.

-Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave nuk ka një regjistër me të dhëna të plota lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin për të paguar tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, e rrjedhimisht nuk ka parashikime reale mbi të ardhurat e pritshme për t'u arkëtuar. Gjithashtu, familjet në Bashkinë Has nuk ngarkohen për detyrimet vendore për taksat dhe tarifën e tjera të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak, si për shembull taksën e tokës bujqësore, taksën e truallit, tarifën e gjelbërimit. Si rezultat, procesi i ngarkimit të familjeve për detyrimet vendore nuk është i dokumentuar si dhe nuk dihet numri i familjeve debitorë dhe vlera totale që ato kanë ndaj bashkisë. Këto veprime apo mosveprime janë në kundërshtim me *Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar neni 4 pika 7, *Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* i ndryshuar neni 19, neni 25 pika 5, *Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"*, neni 9 pika 1, pika 1.3 germa ç).

Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua se, llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" nuk është pasqyruar saktë, pasi nuk janë përfshirë detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore, të cilat në fund të vitit 2024 rezultojnë në vlerën 277,126 lekë, veprime në *kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme"* i ndryshuar *pika.15*

#### **Auditimi i likuidimit të vendimeve të gjykatave dhe kosto e tyre në buxhetin e shtetit.**

Për periudhën objekt auditimi (01.01.2024 deri me 31.12.2024) shpenzimet për likuidimin që kanë rrjedhur nga vendimet gjyqësore të formës së prerë për gjyqe fituesit e larguar nga puna si dhe pensione të pa llogaritura saktë, përfshirë dhe tarifën përmbartimore në rastet kur është aplikuar një e tillë, paraqitet në Tabelën nr. 2.5.

Tabela nr. 2.5 Shpenzimet që rrjedhin nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore

(Në lekë)

Nr.	Emër Mbiemër	Vendim i Gjykatës, nr., date	Vlera për tu ekzekutuar	Shuma e ekzekutuar deri në 31.12.2023	Vlera ekzekutuar për vitin 2024	Taksë përbarimore	Vlera e mbetur e pa ekzekutuar në 31.12.2024
1	A I	Nr. 940, datë 16.12.1994	395,178	0	395,178	31,200	0
2	I Q	Nr. 55, datë 27.03.2024	644,800	0	468,800	77,255	176,000
3	SH M	Nr. 3780, datë 25.10.2024	86,819	0	0		86,819
4	SH B	Nr. 3780, datë 25.10.2024	14,307	0	0		14,307
<b>TOTALI</b>			<b>1,141,104</b>	<b>0</b>	<b>863,978</b>	<b>108,455</b>	<b>277,126</b>

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Buxhetit dhe menaxhimit financiar/Spektori Financës, përpunuar nga grupi i auditimit.

Pra konstatohet se efekti financiar për 1 vit i pagesës së gjyqve fituesve për t'u rikthyer në punë, është **863,978 lekë**, për vitin 2024 dhe shpenzime përbarimore janë në vlerën e **108,455 lekë** duke sjellë kosto shtesë në buxhetin e shtetit dhe shpenzime pa eficiencë dhe ekonomicitet.

Referuar Kodit të Procedurës Civile, neni 510, germa "a" dhe 511, germa "a" shprehet në mënyrë eksplicite se:

"Ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv. Janë tituj ekzekutivë: a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm".

"Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim nëpërmjet lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, i cili:

a) për rastet e parashikuara nga shkronjat "a" dhe "b" të nenit 510 të këtij Kodi, lëshohet nga gjykata që ka dhënë vendimin".

Gjithashtu nga auditimi rezultoi se: Sektori i financës nuk ruan të dhënat të ndara sipas shpenzimeve gjyqësore, përbarimore dhe detyrimet ndaj gjyq fituesve, por i regjistron ato në total, çka sjellë riskun e mos evidentimit të detyrimeve që janë për gjyqve fituesit dhe ato që janë për shpenzime përbarimore.

Përveç Sektorit të Financës dhe Buxhetit, Sektori Juridik i bashkisë Has bazuar në Rregulloren e Brendshme të miratuar nga Kryetari i Bashkisë me vendim nr.01, datë 25.04.2024, me nr. 1445 .prot., datë 25.04.2024, dhe nenit 48/1 pas evidentimit dhe monitorimit të proceseve gjyqësore, duhet të njoftojë shkresërisht në kohë reale DBF për të shmangur shpenzimet përbarimore të cilat rëndojnë buxhetin e shtetit.

Pra në total efekti financiar i zbatimit të vendimeve të gjykatës për të larguarit nga puna është 972,433 lekë, i detajuar:

- 863,978 lekë, të paguara për vitin 2024,
- 108,455 lekë, shpenzime përbarimore, efekt negativ
- 277,126 lekë, të pa likuiduara ende.

Për sa më sipër Drejtoria e Financës dhe e buxhetit në Bashkinë Has, ka sjellë objeksionet sipas shkresës me nr. 2822/prot, datë 14.08.2025, protokolluar në KLSH me nr. 466/5, datë 21.08.2025.

**Pretendimi i subjektit:**

1. Në lidhje me konstatimin se - Pasqyrat Financiare janë hartuar për Degën e Thesarit Has me shkresën nr. 1095, datë 27.03.2025, nënshkruar nga G. B, Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Buxhetit dhe z. S. M. nëpunës zbatues. Dërgimi i pasqyrave financiare në mënyrë elektronike në thesar është kryer me datë **16.04.2025** konfirmuar nga dega e thesarit datë 21.05.2025, jashtë afateve të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 118., konfirmojmë se pasqyrat financiare janë ngarkuar në sistemin AMFIS në datën 31.03.2025 ndërsa data e konfirmimit nga dega e Thesarit është në 21.05.2025, jashtë kompetencave tona.

2. Në lidhje me rekomandimin 4.1, sqarojmë se llogaria 423-429 “Personeli paradhënie, deficite e gjoba”, përbëhet si më poshtë:

Detyrimi 96,451 lekë, i përket ish Komunës Gjinaj pa emër personi dhe është transferuar në bilancin e Bashkisë Has;

Detyrimi 818,498 lekë kanë qenë fonde të ish-Komunës Gjinaj të ndihmës ekonomike të tërhequra nga komuna në Bankë dhe të grabitura gjatë transportit për në komunë në vitin 1997(nuk janë zbuluar autorët). Pra janë detyrime të trashëguara nga vitet e mëparshme.

3. Nga sa trajtohet në gjetjen 9 të PRA-së, ju sqarojmë se detyrimet 277,126 lekë për vendimet gjyqësore kanë ardhur në bashki pasi ishin mbyllur pasqyrat financiare 2024, këto detyrime janë kontabilizuar dhe paguar gjatë vitit 2025.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me pretendimin 1, përsa i përket datës së dorëzimit elektronik të PF 2024, grupi i auditimit ka verifikuar pasqyrat dhe data e vulës digjitale nga Bashkia Has është data 16.04.2025.

Në lidhje me pretendimin 2, ju dakordësoni me gjetjen tonë, dhe qëndrimi ynë mbetet i pa ndryshueshëm. Ju duhet të merrni masa për saktësimin e kësaj situate të mbartur edhe pse nuk është përgjegjësia juaj por është detyra juaj sot.

Në lidhje me pretendimin 3, pagesat që ju konfirmoni janë kryer gjatë vitit 2025, çka do të thotë që rekomandimi ynë ka gjetur zbatim.

### **2.3 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.**

**2.3.1.** Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

**2.3.2.** Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimit në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

**2.3.3.** Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH paraqitet:

**Konkluzion:** Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën përcjellëse, janë lënë gjithsej 19 masa të kategorizuara në *11 masa organizative, 2 masa për eliminim e efekteve negative, 3 masa për uljen e borxhit tatimor si dhe 3 masa disiplinore.*

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Nga 11 masa organizative të rekomanduara, pranuar 100% nga subjekti. Nga këto janë zbatuar 6 masa, janë në proces 2 masa, janë pjesërisht të zbatuara 2 masa dhe *1 masë e pazbatuar.*

-Nga 2 masa për eliminim e efekteve negative, pranuar 100% nga subjekti, të cilat janë në proces zbatimi.

- Nga 3 masa për uljen e borxhit tatimor, pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat rezultojnë realizuar pjesërisht 2 masa, dhe 1 masë e pazbatuar.

\* Masat disiplinore, nuk janë dhënë nga titullari i institucionit, rezultojnë të pazbatuara.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. M. D, Kryetar i Bashkisë Has dhe personi përgjegjës për monitorimin e planit të veprimit të zbatimit të rekomandimeve, znj. N. L, Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë Has.

#### I. Respektimi i afatit prej 20 ditësh, për informimin e KLSH-së mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

- Bashkia Has ka dërguar jashtë afatit 20 ditor, kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 germa "j", të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", sipas shkresës përcjelle në KLSH me nr. 359/10.Prot, datë 12.06.2024.

#### II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, nga Bashkia Has nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve duke mos respektuar kështu edhe afatin 6 mujor, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30, pika 2, ku përcaktohet që: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna".

#### III. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak Has, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:

Bashkia Has ka hartuar planin e veprimit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 1250/16 datë 08.07.2024 "Plan veprimi, për zbatimin e detyrave të lëna", por nuk ka raportuar rregullisht pranë Këshillit Bashkiak, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 50, pika 5, ku përcaktohet që: "Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë".

#### IV. Rekomandimet e KLSH-së:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Has, janë rekomanduar gjithsej:

- **11** masa organizative,
- **3** masa për uljen e borxhit
- **2** masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.
- **3** masa disiplinore.

#### V. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH-së:

Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Has, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si më poshtë:

Masat	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
Masa organizative	11	11	0
Masa për eliminimin e efekteve negative	2	2	0
Masa për uljen e borxhit tatimor	3	3	0
Masa disiplinore	3	3	0
<b>Totali</b>	<b>19</b>	<b>19</b>	<b>0</b>

#### *VI. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e Bashkisë Has:*

Emërtimi	Rekomanduar	Zbatuar	Pa zbatuar	Në proces	Pjesërisht të zbatuar
Masa Organizative	11	6	1	2	2
Masa për eliminimin e efekteve negative	2			2	
Uljen e Borxhit	3		1		2
Masa Disiplinore	3		3		
<b>Total</b>	<b>19</b>	<b>6</b>	<b>5</b>	<b>4</b>	<b>4</b>

Nga verifikimi i dokumentacionit, në lidhje me *zbatimin e rekomandimeve të ri kërkuara* konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë

- ✓ Nga **13 masa organizative** te rekomanduara, pranuar 100% nga subjekti. Nga këto janë **zbatuar 2 masa**, janë **në proces 2 masa**, janë **pjesërisht të zbatuara 4 masa** dhe **5 masa të pazbatuara**.
- ✓ **1 masë shpërblim dëmi** në vlerën **265,845.521 lekë**, pranuar 100% nga subjekti, **rezulton e pazbatuar**.
- ✓ Nga **3 masa për uljen e borxhit tatimor**, pranuar 100% nga subjekti, **rezultojnë 2 masa të zbatuara pjesërisht dhe 1 masë e pazbatuar**.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Bashkia Has nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

Nuk ka hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre, në kundërshtim me nenin 8 pikën 8/a të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

Megjithëse nga titullari i Bashkisë Has është ngritur Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP) për hartimin e PBA-së 2024-2026, por këtu nuk janë reflektuar ndryshimet e ndodhura nga zgjedhjet e pushtetit vendor përgjatë muajit qershor 2023 që ka bërë të ketë lëvizje të punonjësve, si dhe nuk rezulton asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS, veprime në kundërshtim me *Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinitorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinitorit të riskut në njësitë publike”, lidhur me rolin e GMS në sistemin e MFK.*

Megjithëse Bashkia Has e kryen aktivitetin e saj në bazë të një rregullore të brendshme, e miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak datë 03/01/2019 “Rregullore e funksionimit të brendshëm administrativ të Bashkisë Has”, nuk disponon përshkrime pune, dhe procedura e ndjekur për hartimin e tyre nuk është bërë në përputhje me nenin 24 të Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”.

Nuk janë kryer vlerësimet e punonjësve, sikurse përcaktohet në *nenin 62 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”*. Gjithashtu, Bashkia Has nuk disponon një program trajnimi për punonjësit por janë dërguar nevojat për trajnim.

Bashkia Has nuk ka hartuar një strategji risku, nuk ka hartuar regjistër risku, si dhe nuk disponon as procedurë të menaxhimit të riskut ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve dhe as raporte monitorimi të fushave me risk, veprime në kundërshtim me nenin 12 pika dhe nenin 21 të *Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, të ndryshuar.

*Titullari i Bashkisë Has për vitin 2023 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK*. Nuk ka asnjë dokumentim të raportimit mbi statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit të MFK.

Nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore nuk është hartuar plani vjetor i trajnimeve në përputhje me Ligjin nr. 10296 datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

**1.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Has të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së riskut, të miratojë gjurmën e auditimit për proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë.

Koordinatori i Grupit të Menaxhimit Strategjik të organizojë takimet periodike të GMS-së për të siguruar marrjen në kohën të informacioneve cilësore për vlerësimin e progresit të bërë nga njësia në arritjen e objektivave të MFK-së. Sektori i Burimeve Njerëzore në Bashkinë Has të marrë masat për hartimin e planit vjetor të trajnimeve të punonjësve.

**Përgjigja e subjektit:** Nga Bashkia Has është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP) për hartimin e PBA- së 2024-2026 me Vendimin nr. 1, datë 08.01.2024.

Duke pasur parasysh ndryshimet e punonjësve në sektorët e Bashkisë është bërë “Ndryshim në Ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP) për Hartimin e PBA-së 2024-2026, Bashkia Has” sipas vendimit nr. 02, date 19.11.2024, miratuar nga Kryetari i Bashkisë. Janë organizuar takime periodike të Grupit të Menaxhimit Strategjik për të identifikuar çështje, probleme apo pengesat për arritjen e objektivave të programit. Bazuar në *ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar si dhe ligjin nr. 152/3013 “Ligji për Nëpunësin Civil”* i ndryshuar, nga Sektori i Burimeve Njerëzore është bërë vlerësimi i nevojave për trajnim të punonjësve të Bashkisë si dhe temat e trajnimeve sipas pozicioneve përkatëse, dërguar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) me shkresën nr. 3383/1.prot, datë 07.11.2024.

Bashkia Has ka nxjerrë Urdhrin me nr. 34, datë 16.01.2025 “Për Menaxhimin dhe Koordinimin e Riskut në Bashkinë Has”.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**2. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Has ka ngritur NJAB për **vitin 2023**, e cila ka funksionuar me 1 auditues sipas strukturës organizative të përcaktuar nga Kryetari i Bashkisë me Vendimin të KB nr. 95 datë 01.01.2023 “Struktura organizative e miratuar” (e ndryshuar). Ndërsa me VKB nr. 581, datë 22.06.2023 struktura e Njesisë së Auditit të Brendshëm është përcaktuar me 1 përgjegjës dhe 2 specialist audit, por në fakt nuk është e plotësuar deri tani. Planit i auditimeve për vitin 2023 është 6 angazhime auditimi, por në fakt janë realizuar 3 auditime, pra në masën 50%.

Nga auditimi i tre dosjeve të angazhimeve u konstatuan mangësi: dosjet janë jo të plota dhe të pa inventarizuara. Në dosje gjenden vetëm programet e angazhimit të auditimit; autorizimet për

fillimin dhe përgatitjen e angazhimit; njoftimin për fillimin e angazhimit si dhe Raporti përfundimtar i auditimit që në të tre rastet është i pa nënshkruar nga audituesi. Pra i gjithë dokumentacioni tjetër pjesë e domosdoshme e dosjes mungon. Nga NJAB nuk janë dërguar shkresa njëjive të audituara për të kërkuar informacion mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna dhe në auditimin e radhës çështja e zbatimit të rekomandimeve duhet të trajtohet si çështje kryesore. Veprime dhe mos veprime në kundërshtim me *ligjin nr. 114/2015 "Për Auditimin në Sektorin Publik"* në nenet 2;5 dhe 6.

**2.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakant në strukturën e Njesisë së Auditit të Brendshëm, me qëllim bërjen funksionale të kësaj njësie auditimi për përmbushjen e misionit të saj, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njesisë.

**Përgjigjja e institucionit:** Për vitin 2024, Kryetari i Bashkisë Has ka miratuar strukturën organike sipas urdhrin nr 35, datë 15.01.2024, gjithsej 300 punonjës.

Përsa i përket sektorit të AB ai përbëhet nga një përgjegjës sektori dhe dy specialistë/audit. Struktura faktike ka vakant ende përgjegjës in e sektorit dhe është plotësuar me 2 specialistë/audit përkatësisht me emërim të znj. E. Z. në janar 2024 dhe z. S. SH. me emërim në korrik 2024. (Punonjësit nuk janë të pajisur me certifikatën e auditit të brendshëm).

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

**2.2 Rekomandimi:** Njësia e Auditit të Brendshëm, në periudhën në vijim të marrë masa për realizimin e misioneve të planifikuara, si dhe planifikimin e misioneve me risk që kjo njësi vendore ka deri në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

**Përgjigjja e institucionit:** Për sa i përket realizimit të misioneve të planifikuara për vitin 2024 nga NJAB, ky sektor ka dorëzuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të AB në MF me shkresën 914/.prot., datë 28.09.2023, planin strategjik dhe vjetor të auditimeve me 11 auditime të planifikuara. Nisur nga mungesa e specialistëve në këtë sektor si dhe përgjegjësit të sektorit si dhe mungesës së analizës së riskut në planifikimin e mëparshëm, janë kryer vetëm 4 auditime, sipas ndryshimit të planit strategjik dhe vjetor të auditimeve me Urdhrin 468, të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Has, datë 28.10.2024, dhe dërguar në MF me shkresën 3459/.prot., datë 28.10.2024.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi evidentohen risqe buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara dhe mos likuidimi i vendimeve gjyqësore, rezulton se vlera e faturave të pa likuiduara në fund të vitit 2022 është prej 11,333 mijë lekë. Janë krijuar gjatë vitit 2023 detyrime në vlerën 6,854 mijë lekë dhe është likuiduar në vlerën 17,601 mijë lekë, duke rezultuar gjendje më 31.12.2023 në vlerën 587 mijë lekë, ku në raport me shpenzimet e vitit të cilat janë në shumën 304,615 mijë lekë zënë 0.09%, pra nuk është me vështirësi financiare, veprime në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore", neni 34, pika 1, neni 40, pika 3, *Udhëzim i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"*, pika 101.

**3.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën 587 mijë lekë, duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim, si dhe të raportojë periodikisht në MFE vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike.

**Përgjigjja e subjektit:** Gjatë vitit 2024 janë likuiduar:

- detyrimi në vlerën 395,178 lekë ndaj kreditorit A. I, detyrime për vendime gjyqësore, sipas urdhër shpenzimit nr.250 datë 24.05.2024;
- Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim Ujësjiellësi Zahrisht”, kanë mbetur pa likuiduar detyrimet në vlerën 163,409 lekë si dhe shuma 28,200 lekë kolaudim punime për ndërtim ujësjiellësi, detyrime të vitit 2018 pasi ka mungesë dokumentacioni në dosjen e OE.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces**.

**4. Gjetje nga auditimi:** Procedurës së mbajtjes së kontabilitetit nga Sektori i Financës i mungon libri i madh apo libri centralizatori për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese, çka tregon se veprimet me llogaritë nuk kanë ndjekur rrjedhën logjike kontabël për nxjerrjen e bilancit. Këto veprime janë në kundërshtim me *Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II pika 2.2 “Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik” Kreu III, pika 3.2, nënpikat 43,44,45.*

**4.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has të marrë masa, që në hartimin e pasqyrave financiare, të mbështetet në normat dhe parimet e kontabilitetit, në rregullat për dokumentacionin si dhe në procedurat për mbajtjen kronologjike të kontabilitetit, duke u finalizuar me përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare të Bashkisë.

**Përgjigja e subjektit:** Gjatë vitit ushtrimor 2024 janë mbajtur ditarët e llogarive dhe pasqyrat financiare janë hartuar konform normave dhe parimeve të kontabilitetit, veprimet kontabile janë regjistruar në ditar dhe në librin e madh (centralizator), pasqyrat financiare të vitit 2024 janë mbyllur dhe dorëzuar në thesar sipas kërkesave ligjore.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**5. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarisë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën prej 914,949 lekë si në fund të vitit 2022. Kjo vlerë është trashëguar nga konsolidimi i pasqyrave financiare të aparatit të Bashkisë Has me ish komunat me reformën territoriale të vitit 2015. Kjo vlerë i përket bilancit të ish-komunës Gjinaj, për të cilën nuk ka analizë të detajuar dhe nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson, veprime në kundërshtim me *Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”.*

**5.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore të shqyrtojë dokumentacionin financiar të ish-komunës Gjinaj, mbi bazë të së cilës të analizojë dhe të përcaktojë të drejtat e konstatuara për arkëtim në vlerën 914,949 lekë, duke përcaktuar personat përgjegjës material me shumat përkatëse, që i kanë detyrim Bashkisë për kthim. Nëse është e pamundur Bashkia Has të ndjekë hapat ligjorë për njohjen ose jo të këtij detyrimi dhe më pas të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet.

**Përgjigja e subjektit:** Gjendja e llogarisë 423-429 “Personali, paradhënie, deficite, gjoba” përbëhet nga dy detyrime:

1. Shuma 96,451 lekë “Deficite dhe gjoba” krijuar para vitit 2015, detyrim i ish punonjësve të ish komunës Gjinaj pa listë emërore.

2. Llogari aktive 423-429, në shumën 818,498 lekë që përfaqësojnë vlerë monetare të ndihmës ekonomike të grabitur në vitin 1997 gjatë transportit, pa autor.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër, Bashkia Has, ka kryer analizën e detajuar të kësaj llogarie, por nuk ka proces verbale dhe listë emërore për të adresuar arkëtimin e kësaj vlere. ***Rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe në proces.***

**6. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” në fund të vitit 2023, rezulton në vlerë neto 1,791,490 lekë dhe vlerë historike 9,960,627 lekë, që i përket 27 projekt-studimeve për investime të kryera në vitet e mëparshme, vlerë e cila nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv apo në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë.

Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Këto veprime janë në kundërshtim me *Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1. pika 2, Klasa 2 “Aktivet Afatgjata” Pika 3.3 nënpika 62 dhe Kreu II, pika 16/b.d.*

**6.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës 1,791,490 lekë që i përket 27 projekt-studimeve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij. Më pas të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe të bëjë sistemimet kontabël përkatëse.

**Përgjigja e subjektit:** Nga Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore është kryer sistemimi i veprimit në llogarinë 202 “Studime e Kërkime” duke kredituar llogarinë 202 për shumën 5,203,200 lekë kosto historike, nga të cilat 1,754,367 lekë është vlera e inventarit gjendje dhe 3,449,000 lekë është vlera e amortizimit, veprimi ka kaluar në debi llogaritë respektive në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione” në shumën 184,591 lekë, në debi të llogarisë 213 “Rrugë Rrjete Vepra Ujore” në shumën 1,569,776 lekë.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**7. Gjetje nga auditimi:** Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) të klasës 21 për vitin 2023 është në vlerën 3,211,522,798 lekë, ku janë pasqyruar të gjitha lëvizjet e aktiveve gjatë vitit 2023 për shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktivi. Në inventarët kontabël të aktiveve materiale gjendje në llogaritë: 210 “Toka, Troje, Terrene” është në vlerën 1,074,183 lekë; 212 “Ndërtesa Konstruksiione” në vlerën 966,447,807 lekë; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 1,627,644,078 lekë; 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 75,859,409 lekë janë azhurnuar bruto të gjithë investimet e kryera gjatë vitit 2023 për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv.

Për vitin 2023 nuk është kryer inventari fizik i aktiveve materiale dhe jo materiale si dhe aktiveve afatshkurtra të Bashkisë Has dhe 4 NJA-ve, duke mos ushtruar kontroll të paktën një herë në vit mbi aktivet dhe menaxhimin e tyre në lidhje me vërtetimin e saktësisë, cilësisë e gjendjes fizike të tyre për shmangien e humbjeve apo keq menaxhimin e tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me

UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar kapitulli III, pika 30, Kreu IV. “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, pikat 73,74, me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata”.

**7.1.Rekomandimi:** Strukturat drejtuese të Bashkisë Has dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Taksave Vendore të marrin masa për kryerjen e procedurave të inventarizimit fizik të aktiveve të paktën një herë në vit, si dhe të bëhen sistemimet e nevojshme lidhur me ndryshimet e konstatuara nga inventari kontabël, të kryhen përditësimet në kontabilitet duke plotësuar dhe saktësuar regjistrin historik të aktiveve.

**Përgjigja e subjektit:** Lidhur me inventarizimin fizik të aseteve të bashkisë konfirmojmë se inventari për periudhën 2023 është kryer me vonesë për arsye të lëvizjes nga detyra të disa punonjësve të bashkisë Has, të cilët nuk janë paraqitur për dorëzimin e mallit në ngarkim. Për pasojë urdhri i Kryetarit të bashkisë për inventarizimin për vitin 2023, ka dalë me nr.82/1 datë 05.02.2024 dhe relacioni nga komisioni është dorëzuar në datë 30.04.2024 pas përfundimit të auditimit të radhës.

Inventarizimi për vitin 2024 është kryer referuar urdhrin të Kryetarit nr.489 date 02.12.2024 dhe relacioni nga komisioni është dorëzuar në bashki me shkresën nr.408 datë 04.02.2025.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**8. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarisë së fondeve 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën prej 18,586,594 lekë, vlerë e cila nuk rakordon me gjendjen e llogarisë analoge 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”, në vlerën 19,759,878 lekë të aktivitetit të bilancit, pasi kjo gjendje duhet të pasqyrohet detyrimin, që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 pika 3.3, nënpika 8.

**8.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për vlerat e detyrimeve, që ka shteti ndaj institucionit, të cilat janë paraqitur gabim në llogaritë e fondeve në pasqyrën e performancës (llog.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”).

**Përgjigja e subjektit:** Gjendja e llogarisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” e vitit 2023, në shumën 19,759,878 është sistemuar në bilanc dhe në thesar brenda periudhës së auditimit, në pasqyrat financiare përfundimtare të bashkisë Has për vitin 2023 rezulton e sistemuar, gjendja e Llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti 31.12.2023 është 19,759,878 lekë.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

**9. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 69,067,839 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 70,461,012 lekë. Referuar analizës së llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe lëvizjeve shtesa-pakësime nga viti 2022 në vitin 2023 konstatohet se, vlera e shtuar e debitorëve në vitin 2023 për taksën e infrastrukturës prej 1,729,423 lekë nuk është përfshirë në gjendjen e kësaj llogarie në mbyllje të vitit 2023, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes

*dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 32 Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, Pika 3.3.*

**9.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2024 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

**Përgjigja e subjektit:** Shkresa zyrtare nga ASHK ka ardhur në bashki pas mbylljes së pasqyrave financiare për vitin 2023, kontabilizimi është kryer në pasqyrat financiare 2024 duke debituar llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” në shumën 1,698,702 lekë dhe kredituar llogarinë 4341 “Operacione me shtetin detyrime në shumën 1,698,702 lekë. Diferenca sipas kërkesës për arkëtim në shumën 30,723 lekë i përket qytetarit Sokol Ngjeci i cili ka paguar detyrimin në datë 06.12.2024.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër *rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe i zbatuar.*

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të listave të inventarëve të asetëve rezulton se, janë 1444 prona të paluajtshme publike, shtetërore, të transferuara në pronësi ose në përdorim Bashkisë Has (Qendër), listat përfundimtare të të cilave janë të miratuara me VKM-ët përkatëse, ndërsa për 412 prona të 3 Njësi Administrative si **Golaj e Fajza** janë në fazën e miratimit të listave paraprake dhe **Gjinaj** në fazën fillestare.

Nga këto prona janë hipotekuar 20 pasuri të paluajtshme dhe janë në proces aplikimi për certifikim hipotekor 26 pasuri të tjera. Për pjesën tjetër të pronave nuk është bërë përditësimi i të dhënave të inventarit të këtyre pronave.

Në mungesë të përditësimit të inventarëve dhe përgatitjes së dokumentacionit tekniko-ligjor të këtyre pronave, për një pjesë nuk disponohet informacion në lidhje me gjendjen reale dhe statusin e tyre, sa nga këto prona janë të zëna, sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë.

Mos kryerja e procedurave për mos përditësimin e listave paraprake dhe fillestare të pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM për 3 NJA **Golaj e Fajza** dhe **Gjinaj**, më pas paraqitja pranë ASHK në Drejtorinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike me vërejtjet dhe ndryshimet e të dhënave të listë-inventarëve të pronave, mos regjistrimi në ASHK në favor të Bashkisë i pjesës më të madhe të këtyre pronave të listuar, si dhe mos vlerësimi i tyre janë veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” nenin 18, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, pikën 18,22, me ligjin nr.20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV “Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike” nenet 35-44, me Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”.**10.1.**

**Rekomandimi:** Bashkia Has nëpërmjet strukturave drejtuese dhe përgjegjëse të kryejë procedurat e plota për transferimin përfundimtar të listave të inventarëve të pronave për 3 NJA Golaj, Fajza dhe Gjinaj, duke kryer inventarizimin dhe përditësimin e listave paraprake të pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM Bashkisë dhe NJA-ve dhe më pas miratimi me VKB e paraqitja pranë ASHK në Drejtorinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike me vërejtjet dhe

ndryshimet e listave të paraprahe apo fillestare të pronave të miratuara. Gjithashtu për pjesën tjetër të pronave të kaluara Bashkisë me VKM në pronësi/përdorim, të pa hipotekuar të përgatisë dokumentacionin tekniko-ligjor dhe të ndjekë deri në fund regjistrimin e tyre në ASHK, Drejtoria Vendore Has.

**Përgjigja e subjektit:** Për 10 prona të regjistruara, janë pajisur me certifikatë regjistrimi gjatë vitit 2024 – 2025, të pasqyruara në tabelën 1:

Tabela 1

Nr.	Emërtimi i pronës
1	343/2 Pyll. Sip 10.000 m <sup>2</sup>
2	343 Pyll. Sip 283 457 m <sup>2</sup>
3	1 Pyll. Sip 2558149 m <sup>2</sup>
4	9 Pyll. Sip 224201 m <sup>2</sup>
5	6 Pyll. Sip 86855 m <sup>2</sup>
6	44 Pyll. Sip 910128 m <sup>2</sup>
7	81 Pyll. Sip 79303 m <sup>2</sup>
8	53 Pyll. Sip 167284 m <sup>2</sup>
9	565 Pyll. Sip 1548285 m <sup>2</sup>
10	546 Pyll. Sip 2145795 m <sup>2</sup>

### Lista e pronave që janë në proces certifikimi: (Tabela 2)

Tabela 2

1	4/225 Zk 2282. 155m <sup>2</sup>
2	4/223 ZK 2282. 155m <sup>2</sup>

Lista e pronave të cilat janë përgatitur për aplikim për certifikatë pronësie, deri me datë 31.05.2025 për pronat si më poshtë (tabela 3):

Tabela 3

1	4/78 ZK 2282. 1135m <sup>2</sup>
2	4/79 ZK 2282. 172m <sup>2</sup>
3	4/100 ZK 2282. 95m <sup>2</sup>
4	4/102 ZK 2282. 154m <sup>2</sup>
5	4/103 ZK 2282. 105m <sup>2</sup>
6	4/109 ZK 2282. 175m <sup>2</sup>
7	5/47 ZK 2282. 495m <sup>2</sup>
8	5/49 ZK 2282. 317m <sup>2</sup>
9	5/52 ZK 2282. 423m <sup>2</sup>
10	5/77 ZK 2282. 406m <sup>2</sup>
11	5/55 ZK 2282. 217m <sup>2</sup>
12	4/171 ZK 2282. 1026m <sup>2</sup>
13	4/38 ZK 2282. 743m <sup>2</sup>

Për mungesë personeli/ stafi nuk është kryer përditësimi i listave paraprahe përfundimtare të inventarëve të pronave për 3 NJA Golaj, Fajza dhe Gjinaj.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nuk janë kryer procedurat për transferimin përfundimtar të listave të inventarëve të pronave për 3 NJA Golaj, Fajza dhe Gjinaj, duke kryer inventarizimin dhe përditësimin e listave paraprahe të pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM Bashkisë dhe NJA-ve dhe më pas miratimin me VKB e paraqitjen pranë ASHK në Drejtorinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike me vërejtjet dhe ndryshimet e listave të paraprahe apo fillestare të pronave të miratuara. Gjithashtu në lidhje me përgjigjen e dhënë nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve se për 10 prona, janë pajisur me certifikatë regjistrimi gjatë vitit 2024 – 2025, të pasqyruara në tabelën 1, sqarojmë që nuk është kryer procedurë për rivlerësimin e tyre pra këto janë prona për të cilat certifikatat e regjistrimit janë marrë në vitin 2020.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar**.

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve përcjellë me shkresën 24/6 datë 06.04.2023 rezulton se, nga subjekti është respektuar afati 20 ditë për kthimin e përgjigjes për marrjen e masave në zbatimin e rekomandimeve, përcjellë me shkresën nr. 1082/1.Prot, datë 30.05.2023, në zbatim të shkronjës “j” të nenit 15 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”.

Ndërsa për respektimin e afatit 6 mujorë nga Bashkia Has nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim të pikës 2 të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”.

- Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a- Nga **23 masa organizative** të rekomanduara, pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 7 masa, janë në proces 3 masa, **janë pjesërisht të zbatuara 2 masa dhe nuk janë zbatuar 11 masa.**

b- Nga **1 masë shpërblim dëmi** në vlerën **265,845.521 lekë**, pranuar 100% nga subjekti, e cila rezulton e pazbatuar.

c- Nga **3 masa për eliminim e efekteve negative**, pranuar 100% nga subjekti, të cilat janë në proces zbatimi.

d- Nga **4 masa për uljen e borxhit tatimor**, pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat nuk është zbatuar asnjë masë, në proces zbatimi janë 1 masë, **realizuar pjesërisht 2 masa dhe pa zbatuar 1 masë.**

e- **Masat disiplinore**, nuk janë dhënë nga titullari i institucionit.

**11.1. Rekomandimi:** Bazuar në nenin 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju ri kërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

### **A. Masat Organizative**

**1.1 Rekomandimi:** Bashkia Has të marrë masa që të hartohet dhe miratohet strategjia e riskut. Titullari i Bashkisë Has të miratojë gjurmën e auditimit për proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme. Koordinator i Grupit të Menaxhimit Strategjik të organizojë takimet periodike të GMS-së për të siguruar marrjen në kohën dhe formën e duhur të informacioneve cilësore me qëllim vlerësimin e progresit të bërë në arritjen e objektivave të MFK-së. Sektori i Burimeve Njerëzore në Bashkinë Has të marrë masa që për çdo largim punonjësish nga puna të ndiqet procedura për dorëzimin e detyrës.

**Komenti i grupit të auditimit:** Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që rezultojnë ende të pazbatuara. Me qëllim unifikimit dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së masave korrigjuese, rekomandimet e përsëritura do të konsiderohen në një të vetme dhe do të rikërkohen në mënyrë të centralizuar në vijim të këtij raporti.

**Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe i zbatuar pjesërisht.**

**2.1 Rekomandimi:** Bashkia Has të marrë masa për ngritjen e strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm, që të jetë një mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm si dhe një organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë ose, shërbimi i auditit të brendshëm të

kryhet nga njësi e auditit të brendshëm të një njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshje ndërmjet titullarëve të njësi publike përkatëse.

**Përgjigja e institucionit:** Për vitin 2024, Kryetari i Bashkisë Has ka miratuar strukturën organike sipas urdhrit nr 35, datë 15.01.2024, gjithsej 300 punonjës.

Për sa i përket sektorit të AB ai përbëhet nga një përgjegjës sektori dhe dy specialistë/auditi. Struktura faktike ka vakant ende përgjegjës e sektorit dhe është plotësuar me 2 specialistë/auditi përkatësisht me emërim të znj. E. Z. në janar 2024 dhe z. S. Sh. me emërim në korrik 2024. (Punonjësit nuk janë të pajisur me certifikatën e auditit të brendshëm).

**Komenti i grupit të auditimit:** Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që rezultojnë ende të pazbatuara. Me qëllim unifikimin dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së masave korrigjuese, rekomandimet e përsëritura do të konsiderohen në një të vetme dhe do të rikërkohen në mënyrë të centralizuar në vijim të këtij raporti.

***Për sa më sipër, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe i zbatuar pjesërisht.***

**3.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Has dhe Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Has dhe kontraktorëve, brenda afatit 30 ditor pas ardhjes së faturës tatimore, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor.

**Komenti i grupit të auditimit:** Rezulton se, nuk ka debitorë të rinj të krijuar gjatë vitit 2024, në lidhje me likuidimin e kontrave të lidhura me OE sipas detyrimeve kontraktuale.

Për sa trajtuar më sipër ***rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe i zbatuar.***

**5.1 Rekomandim:** Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për krijimin e regjistrit të taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit e kategorisë familjare me të gjitha të dhënat e nevojshme, i cili të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve vendore që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Has.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër ***rekomandimi 5.1; konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe i pa zbatuar.***

**6.1 Rekomandim:** Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Bujqësisë të marrin masa për të identifikuar numrin e familjeve që kanë në pronësi tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saktë që ato zotërojnë, me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota dhe të sakta. Ky regjistër më pas të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve që ju lindin këtyre familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Has.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër ***rekomandimi 6.1, konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe i pa zbatuar.***

**10.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has të marrë masa, që në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare, të zbatojë parimet e kontabilitetit në procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare duke ndjekur fazat në mënyrë logjike, që nga mbajtja e dokumenteve përmbledhës të transaksioneve dhe veprimeve që rezultojnë nga mbajtja e kontabilitetit në ditarët përkatëse kronologjik, saktësimin e pozicionit të çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm dhe pas verifikimit paraprak të pozicionit të llogarive, të cilat duhet të jenë të balancuara, të bëjë në fund kryerjen e veprimeve të mbylljes së llogarive, deri

ne pozicionin përfundimtar të tyre, duke evidentuar dhe në librin e veprimeve të ndryshme sistemimet me të gjitha të dhënat të kryera në llogaritë e ndryshme sipas rastit.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër *rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe i zbatuar.*

**11.1 Rekomandim:** Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore të shqyrtojë dokumentacionin financiar të ish-komunës Gjinaj, mbi bazë të së cilës të analizojë dhe të përcaktojë të drejtat e konstatuara për arkëtim, duke përcaktuar personat përgjegjës material me shumat përkatëse që i kanë detyrim Bashkisë për kthim. Nëse është e pamundur Bashkia Has të ndjekë hapat ligjorë për njohjen ose jo të këtij detyrimi dhe më pas të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet.

**12.1 Rekomandim:** Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës 1,791,490 lekë që i përket 27 projekt-studimeve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij. Më pas të bëjë korrigjimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe të bëjë sistemimet e kontabël përkatëse.

**Komenti i grupit të auditimit:** Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që rezultojnë ende të pazbatuara. Me qëllim unifikimin dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së masave korrigjuese, rekomandimet e përsëritura do të konsiderohen në një të vetme dhe do të rikërkohen në mënyrë të centralizuar në vijim të këtij raporti

Në lidhje me rekomandimet **11.1 dhe 12.1, konsiderohen në proces zbatimi.** (Trajtuar në rekomandimet **3.1 dhe 6.1** të Kap. A. Masa Organizative).

**14.1 Rekomandimi:** Bashkia Has, të marrë masa për shqyrtimin e kërkesave ligjore për hartimin e raporteve përmbledhëse gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër rekomandimi **14.1, konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe i pazbatuar.**

**23.1 Rekomandim:** Nga Bashkia Has të merren masa për të pasqyruar në njoftimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë mënyrën e përllogaritjes së taksës.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër rekomandimi **23.1, konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe i pazbatuar.**

**25.1 Rekomandimi:** Bashkia Has të marrë masa për të hartuar një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të lënë nga KLSH, si dhe të kryej raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

**26.1 Rekomandimi:** Bashkia Has të marrë masat për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të lëna nga KLSH në auditimin e realizuar në vitin 2022.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër rekomandimi **25.1 dhe 26.1, konsiderohen pjesërisht të zbatuar.**

**27.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Has të ngrëjë një grup pune për të verifikuar dhe dokumentuar procesin e ndjekur për vendosjen e bustit të Pjetër Bogdanit si dhe të merren masa për të plotësuar dokumentacionin me qëllim vlerësimin e veprës dhe regjistrimin e saj në inventarin e Bashkisë Has.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga Bashkia Has, rezulton të mos jenë marrë masa për vlerësimin e veprës dhe regjistrimin e saj në inventarin e Bashkisë Has.

***Për sa më sipër rekomandimi 27.1 konsiderohet i pazbatuar.***

### **B. Masa shpërblim dëmi**

**1.2 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Has të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës **265,845.5 lekë**, nga subjekti "K. C." ShPK, përfitues në mënyrë të pa drejtë të kësaj vlere, si rezultat i llogaritjes së gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga Bashkia Has, rezulton të mos jenë marrë masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës **265,845.5 lekë**, nga subjekti "K. C." ShPK, përfitues në mënyrë të pa drejtë të kësaj vlere, si rezultat i llogaritjes së gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

***Për sa më sipër rekomandimi 1.2, konsiderohet i pazbatuar.***

### **C.2 Masa për uljen e borxhit tatimor për rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara).**

**4.1 Rekomandim:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të vitit 2022 në vlerën progresive **42,557,390 lekë** e përbërë nga:

- 26,825,739 lekë për 187 subjekte private (biznesi i madh dhe i vogël);
- 4,861,266 lekë për qiratë e ambienteve të tregut (Markat e Qytetit Krume);
- 10,619,005 lekë për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet;
- 96,900 lekë nga kontratat e dhënies me qira të aseteve;
- 154,480 lekë nga institucione publike;

**7.1 Rekomandim:** Sektori i Planifikimit, të Territorit dhe Urbanistikës në Bashkinë Has të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet" dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 276 debitorë në vlerën **10,620,347 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Has të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukture.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga Bashkia Has/ Sektori i Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës, rezulton të mos jenë marrë masa konkrete për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 276 debitorë në vlerën **10,620,347 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen.

Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që rezultojnë ende të pazbatuara. Me qëllim unifikimin dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së masave korrigjuese, rekomandimet e përsëritura do të konsiderohen në një të vetme dhe do të ri kërkohen në mënyrë të centralizuar në vijim të këtij raporti.

***Për sa më sipër rekomandimi 7.1 konsiderohet i pazbatuar.***

**9.1 Rekomandim:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të shqyrtojë dokumentacionin e subjekteve "D. H." ShPK dhe "D. M." ShPK të marrë masa, që këta subjekte të pajisen menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit, duke paguar vlerën e mbetur prej **1,000,000 lekë** ndaj Bashkisë Has për 5 vjet, duke filluar nga data e mbarimit në vitin 2022. Gjithashtu,

Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim, që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.

**Komenti i grupit të auditimit:** Në lidhje me rekomandimet **4.1 dhe 9.1**, grupi i auditimit është shprehur përkatësisht në rekomandimet 1.1/ Seksioni D dhe 2.1, në seksionin C, **të cilat rezultojnë pjesërisht të zbatuara.** (Rekomandimet janë të njëjta në përmbajtje por që i përkasin vitet përkatësisht 2022 dhe 2023 e rrjedhimisht debitorët paraqiten progresiv si në numër edhe në vlerë).

## **B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH.**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të korrespondencës zyrtare të bashkisë me ASHK- Drejtoria Has dhe pagesat e kryera nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë (TNI) rezulton se, për vitin 2023 janë legalizuar 24 objekte me vlerë të TNI prej 1,068,602 lekë dhe në 6-mujorin e dytë të vitit 2022 (me shkresë të ardhur në 2023) janë legalizuar 15 objekte me vlerë të TNI prej 660,821 lekë. **Pra vlera totale e shtuar për vitin 2023 për taksën në infrastrukturë është 1,729,423 lekë**, për të cilën nuk është kryer asnjë pagesë, duke sjellë të ardhura të munguara (e pa kontabilizuar).

Ndërsa në vitet e mëparshme deri në Qershor 2022 janë 266 debitorë në vlerë totale 10,313,690 lekë, vlerë e cila është trajtuar në detyrimet për taksat dhe tarifata.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nenit 9, pika 3.c dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5. Pika 5 e nenit 27 të ligjit 9632 datë 30.10.2006 “për sistemin e taksave dhe tarifave vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2 në faqet 32-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me vlerë **1,729,423 lekë**.

**Përgjigja e subjektit:** Shkresa zyrtare nga ASHK ka ardhur në bashki pas mbylljes së pasqyrave financiare 2023, kontabilizimi është kryer në pasqyrat financiare 2024 duke debituar llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” në shumën 1,698,702 lekë dhe kredituar llogarinë 4341 “Operacione me shtetin detyrime në shumën 1,698,702 lekë. Diferenca sipas kërkesës për arkëtim në shumën 30,723 leke i përket qytetarit S N i cili ka paguar detyrimin me date 06.12.2024.

Janë dërguar njoftim vlerësimet për debitorët për taksën në infrastrukturë gjatë vitit 2024 dhe rezulton që nga shuma totale prej 1,698,702 lekë janë paguar 815,146 lekë. Diferenca për tu paguar është 883,556 lekë.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga informacioni dhe dokumentacioni që bashkia disponon, rezultojnë **9**

**subjekte** që ushtrojnë aktivitetet tregtim lëndë djegëse me pakicë, nga të cilat 1 pikë ka licenca me afat më të shkurtër se 5 vjet dhe me pagesa pjesore dhe 8 pika kanë licenca 5-vjeçare. Të 9 subjektet kanë detyrime me një efekt financiar me vlerë totale 4,447,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Has (e pakontabilizuar), veprime në kundërshtim me *ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”*, i ndryshuar me *ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”*, të ndryshuar, neni 4.

**2.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Taksave, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që **9 subjektet** të plotësojnë dokumentacionin të bëjnë pagesën përkatëse për ushtrimin e aktivitetit duke paguar detyrimet ndaj Bashkisë Has me vlerë 4,447,000 lekë. Gjithashtu, Drejtoria e Financës dhe Taksave të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet me qëllim që të kryhen pagesat e plota brenda afateve.

**Përgjigja e subjektit:** Gjatë vitit 2024 nga detyrimi i mësipërm është paguar 1,060,000 lekë tarifë për leje shfrytëzimi karburantesh. Subjektet janë njoftuar zyrtarisht nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore me shkresat si më poshtë:

1. Shoqëria Vëllezërit P., shkresa 289 prot date 23.01.2024, ne vijim nuk është njoftuar pasi ka paguar detyrimet.

2. Shoqëria “Xh. P” është njoftuar me kërkesë pagese 1817 prot datë 03.06.2024, dhe nr.2911/12 prot datë 13.09.2024, kjo shoqëri ka paguar detyrimin vjetor për vitin 2024 me datë 11.06.2024 në shumën 200,000 lekë.

3. Shoqëria “S” Shpk është njoftuar për pagesë me shkresën nr.291 prot datë 23.01.2024, si dhe shkresa nr.1813.prot datë 03.06.2024, dhe ka paguar më datë 10.06.2024, shumën 200,000 lekë pagesë autorizimi sipas akt marrëveshjes së lidhur me bashkinë datë 10.09.2020 me afat 5 vjeçar.

4. Shoqëria “D. H” është njoftuar me kërkesën për pagesë nr.290/prot, datë 23.01.2024 dhe shkresa nr.1815.prot datë 03.06.2024. Shoqëria ka kryer pagesën e autorizimit me datë 10.06.2024 në shumën 200,000 lekë (bazuar ne akt marrëveshjen datë 14.04.2023)

5. Shoqëria “D & M” ka kryer pagesën e autorizimit vjetor në datë 31.07.2024, në vlerën 200.000 lekë.

6. Shoqëria “K. L” është njoftuar për pagesë me shkresën nr.1814.prot, datë 03.06.2024, dhe shkresën nr.2448.prot, datë 17.07.2024 dhe shkresën nr.2991/18 datë 19.09.2024, nga verifikimet e kryera rezulton se shoqëria nuk ushtron aktivitet.

7. Shoqëria “E” Shpk ka pezulluar aktivitetin me datë 31.05.2021, nga verifikimet e kryera pra shoqëria nuk ushtron aktivitet.

8. Shoqëria “G SH” ShPK është njoftuar dhe kërkuar pagesë me shkresën nr.292 datë 23.01.2024, ka shlyer rregullisht çdo muaj detyrimet për autorizimin. Detyrimi vjetor është paguar.

9. Shoqëria “H” ShPK është njoftuar dhe është kërkuar pagesa me shkresën nr.1816.prot datë 03.06.2024, nuk ka kryer asnjë pagese gjate vitit 2024, aktiviteti i shoqërisë rezulton i pezulluar nga data 09.06.2022.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

## **C. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET KONTRAKTORE NGA QIRADHËNIA.**

**1.Gjetje nga auditimi:** Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave nuk ka të dhëna lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin për të paguar tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, nuk ka të dhëna lidhur me nivelet e pritshmërisë së tyre si dhe nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve që janë debitorë ndaj bashkisë. Gjithashtu, familjet në Bashkinë Has nuk ngarkohen për detyrimet vendore për taksat dhe tarifën e tjera të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak, si për shembull taksa e tokës bujqësore, taksa e truallit, tarifën e gjelbërimit. Bashkia Has nuk ka agjent tatimor për mbledhjen e taksave/tarifave nga familjet, por i mbledh ato me paraqitjen e qytetarëve pranë zyrave të bashkisë/njësive administrative për të marrë shërbime të ndryshme. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore regjistron vetëm të dhëna lidhur me familjet që paguajnë ndërsa për familjet debitorë nuk ka një regjistër.

Si rezultat, procesi i ngarkimit të familjeve për detyrimet vendore nuk është i dokumentuar si dhe nuk dihet numri i familjeve debitorë dhe vlera totale që ato kanë ndaj bashkisë.

Gjendja e debitorëve progresiv të vitit 2022 rezulton në vlerën 42,557,390 lekë, gjatë vitit 2023 janë paguar detyrime në total në vlerën 1,657,558 lekë dhe nga shtesat në vlerën 3,102,436 lekë, rezulton gjendja e debitorëve progresiv është në vlerën 44,002,268 lekë.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me përcaktimet e VKB nr. 78, datë 22.12.2021, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has”, me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2 në faqet 32-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Taksave, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifën vendore në fund të vitit 2023 në vlerën progresive **44,002,268 lekë** e përbërë nga:

- Detyrimet nga taksat dhe tarifën për biznesin e vogël në shumën 12,652,282 lekë;
- Detyrimet nga taksat dhe tarifën për biznesin e madh në shumën 15,200,476 lekë;
- Detyrime nga institucionet shtetërore në shumën 206,600 lekë;
- Detyrime nga Kryefamiljarë të pajisur me leje legalizimi në shumën 10,313,690 lekë;
- Detyrime nga qiratë e tregut (markat) në shumën 5,357,075 lekë;
- Detyrime kontraktore nga qiradhënie të tokës bujqësore të pandarë në vlerën 272,145 lekë.

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e-Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Has, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje e lejitimit të tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

**Përgjigja e subjektit:** Në lidhje me sa në sipër, Sektori i Taksave dhe Tarifave, ka kryer njoftim vlerësimet tatimore përkatësisht,

Për institucionet shtetërore me shkresën nr.288/15, dt 23.01.2024 (15 institucione)

- Për detyrimet nga taksat dhe tarifatat për biznesin e vogël, shkresa me nr 2507, dt 28.08.2024, (paguar në 2024 – vlera 314,615 lekë).
- Për detyrimet nga taksat dhe tarifatat për biznesin e madh, shkresa 2911/21, dt 13.09.2024, (paguar në vitin 2024 2,077,838 lekë).
- Për detyrimet kontraktore nga qiradhënie të tokës bujqësore të pandarë edhe tokës pyjore, janë njoftuar 14 subjekte sipas shkresave paraqitur grupit të auditimit.

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Nuk janë dërguar nga Sektori i Tatim Taksave, njoftimet drejt bankave të nivelit të dytë ( urdhër bllokimet e llogarive bankare).

Nuk janë dërguar në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **pjesërisht i zbatuar**.

**2. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Has në kuadër të administrimit të aseteve për krijimin e të ardhurave ka lidhur **28 kontrata** përkatës me subjekte të ndryshëm fizik/ juridik për dhënien me qira të aseteve, që ka në pronësi apo në përdorim për afate kohore nga 1-30 vjet. Kontratat janë lidhur për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullorore, për aktivitet bujqësor, për pemëtari, antena, studim-kërkim-zbulim minerali dhe ngritje fabrike përpunimi, agroturizmit etj. Nga verifikimi i dokumentacionit e dosjeve të kontratave dhe pagesave të kryera rezultoi se, në fund të vitit 2023 paraqiten 10 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në vlerën 1,207,337 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Has.

Referuar të dhënave të faqes së AKBN-së dhe dokumentacionit të aseteve, rezultoi se në territorin e Bashkisë Has ushtrojnë aktivitetin 19 subjekte private për prodhim dhe nxjerrje minerare dhe inertesh, në parcela të fondit pyjor-kullor, asete të Bashkisë Has.

Nga Bashkia nuk është lidhur në asnjë rast kontratë qiradhënie të hapësirës për ndërtim/përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim, me rrjetin rrugor, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Has. Këto veprime janë në kundërshtim me *Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 36, me VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” me VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore” i ndryshuar me VKM nr.267, datë 27.04.2023.*

**2.1. Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të marrë masa për monitorimin e kushteve të kontratave të qiramarrësve, duke e dokumentuar këtë proces, si dhe të veprojë në kohë ndaj të gjithë qiramarrësve që nuk respektojnë përcaktimet në kontratë. Të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e tarifës së qirasë nga 10 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në vlerën 1,207,337 lekë.

**Komenti i grupit të auditimit:** Në lidhje me këtë rekomandim jemi shprehur në rekomandimin 1.1 dhe rekomandimi **konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe pjesërisht i zbatuar**.

**2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse Bashkia HAS, të marrë masa që për subjektet të cilat janë pajisur me leje shfrytëzimi nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), të hartojë raporte teknike për saktësimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme, të bëjë përditësimin në kadastrën e pyjeve në sipërfaqe dhe vëllim, ku për sipërfaqet e pa zbritura nga fondi pyjorë, t'i drejtohet subjekteve me leje minerale të bëjë kërkesën për zbritje nga fondi pyjorë, në referencë të nenit 17, të Ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjorë”, i ndryshuar, për zbritjen nga fondi pyjorë. Gjithashtu në bashkëpunim me Policinë Bashkisë dhe Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit (IMT), nuk duhet të lejojë që në territorin e sajë të përdorin sipërfaqe pyjore/kullosore pa kontratë me bashkisë.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nuk ka përgjigje për këtë rekomandim e rrjedhimisht rekomandimi konsiderohet *i pranuar nga subjekti dhe i pazbatuar*.

#### **D. MASA DISIPLINORE.**

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja, mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Has, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

##### **a -“Vërejtje” neni 58 shkronja (a), për 3 punonjës, si më poshtë:**

**1. Z. S. M.** Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Taksave, në cilësinë e nëpunësit zbatues, - Për problemet e konstatuara në lidhje me mbledhjen e të ardhurave të bashkisë dhe monitorimin e borxhit, për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe paketën fiskale të miratuar VKB-së nr. 104 datë 25.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2021”.

-Për mangësitë e konstatuara në kundërshtim me *ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5 datë 21.02.2022 dhe me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në lidhje me mbajtjen e librave të kontabilitetit, gjendjet e llogarive: 202 “Studime dhe Kërkime”, 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba”, 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” dhe moskryerjen e inventarit fizik i aktiveve materiale dhe jo materiale si dhe aktiveve afatshkurtra të Bashkisë Has dhe 4 NJA-ve, Për këto aktive nuk është kryer inventar fizik për të verifikuar statusin e tyre, nëse ekzistojnë apo jo dhe marrjen e masave për ndjekjen e procedurave ligjore për sistemimin e tyre.*

**2. Z. U. H.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave.

- Për problemet e konstatuara në lidhje me mbledhjen e të ardhurave të bashkisë dhe monitorimin e borxhit, për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”,

i ndryshuar dhe paketën fiskale të miratuar VKB-së nr. 104 datë 25.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2021” .

- Mos monitorim të kontratave të qirasë dhe ndjekjen e debitorëve për arkëtimin e detyrimeve kontraktore të qiradhënies në vlerën 1,207,337 lekë.

**3. Z. Y. D.** me detyrë inspektor i pronave.

Për mangësitë e konstatuara në kundërshtim me *ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV “Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike” nenet 35-44, me Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike” dhe VKM-së nr.669, datë 07.08.2013 “Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH)” me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” dhe me kontratat përkatëse pika 4 “dispozita të veçanta”, neni “Pagesa” ose “Të drejtat dhe detyrimet e përdoruesit”, me VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore” i ndryshuar, për:*

- Mos kryerje të procedurave për transferimin përfundimtar të pronave për 3 NJA Golaj, Fajza dhe Gjinaj, duke mos kryer përditësimin e listave paraprake të inventarëve pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM Bashkisë dhe NJA-ve dhe mos hipotekimi i pasurive të paluajtshme të transferuara.

- Mos monitorim të kontratave të qirasë dhe ndjekjen e debitorëve për arkëtimin e detyrimeve kontraktore të qiradhënies në vlerën 1,207,337 lekë.

Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Rekomanduar	Zbatuar	Pa zbatuar	Në proces	Pjesërisht të zbatuar
Masa Organizative	11	6	1	2	2
Masa për eliminimin e efekteve negative	2			2	
Uljen e Borxhit	3		1		2
Masa Disiplinore	3		3		
<b>Total</b>	<b>19</b>	<b>6</b>	<b>5</b>	<b>4</b>	<b>4</b>

Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e viteve 2020-2022 paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Rekomanduar	Zbatuar	Pa zbatuar	Në proces	Pjesërisht të zbatuar
Masa Organizative	13	2	5	2	4
Masa Shpërblim dëmi	1	0	1	0	
Uljen e Borxhit	3		1		2
<b>Total</b>	<b>17</b>	<b>2</b>	<b>7</b>	<b>2</b>	<b>6</b>

### **Konkluzion:**

- Bashkia Has, nuk ka respektuar afatin 6 - mujor të kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me nenin 30, pika 2 e Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Niveli i pranimit të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën **31 % zbatuar, pa zbatuar në nivelin 26,32 %, në proces apo zbatuar pjesërisht në nivelin 42,1 %**.

**-Në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve nga auditimet e viteve të kaluara paraqitet;**

Niveli i pranimit të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën **11,76 % zbatuar, pa zbatuar në nivelin 41,17 %, në proces apo zbatuar pjesërisht në nivelin 47 %.**

Sa më sipër veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me *Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, netët 15 dhe 30, pika 2 dhe Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, “Auditimi i jashtëm”, pika 5.*

Mbajnë përgjegjësi:

- Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë Has, znj. N. L.
- Përgjegjësi i sektorit të tatim taksave, z. D. C.
- Specialistët e sektorit: S. XH. dhe inspektore e tregut dhe taksapaguesve familjarë E. D.
- Drejtor i administrimit të Pyjeve, z. F. D.

Për sa më sipër, Bashkia Has/ Kryetari, z. M. D. ka sjellë objeksionet e tij me shkresën me nr. 1927/3 datë 18.08.2025, protokolluar në KLSH me nr 466/4, datë 21.08.2025.

Në këtë shkresë z. D. konfirmon njohjen me PRA-në e kryer në Bashkinë Has si dhe ndjekjen e procesit të gjetjeve dhe zbatimit të rekomandimeve të lëna në këtë material.

#### **Pika 4. Të ndryshme të dala gjatë auditimit.**

Nga të dhënat e vëna në dispozicion në lidhje me planifikimin dhe realizimin e të ardhurave në bazë të informacionit të dërguar nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit informacion i dërguar pas përfundimit të fazës së terrenit konstatohet që planifikimi buxhetor përfundimtar për vitin 2024 është në vlerën 857,277,000 lekë. Nga auditimi i pasqyrës së performancës financiare u konstatua që të ardhura në total për vitin 2024 janë në vlerën 717,377,105 lekë të cilat kanë shërbyer për kryerjen e shpenzimeve korente për paga mallra dhe shërbime dhe financimin e shpenzimeve për ndihmat ekonomike dhe paaftësisë. Për vitin 2024, llogaria 231 investimet në proces janë në vlerën 129,520,290 lekë. Nga auditimi i pasqyrës E3 “Cash Flow”, u konstatua që kthime në buxhet për fonde të pa përdorura janë në vlerën prej 5,489,228 lekë. Grupi i auditimit kreu përllogaritjet në lidhje me saktësinë e raportimit në pasqyrën e pozicioni financiar të ardhurave nga grantet dhe të ardhurat e veta si më poshtë vijon:

Tabela 4.1 Përllogaritjet për pasqyrimin e granteve dhe të ardhurave të veta në PASH viti 2024/lekë

Plani buxhetor përfundimtar viti 2024	231 i vitit 2024	Transferimi në buxhet i fondeve të pa përdorura	Kontabilizimi i ardhurave në PASH sipas përllogaritjeve	Kontabilizimi i ardhurave në PASH faktik	Pasqyruar e të ardhurave në PASH më pak se përllogaritjet
1	2	3	4=1-2+3	5	6=5-4
857,277,000	129,520,290	5,489,228	733,245,938	717,377,105	-15,868,833

Burimi: Drejtoria e financës dhe buxhetit bashkia Has/përpunoi grupi i auditimit

Konstatohet që për vitin 2024 janë pasqyruar të ardhura më pak në pasqyrën e performancës financiare për vlerën 15,868,833 lekë. Mos pasqyrimi i këtyre të ardhurave për vlerën 15,868,833 lekë tregon që nuk janë reflektuar ndryshimet buxhetore të realizuara gjatë vitit për të ardhurat rrjedhimisht pasaktësi në raportimin e tyre në pasqyrën e pozicionit financiar.

Nga auditimi në lidhje me raportimin e të ardhurave të realizuara përgjatë vitit konstatohet se nuk janë respektuar parimet e njohjes së të ardhurave në pasqyrat financiare sipas përcaktimeve të

Kapitullit II, Rubrika 2.3 “Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik”, paragrafi 8 të Udhëzimit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, të ndryshuar, ku citohet “...në lidhje me njohjen e të ardhurave në librat e tyre të brendshëm kontabël, të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme gjatë raportimit të tyre financiar do të përdorin metodën mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, në kuadër të rritjes së transparencës dhe besueshmërisë së informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare”, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 6, neni 9 dhe nenin 10, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 germa a dhe germa c, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5 germa a, neni 42, pikat 1, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 198, “Njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për mbledhjen në kohë të të ardhurave dhe menaxhimin e tyre”.

## V. GJETJE DHE REKOMANDIME

### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se Bashkia Has nuk ka miratuar një plan strategjik me objektiva dhe priorite në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor. Gjithashtu, mungojnë planet vjetore të punës për të gjitha drejtoritë përkatëse. Për vitin 2024, nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut dhe regjistri përkatës, duke mos përfshirë të gjitha strukturat e bashkisë. Po ashtu, nuk janë ndërmarrë veprime për monitorimin dhe raportimin periodik të risqeve me impakt të lartë, si dhe mungojnë plan-veprimet për menaxhimin efektiv të tyre. Titullari i institucionit nuk ka miratuar plan për menaxhimin e risqeve të nivelit të mesëm dhe të lartë. Mungojnë hartat dhe manualët e proceseve të punës të cilat sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësi, veprime në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu II, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1, në faqet 14-25, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1 Rekomandimi:** Nga Kryetari i Bashkisë Has dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik të merren masa për:

-Hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut, regjistrin të riskut si dhe planin e veprimit për minimizimin e risqeve për të gjithë institucionin me qëllim menaxhimin aktiv të tyre.

-Vlerësimin e mundësisë së riskut për mashtrime dhe të kryhen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve, në mënyrë që vlerësimi i riskut të mashtrimin të bëhet pjesë integrale e procesit të menaxhimit të riskut.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**1.2 Rekomandimi:** Nga Kryetari i Bashkisë Has dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik të merren masa për:

-Hartimin e manualeve të shkruara të proceseve të punës, në mënyrë që të identifikojnë përgjegjësitë dhe të përcaktojnë linja të qarta raportimi për njësinë publike.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i përbërjes dhe veprimtarisë së Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, u konstatua se:

-Audituesit e brendshëm nuk janë të certifikuar.

-Sektori i Auditit të brendshëm rezulton joefektiv, pasi struktura e tij është e paplotësuar, ku përgjatë vitit 2024, rezulton vakant pozicioni i përgjegjësit të sektorit si dhe për gjysmën e vitit ka qenë vetëm me një specialist, duke sjellë realizimin e një plani auditimesh prej nga 11 të miratuara në vetëm 4 auditime të realizuara. Kjo e ekspozon institucionin në mos identifikimin në kohë të dobësive apo rreziqeve financiare dhe administrative, veprime në kundërshtim me nenin 13 të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe në nenin 19 “Certifikimi i Audituesve të brendshëm”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.2, në faqet 25-3, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakant në strukturën e Njësisë së Auditit të Brendshëm, me qëllim bërjen funksionale të kësaj njësie auditimi për përmbushjen e misionit të saj, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë.

*Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i Pasqyrave Financiare të hartuara për Degën e Thesarit Has me shkresën nr.1095, datë 27.03.2025 u konstatua se janë dërguar në mënyrë elektronike në thesar më datë 16.04.2025 konfirmuar nga dega e thesarit datë 21.05.2025, jashtë afateve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 118, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, në faqet 31-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Has, të marrë masa për ndjekjen e afateve të raportimit financiar, në mënyrë që pasqyrat financiare të përgatiten, siglohen dhe dorëzohen në kohën e duhur.

*Në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” u konstatua se kjo llogari ruan të njëjtën vlerë prej 914,949 lekë si në fund të vitit 2024, ashtu edhe në fund të vitit 2023, pa pasur lëvizje gjatë periudhës raportuese. Kjo vlerë është trashëguar nga procesi i konsolidimit të pasqyrave financiare midis Bashkisë Has dhe ish-komunës Gjinaj, në kuadër të reformës territoriale të vitit 2015. Megjithatë, nga strukturat përkatëse të bashkisë nuk është hartuar një analizë e detajuar që të sqarojë natyrën dhe përbërjen e kësaj vlere, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, në faqet 31-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masat për të shqyrtuar dokumentacionin financiar të ish-komunës Gjinaj, me qëllim analizimin dhe identifikimin e të drejtave të konstatuara për arkëtim në vlerën prej 914,949 lekë, si dhe të marrë hapat e nevojshëm për realizimin e mbledhjes së këtij detyrimi.

*Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procesit të kontabilizimit të pronave në llogarinë 211 “Pyje dhe kullota” të Bashkisë Has, u konstatua se, Drejtoria e Administrimit Pyjor dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit / Inspektori i Pronave kanë kryer aplikime pranë ASHK Kukës vetëm për marrjen e vërtetimeve për pronat e regjistruara në vitin 2020, me qëllim dhënien

e tyre me qira. Megjithatë, vlera e këtyre pasurive nuk është regjistruar në kontabilitetin e institucionit. Për pesë certifikatat e pronësisë të përfshira në dokumentacionin përkatës, grupi i auditimit ka kryer një vlerësim të asetëve përkatëse, në bazë të VKM nr. 89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, duke përdorur tabelat referuese për vlerën për m<sup>2</sup> të pyjeve në territorin e Bashkisë Has. Bazuar në këtë metodologji, dhe duke llogaritur me vlerën 100 lekë/m<sup>2</sup>, rezulton se vlera totale e këtyre asetëve është **406,279,100 lekë**. Pavarësisht faktit se këto prona janë regjistruar në ASHK Kukës që në vitin 2020 dhe janë rifreskuar në vitin 2024, ato nuk janë rivlerësuar dhe nuk janë integruar siç duhet në kontabilitetin e bashkisë. Kjo situatë është rezultat i mungesës së bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe Drejtorisë së Administrimit Pyjor, për sa i përket përpunimit dhe shkëmbimit të informacionit mbi regjistrimin dhe pasqyrimin e pasurive pyjore në sistemin financiar, veprime në kundërshtim dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.02.2011, i ndryshuar ”Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik”, pika 36, 52,73,85 si dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 3.1, nënpika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, në faqet 31-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Has në bashkëpunim me Sektorin e pronave dhe Drejtorinë e Shërbimit Pyjor të marrin masa për:

-Të evidentuar dhe të kontabilizuar në mënyrë të plotë vlerat e trojeve të pajisura me certifikata pronësie, si dhe pronat e tjera troje sipas dokumentacionit ligjor ekzistues, duke reflektuar kështu gjendjen reale të asetëve në pronësi të bashkisë.

-Të përfshirë në regjistrat kontabël pasuritë e llojit pyje dhe kullota, që me vendime të posaçme të Këshillit të Ministrave (VKM), i janë kaluar në pronësi njësive vendore (ish-komunave), tashmë pjesë e bashkisë.

-Të bashkëpunuar me institucionet përkatëse si Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria e Pasurive Publike dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive, për të siguruar verifikimin e titujve të pronësisë për të përfituar informacion të saktë mbi sipërfaqet dhe vlerat përkatëse.

- Vlerësimin financiar të asetëve, në rastet kur mungon vlera kontabël, duke u mbështetur në ekspertizën e licencuar për vlerësim pasurish, në përputhje me kërkesat e standardeve kontabël dhe legjislacionit në fuqi.

#### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të Shoqërisë Aksionare “Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Kukës Sh. A” me NIPT M28322201I, u konstatua se Bashkia Has zotëron 6.06% të aksioneve të kësaj shoqërie. Kjo shoqëri është krijuar sipas akt marrëveshjes se Bashkive Tropojë, Has dhe Kukës dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë e përfaqësuar nga AKUM me nr. 3206.prot., datë 19.07.2022 protokolluar nga AKUM me nr. 1574.prot., datë 26.07. 2022. Vlera e kapitalit të kësaj shoqërie është 10,000,000 lekë, ku bashkia Has zotëron ose 6,06% të tyre ose në vlerën total 660,000 lekë e pa pasqyruara kjo në Llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, e cila për vitin 2024 është në vlerën 0 lekë, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu 3.1, pika 31, shkronja “b”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, në faqet 31-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Has të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e saktë të llogarisë nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”.

*Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua se, llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” nuk është pasqyruar saktë, pasi nuk janë përfshirë detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore, të cilat në fund të vitit 2024 rezultojnë në vlerën 277,126 lekë, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar pika.15. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, në faqet 31-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Has, të marrë masa për të pasqyruar vlerën reale të detyrimeve të prapambetura prej 277,126 lekë në llogarinë 467 “Kreditorë të tjerë”, për paraqitjen e një gjendjeje të saktë dhe të drejtë të pozitës financiare të njësisë.

*Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025*

**8. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave nuk ka një regjistër me të dhëna të plota lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin për të paguar tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, e rrjedhimisht nuk ka parashikime reale mbi të ardhurat e pritshme për t’u arkëtuar. Gjithashtu, familjet në Bashkinë Has nuk ngarkohen për detyrimet vendore për taksat dhe tarifatat e tjera të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak, si për shembull taksën e tokës bujqësore, taksën e truallit, tarifën e gjelbërimit. Bashkia Has nuk ka agjent tatimor për mbledhjen e taksave/tarifave nga familjet, por i mbledh ato me paraqitjen e qytetarëve pranë zyrave të bashkisë/njësisive administrative për të marrë shërbime të ndryshme. Si rezultat, procesi i ngarkimit të familjeve për detyrimet vendore nuk është i dokumentuar si dhe nuk dihet numri i familjeve debitorë dhe vlera totale që ato kanë ndaj bashkisë. Këto veprime apo mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar neni 4 pika 7, Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar neni 19, neni 25 pika 5, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1, pika 1.3 germa ç).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, në faqet 31-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1.Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Has në bashkëpunim me drejtorinë e Buxhetit, taksave dhe tarifave vendore të marrë masa për hartimin e një regjistri gjithëpërfshirës me të dhëna të sakta të numrit të familjeve, adresave të tyre me qëllim planifikimin e saktë të taksave për tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës.

-Titullari i Bashkisë Has, të marrë masa që në vendimin e Këshillit Bashkiak të planifikojë sipas një regjistri taksat e tokës bujqësore, taksën e truallit dhe tarifën e gjelbërimit, për maksimizimin e të ardhurave si një nga funksionet bazë të pushtetit vendor.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve përcjellë me shkresën 359/10.Prot, datë 12.06.2024, rezultoi se Bashkia Has, nuk ka respektuar afatin 6 - mujor të kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me nenin 30, pika 2 e Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Niveli i pranimit të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën 31 % zbatuar, pa zbatuar në nivelin 26,32 %, në proces apo zbatuar pjesërisht në nivelin 42,1 %.

Në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve nga auditimet e viteve të kaluara paraqitet; Niveli i pranimit të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën 11,76 % zbatuar, pa zbatuar në nivelin 41,17 %, në proces apo zbatuar pjesërisht në nivelin 47 %.

Konkretisht për vitin 2023: Në 19 masa të kategorizuara në *11 masa organizative, 2 masa për eliminim e efekteve negative, 3 masa për uljen e borxhit tatimor si dhe 3 masa disiplinore, rezultoi se:*

-Nga 11 masa organizative të rekomanduara, janë zbatuar 6 masa, janë në proces 2 masa, janë pjesërisht të zbatuara 2 masa dhe 1 masë e pazbatuar.

-Nga 2 masa për eliminim e efekteve negative, 2 janë në proces zbatimi.

- Nga 3 masa për uljen e borxhit tatimor, rezultojnë *realizuar pjesërisht 2 masa, dhe 1 masë e pazbatuar.*

\* Masat disiplinore, nuk janë dhënë nga titullari i institucionit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 58-78, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1. Rekomandimi:** Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju ri kërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshejtimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

#### **A. Masat Organizative**

**10.1. Rekomandimi:** Bashkia Has nëpërmjet strukturave drejtuese dhe përgjegjëse të kryejë procedurat e plota për transferimin përfundimtar të listave të inventarëve të pronave për 3 NJA Golaj, Fajza dhe Gjinaj, duke kryer inventarizimin dhe përditësimin e listave paraprake të pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM Bashkisë dhe NJA-ve dhe më pas miratimi me VKB e paraqitja pranë ASHK në Drejtorinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike me vërejtjet dhe ndryshimet e listave të paraprake apo fillestare të pronave të miratuara. Gjithashtu për pjesën tjetër të pronave të kaluara Bashkisë me VKM në pronësi/përdorim, të pa hipotekuar të përgatisë dokumentacionin tekniko-ligjor dhe të ndjekë deri në fund regjistrimin e tyre në ASHK, Drejtoria Vendore Has.

**14.1 Rekomandimi:** Bashkia Has, të marrë masa për shqyrtimin e kërkesave ligjore për hartimin e raporteve përmbledhëse gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit.

**27.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Has të ngrejë një grup pune për të verifikuar dhe dokumentuar procesin e ndjekur për vendosjen e bustit të Pjetër Bogdanit si dhe të merren masa për të plotësuar dokumentacionin me qëllim vlerësimin e veprës dhe regjistrimin e saj në inventarin e Bashkisë Has.

**B. Masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, me efekt mungesë të ardhurash.**

**1.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me vlerë **1,729,423 lekë**.

**2.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Taksave, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që **9 subjektet** të plotësojnë dokumentacionin të bëjnë pagesën përkatëse për ushtrimin e aktivitetit duke paguar detyrimet ndaj Bashkisë Has me vlerë **4,447,000 lekë**. Gjithashtu, Drejtoria e Financës dhe Taksave të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet me qëllim që të kryhen pagesat e plota brenda afateve.

## **B. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET KONTRAKTORE NGA QIRADHËNIA.**

**1.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Taksave, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të vitit 2023 në vlerën progresive **44,002,268 lekë** e përbërë nga:

Detyrimet nga taksat dhe tarifave për biznesin e vogël në shumën 12,652,282 lekë;

Detyrimet nga taksat dhe tarifave për biznesin e madh në shumën 15,200,476 lekë;

Detyrime nga institucionet shtetërore në shumën 206,600 lekë;

Detyrime nga Kryefamiljarë të pajisur me leje legalizimi në shumën 10,313,690 lekë;

Detyrime nga qiratë e tregut (markat) në shumën 5,357,075 lekë;

Detyrime kontraktore nga qiradhënie të tokës bujqësore të pandarë në vlerën 272,145 lekë.

T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Has, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje e lejimin e tyre në debitorë të keq.

Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarrja për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

**2.1. Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të marrë masa për monitorimin e kushteve të kontratave të qiramarrësve, duke e dokumentuar këtë proces, si dhe të veprojë në kohë ndaj të gjithë qiramarrësve që nuk respektojnë përcaktimet në kontratë. Të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e tarifës së qirasë nga 10 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në vlerën 1,207,337 lekë.

### ***B. Masa shpërblim dëmi (rekomandime të pazbatuara nga auditimet për periudhën 2020-2022)***

**1.2 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Has të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës 265,845.5 lekë, nga subjekti "K. C" ShPK, përfitues në mënyrë të pa drejtë të kësaj vlere, si rezultat i llogaritjes së gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

### ***C.2 Masa për uljen e borxhit tatimor për rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara).***

**7.1 Rekomandimi:** Sektori i Planifikimit, të Territorit dhe Urbanistikës në Bashkinë Has të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet" dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 276 debitorë në vlerën **10,620,347 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtime të reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Has të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**9.1 Rekomandimi:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të shqyrtojë dokumentacionin e subjekteve “D. H” ShPK dhe “D. M” ShPK të marrë masa, që këta subjekte të pajisen menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit, duke paguar vlerën e mbetur prej 1,000,000 lekë ndaj Bashkisë Has për 5 vjet, duke filluar nga data e mbarimit në vitin 2022. Gjithashtu, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim, që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e debitorëve progresiv deri më datë 31.12.2023, sipas të dhënave analitike marrë nga Sektori i Tatimeve dhe Taksave vendore, rezulton në vlerën 70,461,011 lekë, ku gjatë vitit 2024 janë paguar detyrime në total në vlerën 3,458,455 lekë dhe janë shtuar debitorë në vlerën 22,780,171 lekë, duke sjellë një vlerë të detyrimeve në fund të vitit 2024, në shumën 89,782,727 lekë, të cilat janë të ardhura të munguara në vite për Bashkinë Has.

Për vitin 2024, vlera e debitorëve të rinj është në shumën 19,321,716 lekë, të cilat konsiderohen të ardhura të munguara për vitin 2024, veprime në kundërshtim me përcaktimet e VKB nr. 33, datë 22.12.2023, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has”, me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10.

Konstatohet një tendencë në rritje e detyrimeve të prapambetura dhe mos marrje masash për arkëtimin e detyrimeve duke e vendosur Bashkinë Has para një risku në rritje në mos arkëtimin e të ardhurave të planifikuara vit pas viti.

Nga sektori i Taksave dhe tarifave vendore, nuk janë marrë masa për dërgimin e urdhër bllokimeve dhe monitorimin 30 ditor nga dërgesa e njoftim vlerësimit fillestar mbi detyrimet e lindura për çdo subjekt BM apo BV, e detajuar:

- Detyrime ndaj subjekteve tregtarë, të lëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, në vlerën 23,154,812 lekë;
- Detyrime të debitorëve për penalitete të vendosura nga Agjencia e Prokurimit Publik, në vlerën 3,256,581 lekë;
- Detyrime nga taksat dhe tarifatat për biznesin e madh në shumën 32,121,207 lekë;
- Detyrime nga taksat dhe tarifatat për biznesin e vogël në shumën 13,279,332 lekë;
- Detyrime nga institucionet shtetërore në shumën 206,600 lekë;
- Detyrime nga qiratë e tregut (markat) në shumën 6,030,721 lekë;
- Detyrime kontraktore nga qiradhënie të tokës bujqësore të pandarë në vlerën 595,065 lekë;
- Detyrime kontraktore mbi takën e ndikimit në infrastrukturë, në vlerën 11,138,409 lekë.

Veprime në kundërshtim me Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, Ligjin 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, “Për procedurat tatimore në RSH”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2 në faqet 31-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Buxhetit dhe e Financës/Sektori i Tatim Taksave të analizojnë situatën e debitorëve progresivë dhe atyre të krijuar rishtazi dhe të nxjerrë përgjegjësitë e punonjësve për mos arkëtim të të ardhurave të planifikuara, në moszbatim të detyrave sipas funksioneve përkatëse.

-Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Has të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën 19,321,716 lekë, debi të krijuara në vitin 2024.

-Sektori i Tatim Taksave në bashkëpunim me Sektorin juridik, të ri analizojë të gjithë debitorët e Bashkisë Has deri në 31.12.2024, në vlerën 89,782,727 lekë, duke verifikuar dërgimin e masave shtrënguese ndaj subjekteve, monitorimin e akt- marrëveshjeve dhe respektimin e detyrimeve nga subjektet debitorë dhe në rast të shkeljeve të vazhdojnë me konfiskimin e pasurive siç parashikon ligji tatimor.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **B.1 MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2024, efekti financiar i tyre është në vlerën 1,141,104 lekë. Gjatë vitit 2024, Bashkia Has ka kryer likuidime në vlerën 863,978 lekë, të detyrimeve të mbartura nga vitet e mëparshme. Shpenzimet përmbartimore janë në vlerën e 108,455 lekë, duke sjellë kosto shtesë në buxhetin e shtetit, veprime në kundërshtim me Kodin e Procedurës Civile, neni 510, germa “a” dhe 511, germa “a”, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficiencë.

Sektori i financës nuk ruan të dhënat të ndara sipas shpenzimeve gjyqësore, përmbartimore dhe detyrimet ndaj gjyq fituesve, por i regjistron ato në total, çka sjellë riskun e mos evidentimit të detyrimeve që janë për gjyq fituesit dhe ato që janë për shpenzime përmbartimore.

Përveç Sektorit të Financës dhe Buxhetit, Sektori Juridik i bashkisë Has, bazuar në Rregulloren e Brendshme të miratuar nga Kryetari i Bashkisë me vendim nr. 01, datë 25.04.2024, me nr. 1445 prot., datë 25.04.2024, dhe nenit 48/1 pas evidentimit dhe monitorimit të proceseve gjyqësore, nuk ka njoftuar shkresërisht në kohë reale Drejtorinë e Buxhetit dhe të Financave për të shmangur shpenzimet përmbartimore, të cilat rëndojnë buxhetin e shtetit.

Pra në total efekti financiar i zbatimit të vendimeve të gjykatës për të larguarit nga puna për vitin 2024 është 1,141,104 lekë i detajuar:

- 863,978 lekë, të paguara për vitin 2024,
- 108,455 lekë, shpenzime përmbartimore,
- 277,126 lekë të pa likuiduara në fund të vitit 2024,

Veprime në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 31-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Has të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa eficiencë të buxhetit të Bashkisë Has, në vlerën 108,455 lekë, shpenzime përmbartimore mbi pagesat e kryera për vendimet gjyqësore për gjyq fituesit e larguar nga puna.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

#### **D. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Has t**’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

#### **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**